



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 452 Akti

Nr. 465 Vendimi
Tiranë, më 28.10.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 26.10.2021, në orën 12:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Ermir Lelçi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, komisionere Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Ermir Lelçi, dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Ermir Lelçi është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Shkodër, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Z. Ermir Lelçi, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 16.12.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Etleda Çiftja dhe Roland Ilia.

3. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin datë 13.1.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Pamela Qirko, të gjithë anëtarët të deklarojnë mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe të fillojë hetimi administrativ i thellë dhe i gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

4. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) sipas neneve 31 – 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) sipas neneve 34 – 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe më pas nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

5. Në datën 13.1.2020, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit, e njoftoi mbi përbërjen e trupit gjykues dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni, i kërkoi gjithashtu subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.

6. Në përgjigje të tij², subjekti paraqiti në Komision deklaratën e datës 24.1.2020, në të cilën deklaroi se nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

7. Trupi gjykues, me vendimin e datës 11.10.2021, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Ermir Lelçi, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47

¹E-mail, datë 13.1.2020, ora 16:43 “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

²Lista e akteve (që dorëzohen nga subjekti) protokolluar me nr. *** prot., datë 24.1.2020 në Komision.

dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

8. Në datën 11.10.2021, përmes postës elektronike³, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim, subjektit iu kërkuua të paraqiste edhe shpjegime brenda datës 22.10.2021.

9. Në datën 22.10.2021 subjekti paraqiti pretendimet me shkrim dhe dokumentacionin justifikues, bashkëlidhur pretendimeve në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht, me anë të depozitimit në protokoll⁴ pranë zyrave të Komisionit.

10. Më tej, Komisioni, me anë të postës elektronike⁵, njoftoi subjektin e rivlerësimit se trupi gjykues, me vendimin e datës 22.10.2021, vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 26.10.2021, në orën 12:30, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

11. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ermir Lelçi, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Në datën 26.10.2021 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

13. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

14. Z. Ermir Lelçi, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

15. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 26.10.2021, subjekti i rivlerësimit Ermir Lelçi, kërkoi konfirmimin në detyrë.

16. Seanca dëgjimore e datës 26.10.2021 u ndërpre, për të rifilluar në datën 28.10.2021, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

17. Subjekti i rivlerësimit Ermir Lelçi ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

³E-mail datë 11.10.2021, ora 13:15, "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit administrativ kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit".

⁴Shpjegime të subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi, datë 22.10.2021 (nr. *** prot., datë 22.10.2021, në Komision).

⁵E-mail, datë 22.10.2021, ora 16:03, "Komisioni – Ftesë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore publike".

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

18. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

19. Sipas krerëve IV, V dhe VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; dhe (iii) KLP-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistem objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017⁶ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

21. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

22. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private për periudhën 2003 – 2016 dhe në datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*

⁶Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

➤ *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

23. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shpresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; si dhe (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, e në vijim, shpjegimet në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

24. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar

25. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë si vijon: (i) A.Z., bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit – person i lidhur; (ii) E.L., e bija e subjektit të rivlerësimit – person i lidhur; (iii) E.L., e bija e subjektit të rivlerësimit – person i lidhur; (iv) M.L., i biri i subjektit të rivlerësimit - person i lidhur; (v) N.L. konsiderohet person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, për shkak të dhurimit të shumës 2.110.000 lekë për shlyerjen e parakohshme të kredisë që ka shërbyer si burim për apartamentin në Shkodër.

Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Apartament banimi me sip. 138 m², në vlerën 6.200.000 lekë, në Shkodër

1.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament me sip. 138 m², në bashkëpronësi me babanë N.L., me vlerë 6.200.000 lekë dhe me pjesë takuese 67% për z. N.L. dhe 33% për subjektin Ermir Lelçi. Si burim krijimi subjekti deklaroi: (i) kursime nga vetëpunësimi i babait në bujqësi dhe blegtori që nga viti 1991 e në vijim; (ii) kredi nga “Tirana Bank” në shumën 2.100.000 lekë me kontratën nr. ***, datë 21.6.2007. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁷.

⁷(1) kontratë kapari nr. ***, datë 7.2.2006; (2) transfertë në llogari e shumës 1.000.000 lekë, në “Tirana Bank” datë 7.2.2006; (3) mandatarkëtimi nr. ***, datë 14.6.2006, të shumës 1.400.000 lekë; (4) kontratë shitblerjeje me rezervë pasuri e paluajtshme, apartament banimi, nr. ***, datë 7.5.2007; (5) kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme, apartament banimi, nr. ***, datë 6.6.2007; (6) kontratë kredie bankare afatgjatë për shtëpi nr. ***, datë 21.6.2007; (7) kontratë hipotekimi nr. ***, datë 21.6.2007; (8) vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 13.6.2007, për pasurinë nr. ***, apartament me sip. 138 m², në emër të shtetasve N. dhe Ermir Lelçi dhe harta treguese e regjistrimit; (9) faturë transfertë në llogari të “Tirana Bank”, datë 16.1.2009, e shumës 2.110.000 lekë; (10) depozitë në arkë në “Tirana Bank” datë 16.1.2009, e shumës 800.000 lekë; (11) historiku i transaksioneve në llogarinë e shtetasit Ermir Lelçi; (12) kërkesë/pranim për “Tirana Bank” nga shtetasi Ermir Lelçi, datë 20.1.2009, për shlyerje totale kredie; (13) deklaratë noteriale nr. ***, datë 30.1.2009 nga “Tirana Bank” për lirimin e

1.2. Komisioni konstaton se nga dokumentacioni i dorëzuar në deklaratën *Vetting* dhe të administruar nga notere V.H.⁸, rezulton se ndërmjet shtetasve A.Ç. dhe Ermir Lelçi është lidhur kontrata e kaparit nr. ***, datë 7.2.2006, në të cilën përcaktohet se: “... shtetasi A.Ç. është pronar i një trualli me sip. 300 m² nga i cili 109 m² janë ndërtesë. Në pallatin që do të ndërtohet në këtë pronë do t'i shesë palës Ermir Lelçi një apartament banimi 3+1, të ndodhur në katin e 3 (kati i dytë i banimit) me sip. +/-148.3 m². Palët kanë rënë dakord që vlera totale e apartamentit do të jetë 6.200.000 lekë. +/-148.3 m². Sot, pala Ermir Lelçi likuidoi shumën 1.000.000 lekë të reja që është kësti i parë. Kësti i dytë do të paguhet në datën 7.6.2006, me vlerë 1.400.000 lekë dhe kësti i tretë prej 3.800.000 lekësh do të paguhet me dorëzimin e çelësave dhe me dhënien e tapisë”.

1.3. Më pas, ndërmjet shtetasit A.Ç., në cilësinë e shitësit, dhe shtetasve N.L. dhe Ermir Lelçi, në cilësinë e blerësve, është lidhur kontrata e shitblerjes me rezervë pasuri e paluajtshme “apartament banimi” nr. ***, datë 7.5.2007. Në nenin 4 të saj parashikohet se në marrëveshje mes palëve kontraktuese, çmimi i shitjes së kësaj pasurie të paluajtshme është 6.200.000 lekë, shumë e cila do të likuidohet nga pala blerëse nëpërmjet kredisë së marrë nga “Tirana Bank”.

1.4. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja Shkodër⁹ rezulton se shtetasit Ermir dhe N.L. kanë në pronësi apartamentin me nr. pasurie ***. Gjithashtu, ASHK-ja Shkodër ka përcjellë edhe kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me nr. ***, datë 6.6.2007 (të paraqitur edhe nga subjekti në deklaratën *Vetting*), me objekt shitjen e apartamentit të banimit me sip. 138 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, në lagjen “****”, Shkodër, të lidhur ndërmjet shtetasit A.Ç., në cilësinë e shitësit, dhe shtetasve N. dhe Ermir Lelçi, në cilësinë e blerësve. Kontrata parashikon se shtetasit N.L. i kalon pronësia e 2/3 pjesë dhe shtetasit Ermir Lelçi 1/3 pjesë. Në këtë kontratë përcaktohet çmimi i shitjes në vlerën 6.200.000 lekë, i cili është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.

1.5. Për sa i përket momentit të fillimit të banimit në këtë apartament, në pyetësin standard¹⁰ subjekti deklaron se: “[...] Nga muaji maj i vitit 2007 banoj në lagjen nr. *** (***), rruga ‘***’, pallati nr. *** [...]”. Gjithashtu, referuar përgjigjeve të subjektit në këtë pyetësor, në vitin 2007 ka shpenzuar për mobilim shumën 465.000 lekë.

1.6. Me anë të pyetësit nr. 2¹¹, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit se përse nuk ka deklaruar kontratën e kaparit dhe pagesat në DIPP-në e vitit 2006. Në përgjigje¹², subjekti sqaron se pagesat janë bërë nga babai i tij dhe ka vlerësuar se nuk kishte detyrim ligjor për t'i deklaruar, pasi referuar edhe kontratës së shitblerjes me rezervë nr. ***, datë 7.5.2006¹³, është përcaktuar pjesa takuese e pronësisë ku, konkretisht, z. N.L. me 2/3 pjesë dhe z. Ermir Lelçi me 1/3. Pjesa takuese e pronësisë prej 1/3 do të krijohej në këstin e fundit dhe, konkretisht, me marrjen e shumës së kredisë prej 2.100.000 lekësh nga “Tirana Bank”, vijoi subjekti.

1.7. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *deklarimi i subjektit në DIPP-në e vitit 2006*

pronës nga barra hipotekore; (14) vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 13.6.2007, për pasurinë nr. ***, z. k. ***, me sip. 138 m², lëshuar në datën 4.2.2009.

⁸Shkresë e datës 27.5.2021.

⁹Shkresa nr. *** prot., datë 17.2.2020.

¹⁰E-mail i datës 13.1.2020.

¹¹E-mail i datës 21.7.2021.

¹²Shpjegime datë 28.7.2021.

¹³Kontrata me rezervë nr. *** mban datën 7.5.2007.

nuk është i saktë dhe në përputhje me germën “dh”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, pasi nuk ka deklaruar detyrimet financiare ndaj shtetasit A.Ç.

1.8. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁴ subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se shuma në të holla prej 1.000.000 lekësh, që është përmendur në kontratën e kaparit të datës 7.2.2006, si dhe të gjitha këstet e blerjes së apartamentit, me përjashtim të kredisë së marrë në “Tirana Bank”, në shumën 2.100.000 lekë, në vitin 2007, janë paguar nga babai i tij dhe në këto kushte rezulton qartë se realisht nuk ka pasur detyrime financiare ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. në vitin 2006 dhe ka vlerësuar se nuk kishte shkak ligjor për të deklaruar detyrimet e babait të tij për blerjen e apartamentit me këste. Në vijim, subjekti sqaron se në DIPP-në e vitit 2007 ka dorëzuar dokumentacionin që vërteton blerjen e apartamentit dhe nuk rezulton që të jetë thirrur nga ILDKPKI-ja për të dhënë sqarime apo të jetë dhënë ndonjë masë administrative. Gjithashtu, sqaron se në DIPP-në e vitit 2007 ka deklaruar kontratën e kredisë në “Tirana Bank” për shtëpi dhe mospasqyrimi i të dhënave të kontratës së kaparit ka ndodhur për shkak të moskuptimit të ligjit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.9. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

1.10. Pretendimi i subjektit se nuk kishte shkak ligjor për të deklaruar detyrimet e babait të tij për blerjen e apartamentit me këste, pasi shuma në të holla prej 1.000.000 lekësh, paguar sipas kontratës së kaparit të datës 7.2.2006, si dhe të gjitha këstet e blerjes së apartamentit janë paguar nga babai i tij dhe në këto kushte rezulton qartë se realisht nuk ka pasur detyrime financiare ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. në vitin 2006, nuk është i bazuar në prova dhe fakte të analizuara në procesin e rivlerësimit.

1.11. Bazuar në kontratën e kaparit të datës 7.2.2006, rezulton se subjekti i rivlerësimit është nënshkruesi i kësaj kontrate dhe, për rrjedhojë, ka marrë përsipër të gjitha detyrimet që lindin nga kjo kontratë, përfshirë dhe elementin thelbësor të kësaj kontrate siç është edhe detyrimi për pagimin e kësteve sipas parashikimeve të kësaj kontrate. Fakti që ka qenë babai që ka paguar këstet, nuk e shkarkon përgjegjësinë që ka pasur subjekti i rivlerësimit si subjekt deklarues parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, për vitin 2006. Ky ligj parashikon se: *“Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si vijon: (a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil; [...] (dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj; [...].* Nga analizimi i kësaj dispozite, evidentohet qartë detyrimi që ka pasur subjekti për deklarimin e të drejtës reale dhe detyrimet financiare që rridhnin nga kjo e drejtë reale. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte deklaruar në DIPV-në e vitit 2006 të drejtat reale dhe detyrimet që rridhnin nga kjo e drejtë pavarësisht se kush ishte personi që kishte ekzekutuar/paguar këstet e rena dakord në kontratën e firmosur nga subjekti.

¹⁴Shpjegime të subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi, datë 22.10.2021 (nr. *** prot., datë 22.10.2021, në Komision).

Për më tepër që babai i subjektit nuk ishte palë në kontratën e kaparit, por është përfshirë si bashkëpronar në kontratën e shitblerjes së vitit 2007.

1.12. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin të drejtat reale mbi këtë apartament, si dhe detyrimet që rridhnin nga kjo kontratë në DIPP-në e vitit 2006, vlerësuar kjo në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e kësaj pasurie.

1.13. Gjatë hetimit, Komisioni konstatoi disa mospërputhje lidhur me dokumentacionin provues të pagesave të kryera, të cilat u analizuan si vijon.

1.14. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur: (i) transfertë bankare nga llogaria e z. N.L. në llogarinë e z. A.Ç. në datën 7.2.2006, në shumën 1.000.000 lekë, me përshkrimin “trn në llogarinë e A. Ç. nga N.L., kësti i parë për blerje Ermir Lelçi”; dhe (ii) mandatarkëtimi nr. ***, datë 14.6.06, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., arkëtuar dhe nënshkruar nga z. N.L., në shumën 1.400.000 lekë, me përshkrimin “arkëtoj për blerje pallat 3+1, kati ****”¹⁵; (iii) e më tej në dosjen e ILDKPKI-së¹⁶ është administruar transfertë bankare nga llogaria e z. N.L. në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. në datën 8.6.2007, shuma 1.390.000 lekë, me përshkrimin “kësti II blerje apartamenti Ermir Lelçi” dhe transfertë bankare nga llogaria e z. Ermir Lelçi në llogarinë e z. A.Ç. në datën 27.6.2007, në shumën 2.100.000 lekë, me përshkrimin “blerje apartamenti”.

1.15. Shoqëria “****” sh.p.k.¹⁷ vuri në dispozicion të Komisionit këto dokumente: (i) kontratën e kaparit nr. ***, datë 7.2.2006; (ii) kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 7.5.2007; (iii) transfertën bankare nga llogaria e z. N.L. në llogarinë e z. A.Ç., datë 7.2.2006, në shumën 1.000.000 lekë; (iv) mandatarkëtimin nr. ***, datë 14.6.2006, në shumën 1.400.000 lekë; (v) mandatarkëtimin¹⁸ nr. ***, datë 3.7.2007, ku pasqyrohet se shtetasi N.L. ka paguar shumën 1.670.000 lekë për “këst parapagim për pallat”; (vi) mandatarkëtimin nr. ***, datë 3.7.2007, ku pasqyrohet se nga shtetasi S.L. është arkëtuar shuma 30.000 lekë për llogari të z. N.L.; (vii) transfertën bankare nga llogaria e shtetasit Ermir Lelçi në llogarinë e z. A.Ç. në datën 27.6.2007, në shumën 2.100.000 lekë. Rezulton se shuma totale e pagesave bazuar në këtë dokumentacion është 6.200.000 lekë.

1.16. ILDKPKI-ja¹⁹ ka përcjellë në Komision procesverbalin e datës 20.1.2016, ku subjekti i rivlerësimit, ndërmjet të tjerave, ka deklaruar se me hartimin e kontratës së shitjes në datën 6.6.2007 është likuiduar edhe kësti i fundit me vlerë 310.000 lekë. Më pas, subjekti deklaroi se burimi i shumës prej 6.200.000 lekësh janë të ardhurat e përfituara nga babai nga shitja e bagëtive prej vitit 1992 e në vijim, ku gjatë kësaj periudhe kohe ka shfrytëzuar një sipërfaqe toke të njohur nga Komuna D., sipas kufijve të vjetër, sipërfaqe të cilën e shfrytëzon dhe aktualisht për bagëtinë dhe se nuk ka kontribuar aspak në pagesën e blerjes së këtij apartamenti dhe se pagesat janë kryer prej tij në vitet 2006 dhe 2007. Lidhur me arsyen e deklaramit të pjesës takuese prej 33%, subjekti ka shpjeguar se kur është hartuar kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 6.6.2007, do të paguante pjesën 2.100.000 lekë, shumë e cila u tërhoq nga kredia dhe më pas u shlye nga kursimet e babait.

1.17. Në vijim të shpjegimeve të dhëna në ILDKPKI, subjekti ka paraqitur kontratën e kaparit nr. ***, datë 7.2.2006, dhe mandatpagesat e bëra nga babai i tij N.L. në datën 7.2.2006, në

¹⁵Aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së, paraqitur nga subjekti.

¹⁶Aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁷Shkresa me nr. *** prot., datë 15.6.2021.

¹⁸Dokumenti është “mandatpagesë”, por tek dhënësi është shënuar “N.L.” dhe te shkresa përcjellëse është cituar si mandatarkëtimi.

¹⁹Shkresa nr. *** prot., datë 2.6.2021.

shumën 1.000.000 lekë, në datën 14.6.2006 në shumën 1.400.000 lekë, në datën 8.6.2006, në shumën 1.390.000 lekë, si dhe mandatpagesën e datës 27.6.2007 në shumën 2.100.000 lekë, me burim kredie të marrë nga “Tirana Bank”. Shuma totale e pagesave bazuar në këto shpjegime është 6.200.000 lekë.

1.18. Duke krahasuar dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në procesverbalin e ILDKPKI-së me atë të përcjellë nga shoqëria “***” sh.p.k., si edhe atë të administruar nga hetimi, Komisioni konstatoi disa mospërputhje, të analizuara në vijim:

1.19. *Lidhur me pagesën e parë, në shumë 1.000.000 lekë, datë 7.2.2006, e parashikuar në kontratën e kaparit, Komisioni vëren se në këtë kontratë citohet se pala Ermir Lelçi likuidoi shumën 1.000.000 lekë të reja, ndërkohë që nga dokumentacioni i administruar nga “Tirana Bank” rezulton se në të njëjtën datë babai i subjektit ka kryer një transfertë po në të njëjtën shumë me përshkrimin “trn në llogarinë e z. A.Ç. nga z. N.L., kësti i parë për blerje Ermir Lelçi. Shuma 1.000.000 ALL”. Shoqëria “***” sh.p.k. konfirmon si pagesë transfertën bankare.*

1.20. Nga hetimi i origjinës së këtyre fondeve konstatohet se babai i subjektit ka depozituar në llogaritë e tij në “Tirana Bank” shumën 1.000.000 lekë, në datën 19.3.2003, me përshkrimin “dep-depozitë në arkë derdhje nga z. N.L. Shkodër” dhe vlerën 1.270.000 lekë, në datën 6.12.2005, me përshkrimin “dep-depozite në arkë derdhje nga z. N.L. Shkodër”, depozitime që kanë shërbyer si burim për transfertën e datës 7.2.2006, në vlerën 1.000.000 lekë.

1.21. *Lidhur me pagesën e shumës 1.400.000 lekë, e parashikuar në kontratën e kaparit, Komisioni vëren se në këtë kontratë citohet se kësti i dytë do të paguhet në datën 7.6.2006, në vlerën 1.400.000 lekë. Nga dokumentacioni i administruar nga “Tirana Bank” rezulton se në datën 8.6.2006 shtetasi N.L. ka kryer një transfertë në shumën 1.390.000 lekë me përshkrimin “kësti II, blerje apartamenti Ermir Lelçi”. Shoqëria “***” sh.p.k. konfirmon vetëm mandatin nr. ***, datë 14.6.2006, në vlerën 1.400.000 lekë. Ndërkohë që subjekti, në deklaratimet e tij në ILDKPKI ka paraqitur transfertën bankare në vlerën 1.390.000 lekë dhe mandatin në vlerën 1.400.000 lekë.*

1.22. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 2²⁰, i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me mospërputhjen e mësipërme dhe, në përgjigje, subjekti deklaroi se: *“Lidhur me shpjegimet që janë fiksuar në procesverbalin e datës 20.1.2016, nuk kam pasur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, kjo për shkak se babai ka kryer veprimet përkatëse të likuidimit të shumave siç rezulton edhe nga dokumenti ‘vërtetim’, i datës 24.2.2021 dhe kjo ka krijuar një konfuzion në rastin konkret dhe nga ana e inspektoreve janë mbledhur shumat prej 1.390.000 lekësh me shumën prej 1.400.000 lekësh ku, në fakt, kemi të bëjmë vetëm me shumën 1.400.000 lekë, shumë e cila rezulton të jetë transferuar nga babai im N.L. nga ‘Tirana Bank’ në shumën 1.390.000 lekë dhe shuma e mbetur prej 10.000 lekësh i është shlyer shoqërisë ‘***’ sh.p.k. te zyra e saj. Në këto kushte, pala shitëse, për të dokumentuar pagimin e kështit të dytë prej 1.400.000 lekësh, ka lëshuar mandatarkëtimin e datës 14.6.2006. Për sa parashtrova më sipër, del qartë se mungesa e disa dokumenteve, mandatarkëtimi, të cilat babai im nuk i dispononte në periudhën kur jam ftuar për të dhënë sqarimet përkatëse, ka sjellë si rezultat edhe këto mospërputhje dhe është e qartë se ka qenë e pamundur objektivisht të sqarohesh saktë inspektorja e ILDKPKI-së, disponoja të gjitha mandatarkëtimet”. Subjekti ka paraqitur bashkëlidhur dokumentacionin provues²¹.*

²⁰E-mail datë 21.7.2021.

²¹Gjendje llogarie nga “Tirana Bank” për z. N.L. për periudhën 1.1.2006-31.12.2006; (24) konfirmim nr. ***, datë 23.7.2021, nga “Tirana Bank”.

1.23. Në pyetësin nr. 3²², Komisioni i kërkoi subjektit të paraqiste vërtetimin e datës 24.2.2021, të lëshuar nga shoqëria “***” sh.p.k., të cituar në pyetësin nr. 2. Në përgjigje²³, subjekti vuri në dispozicion të Komisionit vërtetimin e datës 24.2.2021, të shoqërisë “***” sh.p.k., nëpërmjet së cilës kjo shoqëri vërtetoi se: “... shtetasi N.L. ka kryer pagesat për blerjen e apartamentit sipas kontratës së shitblerjes pasuri e paluajtshme apartament banimi. Në datën 7.2.2006 ka likuiduar shumën 1.000.000 lekë; në datën 7.6.2006 ka likuiduar shumën 1.400.000 lekë; në datën 3.7.2007 ka likuiduar shumën 1.670.000 lekë; në datën 3.7.2007 ka likuiduar shumën 30.000 lekë”.

1.24. Lidhur me origjinën e fondeve të përdorura për transfertën nga llogaria bankare e babait të subjektit, Komisioni konstaton se shuma e mbetur në llogari pas veprimeve të përshkruara në paragrafin 1.21, së bashku me një depozitim në vlerën 300.000 lekë, datë 8.6.2006, janë përdorur për transfertën e datës 8.6.2006, në shumën 1.390.000 lekë.

1.25. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *subjekti i rivlerësimit ka paguar 1.390.000 lekë më shumë për apartamentin dhe jo 6.200.000 lekë sikundër deklaroi subjekti, pasi konstatohet se një pagesë është bërë në bankë në datën 8.6.2006, në shumën 1.390.000 lekë dhe një pagesë e kryer me mandatarkëtim, lëshuar nga shoqëria në datë, 14.6.2006, në shumën 1.400.000 lekë.*

1.26. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁴ subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se mospërputhja e datës së pagesës nuk është e vërtetë, pasi për sqarimin e këtij pretendimi i është drejtuar shoqërisë “***” sh.p.k. dhe ka marrë një vërtetim, ku në përmbajtjen e tij pasqyrohet se shuma e përmendur prej 1.400.000 lekësh të mandati i datës 14.6.2006, është ekuivalente me shumën e paguar prej 1.390.000 lekësh në “Tirana Bank” plus shumën 10.000 lekë, të paguar *cash* nga shtetasi N.L. dhe se shuma totale e paguar për blerjen e apartamentit është 6.200.000 lekë. Fakti i pagesës në bankë i shumës 1.390.000 lekë provohet edhe nga dokumenti “nxjerrje llogarie” e shtetasit N.L., nga “Tirana Bank”, me datë printimi të dokumentit 14.10.2019, ku rezulton i përshkruar veprimi i transfertës së shumës 1.390.000 lekë. Me këto prova shkresore rezulton e provuar se nuk është paguar më tepër shuma 1.390.000 lekë, por kjo shumë është paguar për llogari të këstit të dytë në bankë plus 10.000 lekë, paguar *cash* dhe për të vërtetuar faktin e pagesës së këstit të dytë të përmendur në kontratën e kaparit është lëshuar edhe mandati i datës 14.6.2006.

1.27. Trupi gjykues, pas analizimit të vërtetimit të paraqitur nga subjekti në prapësimet e barrës së provës nga shoqëria “***” sh.p.k., e cila vërtetoi se shuma e përmendur prej 1.400.000 lekësh në mandatin e datës 14.6.2006 është ekuivalente me shumën e paguar prej 1.390.000 lekësh, në “Tirana Bank” plus shumën 10.000 lekë të paguar *cash* nga shtetasi me rezultatet e hetimit dhe e vlerësuar kjo në harmoni me vlerën e çmimit të tregut sipas EKB-së, i cili është pothuajse në vlerën e përcaktuar në kontratë, vlerëson se subjekti i rivlerësimit provoi se çmimi i shitjes së apartamentit është në vlerën 6.200.000 lekë dhe se nuk është paguar më tepër shuma 1.390.000 lekë, por kjo shumë është paguar për llogari të këstit të dytë në bankë plus 10.000 lekë, paguar *cash* dhe për të vërtetuar faktin e pagesës së këstit të dytë të përmendur në kontratën e kaparit është lëshuar edhe mandati i datës 14.6.2006.

²²E-mail datë 8.9.2021.

²³Lista e dokumenteve të subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi, datë 13.9.2021 (nr. *** prot., datë 13.9.2021, në Komision)

²⁴Shpjegime të subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi, datë 22.10.2021 (nr. *** prot., datë 22.10.2021, në Komision).

1.28. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit konkludon se subjekti provoi se çmimi i paguar për këtë apartament është 6.200.000 lekë sipas kontratës së shitblerjes dhe se deklarimi i subjektit lidhur me vlerën e apartamentit përputhet me dokumentacionin justifikues.

1.29. Në vijim, Komisioni, në zbatim të neneve 30 dhe 45 të ligjit nr. 84/2016, hetoi deklarimet e subjektit të rivlerësimit mbi marrëdhënien që ka pretenduar se ka me këtë pasuri.

1.30. Nga dokumentacioni i dorëzuar në deklaratën *Vetting* dhe të administruar nga notere V.H.²⁵, rezulton se ndërmjet shtetasve A.Ç. dhe Ermir Lelçi është lidhur kontrata e kaparit nr. ***, datë 7.2.2006, në të cilën parashikohet se: *“Palët kanë rënë dakord që vlera totale e apartamentit do të jetë 6.200.000 lekë dhe sot, pala Ermir Lelçi likuidoi shumën 1.000.000 lekë të reja që është kësti i parë. Kësti i dytë do të paguhet në datën 7.6.2006, me vlerë 1.400.000 lekë dhe kësti i tretë prej 3.800.000 lekësh do të paguhet me dorëzimin e çelësave dhe me dhënien e tapisë”*.

1.31. Me anë të pyetësorit nr. 2²⁶, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit se përse në kontratën e kaparit figuron si blerës vetëm ai dhe jo babai i tij. Në përgjigje²⁷, subjekti sqaron se është një pakujdesi e noterit, i cili nuk e ka përfshirë si palë në këtë kontratë kapari, pavarësisht se i është vënë në dispozicion mandatarkëtimi i shumës 1.000.000 lekë, të depozituar nga shtetasi N.L.

1.32. Dokumentacioni i administruar nga “Tirana Bank”²⁸ konfirmon se nga llogaria e shtetasit N.L., në datën 7.2.2006, është transferuar shuma 1.000.000 lekë, me përshkrimin “transfera në llogarinë e A. Ç. nga N.L., kësti i parë për blerje Ermir Lelçi” dhe në datën 8.6.2006 është transferuar shuma 1.390.000 lekë, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. me përshkrimin “kësti II, blerje apartamenti Ermir Lelçi”. Gjithashtu, subjekti, bashkë me deklaratën *Vetting* ka dorëzuar mandatarkëtimin nr. ***, datë 14.6.2006, me shënimin “... arkëtuar nga N.L., shuma 1.400.000 lekë, me përshkrimin ‘arkëtoj për blerje pallat 3+1, kati III’, i firmosur dhe vulosur nga shoqëria ‘****’ sh.p.k., A.Ç.’ dhe nga arkëtari N.L.”.

1.33. Shoqëria “****” sh.p.k.²⁹ ka vënë në dispozicion të Komisionit: (i) dokumentin nga “Tirana Bank” “transfertë në llogari”, ku pasqyrohet se shtetasi N.L. ka transferuar në datën 7.2.2006, në llogari të shtetasit A.Ç. shumën 1.000.000 lekë; (ii) mandatarkëtimin nr. *** (data nuk lexohet) ku pasqyrohet se shtetasi N.L. ka arkëtuar shumën 1.400.000 lekë për blerje pallati në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.; (iii) mandatpagesën nr. ***, datë 3.7.2007, ku pasqyrohet se shtetasi N.L. ka paguar shumën 1.670.000 lekë dhe si marrës pasqyrohet shoqëria “****” sh.p.k. dhe shtetasi A.Ç.; (iv) mandatarkëtimin nr. ***, datë 3.7.2007, ku pasqyrohet se nga shtetasi S.L. është arkëtuar shuma 30.000 lekë për llogari të shtetasit N.L., me arkëtar shoqërinë “****” sh.p.k., z. A.Ç.

1.34. Në pyetësin nr. 2³⁰ Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit se pse disa pagesa i janë kryer shoqërisë “****” sh.p.k. dhe jo shtetasit A.Ç. Në përgjigje³¹, subjekti shpjegon se pagesat janë kryer nga babai i tij N.L. dhe ai i ka bërë pagesat sipas orientimit që ka pasur nga pala shitëse. Gjithashtu, sqaron se shtetasi A.Ç. është bashkëshort i shtetasës B. Ç., e cila ka qenë

²⁵Shkresë e datës 27.5.2021.

²⁶E-mail datë 21.7.2021.

²⁷Shpjegime datë 28.7.2021.

²⁸(1) Shkresa nr. *** prot., datë 16.1.2020; (2) nxjerrje llogarie e shtetasit N.L. për periudhën 1.12.2006 – 31.12.2006.

²⁹(1) Shkresa me nr. *** prot., datë 15.6.2021; (2) transfertë në llogarinë e “Tirana Bank” e datës 7.2.2006, e shtetasit N.L.; (3) mandatarkëtimi nr. *** (data nuk lexohet), i shoqërisë “****” sh.p.k.; (4) mandatpagese nr. ***, datë 3.7.2007, lëshuar nga shtetasi A.Ç.; (5) mandatarkëtimi nr. ***, datë 3.7.2007, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k.; (6) transfertë në llogarinë e “Tirana Bank”, e datës 27.6.2007.

³⁰E-mail datë 21.7.2021.

³¹Shpjegime datë 28.7.2021.

administratore e shoqërisë “****” sh.p.k. Fakti që kjo shoqëri ka paraqitur dokumentacionin lidhur me transfertat bankare dhe mandatarëtimet konfirmon se ka qenë shtetasi A.Ç. që ka orientuar blerësin për të kryer transfertat e parave tek numrat e llogarisë që ka kërkuar.

1.35. Më pas ndërmjet shtetasit A.Ç., në cilësinë e shitësit dhe shtetasve N. dhe Ermir Lelçi, në cilësinë e blerësve, është lidhur kontrata e shitblerjes me rezervë pasuri e paluajtshme apartament banimi, nr. ***, datë 7.5.2007, me objekt shitjen me rezervë të pasurisë së paluajtshme apartament banimi me sip. totale 138 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, e ndodhur në lagjen “****”, Shkodër, në favor të shtetasit N.L. me 2/3 pjesë dhe shtetasi Ermir Lelçi me 1/3 pjesë. Neni 4 i kësaj kontrate parashikon: “Në marrëveshje në mes palëve kontraktuese çmimi i shitjes së kësaj pasurie të paluajtshme është 6.200.000 lekë, shumë e cila do të likuidohet nëpërmjet kredisë së marrë nga ‘Tirana Bank’”.

1.36. ASHK-ja Shkodër³² ka përcjellë në Komision kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me nr. ***, datë 6.6.2007 (të paraqitur dhe nga subjekti në deklaratën *Vetting*) me objekt shitjen e apartamentit të banimit me sip. 138 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, të ndodhur në lagjen “****”, Shkodër, e lidhur ndërmjet shtetasit A.Ç., në cilësinë e shitësit dhe shtetasve N. dhe Ermir Lelçi, në cilësinë e blerësve. Kontrata parashikon se shtetasi N.L. i kalon pronësinë e 2/3 pjesë dhe shtetasit Ermir Lelçi 1/3 pjesë. Në këtë kontratë përcaktohet çmimi i shitjes në vlerën 6.200.000 lekë dhe se shuma është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.

1.37. Lidhur me pagesat e fundit, në shumën totale prej 1.700.000 lekësh, të përcjella nga shoqëria “****” sh.p.k., të dokumentuara me mandatet nr. *** dhe nr. ***, datë 3.7.2007 (1.670.000 lekë) dhe nr. ***, datë 3.7.2007 (30.000 lekë) konstatohet se këto pagesa nuk janë cituar nga subjekti as në deklaratën *Vetting* dhe as në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI. Subjekti ka përmendur një pagesë në vlerën 310.000 lekë, në datën 6.6.2007, të kryer *cash*, e cila nuk është konfirmuar nga shoqëria.

1.38. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se për blerjen e apartamentit në bashkëpronësi ka marrë kredi në “Tirana Bank”, dega Shkodër, në shumën 2.100.000 lekë, me kontratën nr. ***, datë 21.6.2007 dhe shuma e kredisë është shlyer në datën 16.1.2009, nga babai tij N.L., sipas mandatit të lëshuar nga banka.

1.39. Nga shqyrtimi i DIPP-së vjetore rezulton se subjekti ka bërë këto deklarime: (i) në DIPP-në e vitit 2007 ka deklaruar kontratë kredie nr. ***, datë 21.6.2007, afatgjatë në “Tirana Bank” për shtëpi, në shumën 2.100.000 lekë, 9.75%, për 20 vjet dhe janë shlyer 6 muaj në shumën 120.600 lekë; (ii) në DIPP-në e vitit 2008 ka deklaruar të njëjtën kredi dhe shlyerje në shumën 204.000 lekë; dhe (iii) në DIPP-në e vitit 2009 deklaroi shlyerje të plotë të kredisë në shumën 2.110.000 lekë, në datën 16.1.2009, nga shtetasi N.L.

1.40. “Tirana Bank”³³ konfirmon kontratën e kredisë bankare afatgjatë për shtëpi nr. ***, datë 21.6.2007, me palë kredimarrëse shtetasit Ermir dhe N.L., ku përcaktohet se: “Banka jep tek kredimarrësi: (a) kredi në shumën 2.100.000 lekë, që do të përdoret për blerje banese; dhe (b) kredi në shumën 120.000 lekë që do të përdoret si garanci për limitin e një karte krediti Visa Card, në emër të kartëmbajtësit Ermir Lelçi”. Kohëzgjatja e kredisë është 20 vjet dhe si kolateral është vendosur apartamenti me sip. 138 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. ***, datë 13.6.2007³⁴. Sipas vërtetimit të ZVRPP-së Shkodër rezultoi se në datën 25.6.2007 është regjistruar hipoteka mbi pasurinë e mësipërme.

³²Shkresa nr. *** prot., datë 17.2.2020.

³³Shkresa me nr. *** prot., datë 16.1.2020.

³⁴Kontratë hipotekimi nr. ***, datë 21.6.2007, me hipotekues Ermir dhe N.L.

1.41. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarive të përcjella rezultuan këto transaksione bankare: (i) Kredia është disbursuar në datën 26.6.2007, në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, në vlerën 2.100.000 lekë dhe në datën 27.6.2007 është kryer transfera në të njëjtën shumë, në favor të shtetasit A.Ç. me përshkrimin “blerje apartamenti”; (ii) gjatë vitit 2007 janë paguar nga subjekti i rivlerësimit principlali, interesa dhe komisione në shumën 141.694 lekë; (iii) gjatë vitit 2008 janë paguar nga subjekti i rivlerësimit principlali, interesa, prime dhe komisione në shumën 269.336 lekë.

1.42. Në datën 16.1.2009, në llogarinë e subjektit janë transferuar 2.110.000 lekë nga babai i tij N.L., me përshkrimin “për shlyerje kredie”. Duke analizuar llogarinë bankare të babait, konstatohet se si burim për këtë shumë kanë shërbyer kryesisht dy depozitime, konkretisht, në shumën 1.250.000 lekë³⁵ në datën 16.1.2008 dhe në shumën 800.000 lekë në datën 16.1.2009. Po në datën 16.1.2009 është kryer pagesa e plotë për mbylljen e kredisë (principlali, interesa dhe komisione) në shumën totale prej 2.075.286 lekësh³⁶.

1.43. Nga shqyrtimi i dokumenteve të mësipërme, Komisioni konstatoi se sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 6.6.2007, shuma 6.200.000 lekë është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale, ndërkohë që pagesa prej 2.100.000 lekësh, me burim kredinë në “Tirana Bank” është kryer në datën 27.6.2007, pra pas nënshkrimit të kontratës.

1.44. Lidhur me këtë mospërputhje, Komisioni, në pyetësin nr. 2³⁷ kërkoi shpjegime nga subjekti, i cili në përgjigje³⁸, shpjegon se fakti i marrjes së kredisë është parashikuar qartësisht në kontratën e shitjes me rezervë nr. ***, datë 7.5.2007, në nenin 4. Në vijim, deklaroi se ishte pala shitëse A.Ç. që do të përfitonte shumën dhe se kontrata (e shitjes) është nënshkruar prej tij dhe babai i tij në mirëbesim, duke menduar se kjo kontratë do të shërbente për marrjen e shumës së kredisë nga “Tirana Bank”. Pretendimi i palës shitëse në kontratë se ishte likuiduar e gjithë shuma prej 6.200.000 lekësh jashtë zyrës së noterit nuk është i vërtetë, pasi ende nuk ishte marrë kredia nga “Tirana Bank”. Pavarësisht nga përmbajtja e kontratës, është e rëndësishme të shqyrtohet dhe të vlerësohet nëse pala blerëse ka përfituar nga deklaratatë fiktive e palës shitëse. Sipas tij, pala blerëse edhe sikur të ishte në dijeni të deklaratës fiktive të kontratës së shitjes, nuk e ka pranuar realisht, pasi ka shkuar te “Tirana Bank” rreth 15 ditë më pas dhe ka nënshkruar kontratën e kredisë nr. ***, datë 21.6.2007, si dhe kontratën e hipotekimit nr. ***, datë 21.6.2007 dhe transfera të shumës 2.100.000 lekë në favor të shitësit A.Ç. është bërë në datën 27.6.2007. Gjithashtu, në datën 3.7.2007 nga babai i tij është likuiduar shuma 1.700.000 lekë. Subjekti ka paraqitur dokumentin “konfirmim bankar”, të “Tirana Bank”³⁹ që konfirmon se: *“Shtetasit Ermir dhe N.L. janë financuar nga ‘Tirana Bank’, me një kredi në shumën 2.100.000 lekë sipas kontratës për kredi bankare afatgjatë me ref nr. ***, datë 21.6.2007, nr. **. Kjo shumë është përdorur për likuidimin e kështit të tretë të blerjes së pasurisë së paluajtshme të llojit apartament nr. **, z. k. **, pasuri e cila ka shërbyer edhe si garanci për këtë kredi sipas kontratës së hipotekimit nr. **, datë 21.6.2007”*.

1.45. Komisioni, me anë të pyetësit nr. 3⁴⁰, i kërkoi subjektit të japë shpjegime se cila ka qenë arsyeja që prindërit e tij kanë investuar në blerjen e apartamentit me sip. 138 m², në qytetin

³⁵Kjo shumë fillimisht është kaluar në dy depozita 1-vjeçare, konkretisht, 875.000 lekë dhe 375.000 lekë, të cilat janë maturuar në datë 16.1.2009 dhe kanë shërbyer si burim për transferatën në shumën 2.110.000 lekë.

³⁶Tri transaksione: (1) vlera 10.252 lekë me përshkrimin “com-komisione/tarifa shlyerje parakohe e kredise”; (2) vlera 14.652 lekë me përshkrimin “pagese int kredi shtëpie (klient) shlyerje para kohe e kredisë”; (3) vlera 2.050.382 lekë me përshkrimin “pagese princ. kredi shtëpie (klient) shlyerje para kohe e kredisë”.

³⁷E-mail, datë 21.7.2021.

³⁸Shpjegime datë 28.7.2021.

³⁹Nr. *** prot., datë 23.7.2021.

⁴⁰E-mail datë 8.9.2021.

e Shkodrës, përderisa ata, sipas deklarimeve të subjektit në pyetësin nr. 2, jetojnë në fshatin Mali i Gjymtit, për shkak të ushtrimit të aktivitetit blegtoral.

1.46. Në përgjigje⁴¹, subjekti shpjegon se ka pasur si qëllim që prindërit e tij të largoheshin nga fshati në qytet për të pasur një jetë më komode gjatë pleqërisë së tyre dhe, pasi u vu në dijeni se afër punës së tij po ndërtohej një pallat, në konsultim me babain vendosën që të shikonin mundësinë e blerjes. Gjithashtu, subjekti shpjegon se është interesuar për të përfituar kredi të butë, por pa rezultat. Më pas ka kontaktuar me personin që po ndërtonte pallatin dhe meqë kishte si qëllim të merrte prindërit e tij, ka rënë dakord për një hyrje (me tri dhoma dhe një kuzhinë). Nga babai i tij i është ofruar mundësia të kontribuonte me një shumë të konsiderueshme, ndërsa për pjesën tjetër do të merrej kredi nëse do të ishte e mundur. Për shkak të marrëdhënieve shumë të mira që kishte me prindërit, duke pasur si shqetësim shëndetin e tyre, u mundua t'i bindë të pranonin të vinin në qytet, por babai i tij nuk ishte dakord të linte fshatin, pasi ishte shumë i lidhur me të. Pavarësisht këtij qëndrimi, ai ishte dakord që të blihej apartamenti (me tri dhoma dhe një kuzhinë). Në vijim, subjekti sqaron se i ka bërë të qartë babait se apartamenti do të regjistrohej në emrin e të dyve, duke përcaktuar edhe pjesën e secilit dhe se ai do të merrte kredi dhe pjesa e kredisë do të ishte pjesa e tij takuese. Sipas subjektit, babai i tij ka rënë dakord dhe ka paguar shumën prej 4.100.000 lekësh, ndërsa për pjesën tjetër prej 2.100.000 lekësh ka marrë kredi duke e regjistruar apartamentin në emër të shtetasit N.L. me pjesë 67% dhe Ermir Lelçi me pjesë 33%.

1.47. Nga analizimi i fakteve të mësipërme, Komisioni vëren disa rrethana: (i) nga dokumentacioni i administruar dhe nga shpjegimet e subjektit vërehet se babai i subjektit ka investuar në një pasuri të paluajtshme në Shkodër, ndërkohë që ka banuar dhe vazhdon të banojë në fshat⁴², për shkak të ushtrimit të aktivitetit blegtoral; (ii) në kontratën e kaparit figuron si blerës vetëm subjekti dhe në përshkrimin e dy transfertave të kryera në vitin 2006 nga babai i tij është specifikuar se pagesat janë për shtetasin Ermir Lelçi (“kësti I për blerje Ermir Lelçi” dhe “kësti II për blerje apartamenti Ermir Lelçi”); (iii) kontratat e energjisë elektrike dhe ujësjellësit janë lidhur në emër të subjektit; (iv) subjekti i rivlerësimit ka një marrëdhënie të qëndrueshme dhe të pandërprerë me këtë apartament, duke qenë se subjekti bashkë me familjen kanë jetuar në këtë apartament.

1.48. Rrethanat e mësipërme tregojnë se subjekti, pavarësisht se zotëron vetëm 33% pjesë takuese pa kontribut financiar, është zotëuesi i vetëm i këtij apartamenti, në mënyrë të pandërprerë që nga blerja e tij dhe në vijim dhe duket sikur subjekti është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë të drejtat reale në masën 33% mbi këtë pasuri.

1.49. Për rrjedhojë, Komisioni, bazuar në nenet 30, 45 të ligjit nr. 84/2016⁴³, vlerësoi se është e nevojshme që të analizohet mjaftueshmëria e burimeve financiare të babait të subjektit për pagimin e kësteve të blerjes së apartamentit në shumën 4.100.000 lekë dhe për pagimin e shumës 2.110.000 lekë për mbylljen e parakohshme të kredisë, si vijon:

1.50. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për blerjen e apartamentit janë paguar shuma të ndryshme nga babai i tij N.L., të kursyera nga vetëpunësimi në bujqësi dhe në blegtori që nga viti 1991 e në vijim, një pjesë e të cilave ka qenë depozituar në bankë dhe një pjesë në banesë. Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues në deklaratën *Vetting* lidhur me të ardhurat e përfituara nga babai i tij.

⁴¹Shpjegime datë 13.9.2021.

⁴²Referuar deklaratimit të subjektit në pyetësin nr. 2.

⁴³Neni 30: “Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij”.

Neni 45: “Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit”.

1.51. Në pyetësin standard⁴⁴ subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: (i) vërtetim nr. *** prot., datë 17.6.2009, lëshuar nga Komuna D., Bregu i Bunës, Shkodër, ku konfirmohet se shtetasi N. M. L. ka përfituar sip. 5.7 dynym tokë, në bazë të ligjit nr. 7501 “Për Tokën”; (ii) aktshitblerjen nr. ***, datë 24.6.1999 për blerjen e mjetit zetar në shumën 500.000 lekë, nga blerësi N.L.; (iii) vërtetimin nr. ***, datë 14.10.2019 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shkodër, i cili vërteton se shtetasi N.M.L. figuron i vetëpunësuar në bujqësi që nga viti 1993 dhe ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore sipas viteve, për periudhën 1993 – 2008⁴⁵; (iv) vërtetimin nr. *** prot., datë 19.12.2019, lëshuar nga Njësia Administrative D., ku konfirmohet se familja e shtetasit N.L. ka likuiduar taksat vendore dhe nuk ka detyrime të tjera financiare ndaj Njësisë Administrative D.; (v) dokumentin e printuar në datën 10.10.2019, nga sistemi RUDA, vulosur nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve, ku është përcaktuar kodi i fermës së shtetasit N.L., si dhe numri dhe kodi i kafshëve (5 gjedhë); (vi) të dhënat e printuara në datën 16.10.2019 nga sistemi RUDA⁴⁶, ku është përcaktuar numri dhe kodi i kafshëve (50 dele); (vii) shkresën kthim-përgjigje me nr. *** prot., datë 21.10.2019, lëshuar nga DRT-ja Shkodër, ku, në përgjigje të kërkesës së subjektit sqarohet se regjistrimi me NIPT i fermerëve pranë DRT-ve ka filluar me udhëzimin nr. ***, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”.

1.52. Komisioni kërkoi nga DRSSH-ja Shkodër⁴⁷ informacion lidhur me të ardhurat financiare *bruto* dhe *neto* të realizuara nga shtetasi N. M. L., e cila në përgjigjen e saj⁴⁸ ka përcjellë informacion për pagesat e kryera nga ky shtetas si i vetëpunësuar në bujqësi për periudhën 1993 – 2008.

1.53. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve⁴⁹ informon se ky shtetas nuk rezulton i regjistruar në organin tatimor me aktivitet privat. Po kështu, QKB-ja⁵⁰ bën me dije se shtetasi N. M. L. nuk figuron i regjistruar në regjistrin tregtar.

1.54. Komisioni kërkoi informacion nga Bashkia Shkodër⁵¹ lidhur me taksat vendore të paguara në çdo vit kalendarik, duke specifikuar edhe llojin e secilës taksë për periudhën 1991–2009. Në përgjigje⁵², Bashkia Shkodër bën me dije se janë arritur të gjenden të dhëna vetëm për vitet 2004, 2005, 2006 dhe 2009. Në tabelat e përcjella janë paraqitur: (i) për vitin 2004 pagesa e taksës mbi ndërtesën, taksa e pastrimit dhe e rrugës; (ii) për vitin 2005, pagesa e taksës mbi ndërtesën dhe taksa e pastrimit; (iii) për vitin 2006, pagesa e taksës mbi truallin dhe taksa e pastrimit; (iv) për vitin 2009, pagesa e taksës mbi ndërtesën dhe tokën.

1.55. Gjithashtu është përcjellë informacion lidhur me pagesat e kryera për taksën e ndërtesës së truallit, taksën e tokës bujqësore, si dhe tarifat e pastrimit dhe ndriçimit për periudhën 2016 – 2021.

⁴⁴E-mail datë 13.1.2020.

⁴⁵Për periudhën 1993 – 2000 pagesa është kryer në datën 28.6.2000; për periudhën 2001 – 2006 pagesa është kryer në datën 26.4.2007; për vitin 2007 pagesa është kryer në datat 13.12.2007 dhe 20.12.2007.

⁴⁶Sistemi i Informacionit Blegtoral dhe Veterinar.

⁴⁷Shkresa nr. *** prot., datë 27.5.2021.

⁴⁸Shkresa nr. *** prot., datë 15.6.2021.

⁴⁹Shkresa nr. *** prot., datë 31.5.2021.

⁵⁰Shkresa nr. *** prot., datë 27.1.2020.

⁵¹(1) Shkresa nr. *** prot., datë 27.5.2021; (2) Shkresa nr. *** prot., datë 3.9.2021.

⁵²Shkresa nr. *** prot., datë 22.9.2021.

1.56. Me anë të pyetësorit nr. 2⁵³ subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion lidhur me vlerën e përfituar, kohën dhe mënyrën e përfitimit të këtyre të ardhurave, si edhe shlyerjen e detyrimeve tatimore përkatëse.

1.57. Në përgjigje⁵⁴, subjekti deklaroi se shtetasi N.M.L. ka pasur të drejtë për të përfituar tokë në bazë të ligjit nr. 7501, “Për Tokën”, kjo pasi në regjistrin e gjendjes civile të vitit 1991, përbërja familjare ka qenë me 7 persona dhe ai disponon tokë dhe toka është shfrytëzuar për qëllime bujqësore dhe blegtorale. Në datën 24.6.1999, ka blerë mjetin traktor kundrejt vlerës 500.000 lekë të reja, i cili përdoret ende. Bazuar në ligjin nr. 8702, datë 1.12.2000, “Për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe të fermave blegtorale”, shtetasi N.L. ka regjistruar fermën e tij në vitin 2004. Subjekti vijon duke sqaruar se është regjistruar si fermer me kod ferme ***, me datë identifikimi 3.1.2000 dhe ka mbarështuar të imëta dhe gjedhë që nga viti 1991. Inspektorati veterinar ka regjistruar dhe ka lëshuar dokumentin e identifikimit individual të kafshës “Pasaport” për 8 krerë lopë, me datë lëshimi 21.6.2004. Sipas sistemit të informacionit blegtoral RUDA rezultoi se në datën 1.1.2007 janë regjistruar në emër të fermerit N.L. 50 dele që fillojnë me kod kafshe *** dhe përfundojnë tek numri rendor 50 me kodin ***. Sipas tij, kjo tregon që ky shtetas i ka pasur këto dele shumë vite më parë, por për arsye të ndryshme janë regjistruar në datën 1.7.2007.

1.58. Gjithashtu, deklaroi se pas vitit 2009, shtetasi N.L., përveç gjedhit, ka vazhduar të mbarështojë dele dhe derra, që provohet nga vërtetimi i lëshuar nga Njësia Administrative D., ndërsa sipas sistemit RUDA rezultoi se në vitin 2009 e në vijim janë regjistruar 5 lopë me numrat përkatës të kodit të kafshëve dhe në vitin 2018 janë regjistruar 3 krerë gjedhë: (i) me datë hyrje 26.5.2018, datë dalje 28.5.2018 dhe me shënimin “therje në thertore”; (ii) datë hyrje 26.5.2018, datë dalje 28.5.2018, me shënimin “therje në thertore”; (iii) me datë hyrje 2.9.2018, datë dalje 19.9.2018, me shënimin “therje në thertore”.

1.59. Për vërtetimin e të ardhurave të babait, subjekti ka paraqitur dhe aktvlerësimin e hartuar nga specialisti M.M. dhe mban vulën e Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Qarku Shkodër dhe datën 26.7.2021. Në këtë akt pasqyrohen llogaritjet e vlerave të përfituara nga shtetasi N.L. (nga shitja e viçave, e qingjave dhe vlera e qumështit të prodhuar dhe tregtuar për periudhën 1993 – 2009). Sipas llogaritjeve të bëra, në total të ardhurat e përfituara për periudhën 1993 – 2009 janë në shumën 13.228.400 lekë, konkretisht, 3.825.800 lekë nga shitja e viçave, 8.436.000 lekë nga shitja e qumështit dhe 1.125.000 lekë nga shitja e deleve.

1.60. Në vijim, subjekti deklaroi se prindërit e tij kanë paguar rregullisht kontributet e sigurimeve shoqërore nga viti 1993, si të vetëpunësuar në bujqësi dhe shpenzimet minimale të një të vetëpunësuar në bujqësi janë më të vogla se ajo e një personi tjetër që realizon jetesën e përditshme jo nga shfrytëzimi i tokës bujqësore dhe marrja prej saj e produkteve të së përditshmes për jetesë (kostoja e ushqimit), apo që jeton në zona ku dihet që kostoja është dukshëm më lartë se e jetesës në zona të tjera. Për vërtetimin e deklarimeve të mësipërme subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues⁵⁵.

⁵³E-mail datë 21.7.2021.

⁵⁴Shpjegime datë 28.7.2021.

⁵⁵(1) librezë ushtarake për kafshë nr. ***, datë 23.3.1981; (2) akt shitblerjeje pasurie të luajtshme nr. ***, datë 24.6.1999; (2) vërtetim nr. *** prot., datë 14.10.2019, nga ISSH-ja Shkodër; (3) pasaport-dokument identifikimi i kafshëve dhe kartelat shoqëruese për kafshët me matrikull: ***, datë 21.6.2004, ***, datë 21.6.2004, ***, datë 21.6.2004, ***, datë 21.6.2004, ***, datë 21.6.2004; ***, datë 21.6.2004, ***, datë 21.6.2004; ***, datë 21.6.2004; (4) kopje dokumenti nga sistemi “RUDA”, (5) vërtetim nr. *** prot., datë 27.1.2021, i Njesisë Administrative D.; (6) kërkesë Ermir Lelçi datë 14.6.2021; (7)

1.61. Në pyetësoin nr. 3⁵⁶, Komisioni i kërkoi subjektit të specifikojë mënyrën e përfitimit të të ardhurave nga aktiviteti blegtoral ku janë shitur (nëse blerësit kanë qenë individë apo biznese, nëse ka pasur persona të tjerë të punësuar etj.), si dhe vënien në dispozicion të fotove të ambienteve të minifermës.

1.62. Në përgjigje⁵⁷, subjekti shpjegon se blerësit e viçave, të qengjave dhe të qumështit kanë qenë individë të ndryshëm dhe sistemi RUDA në rubrikat e tij nuk ka parashikuar personin blerës të kafshës, pasi ky aktivitet zhvillohej nga fermerët pa iu nënshtruar detyrimit për t'u regjistruar me NIPT dhe se këta përjashtoheshin nga taksimi i këtij aktiviteti. Sipas tij, nuk kishte ndonjë akt nënligjor që ta detyronte të deklaronte dhe asnjë institucion shtetëror nuk përfitonte nga taksimi i tij. Në vijim, shpjegon se vetëm në vitin 2014 është parashikuar që fermeri mund të regjistrohet në mënyrë vullnetare për efekt të skemës së kompensimit, sipas udhëzimit nr. 19, datë 3.11.2014, "Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar". Në përfundim, subjekti shpjegon se shtetasi N.L. nuk ka pasur ndonjë detyrim ligjor për t'u regjistruar si fermer dhe se i ka shitur produktet te persona të ndryshëm. Bashkëlidhur shpjegimeve të tij subjekti ka dorëzuar disa foto të ambienteve të fermës.

1.63. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti rezulton se shtetasi N.L.: (i) ka përfituar 40.2 dynym tokë në bazë të ligjit nr. 7501, "Për Tokën"⁵⁸; (ii) shtetasi N.L. dhe bashkëshortja L.L. kanë paguar kontribute të sigurimeve shoqërore si të vetëpunësuar në bujqësi, konkretisht – shtetasi N.L.⁵⁹ në datën 28.6.2000 ka paguar kontributet për periudhën 1.1.1993 – 31.12.2000; në datën 26.4.2006 ka paguar kontributet për periudhën 1.1.2001 – 31.12.2006 e në vijim kontributet për periudhën 1.1.2006 – 30.6.2008, ndërsa shtetasja L.L.⁶⁰ në datën 28.6.2000 ka paguar kontributet për periudhën 1.10.1993 – 31.10.2000 dhe në datën 24.4.2006 ka paguar kontributet për periudhën 1.1.2001 – 4.2.2006; (iii) në datën 24.6.1996 ka blerë traktor me vlerë 500.000 lekë; (iv) në datën 21.6.2004 ka regjistruar 8 krerë lopë⁶¹; (v) në kohën e emergjencave civile të vitit 2011, familja e shtetasit N.M.L. ka pasur minifermë me 6 krerë lopë, 40 dele dhe 10 derra⁶²; (vi) në datën 1.1.2007 ka regjistruar në sistemin RUDA 50 specie të leshta, si dhe 8 gjedhë nga viti 2009 deri në vitin 2018⁶³.

1.64. Në aktvlerësimin e paraqitur nga subjekti lidhur me të ardhurat e realizuara, ndër vite, nga aktiviteti blegtoral për periudhën 1993 – 2009 nga babai i tij, Komisioni vëren se: Janë paraqitur vetëm të ardhurat dhe jo shpenzimet (përveç konsumit të qumështit nga viçat). Duke iu referuar një publikimi zyrtar rreth menaxhimit të një ferme⁶⁴, ku përshkruhen dhe përlllogariten të ardhurat dhe zërat e kostove variabël për një lopë qumështi në vit, rezulton se fitimi *bruto* është në masën 32,3% të të ardhurave të realizuara. Rendimenti i litrave të prodhuara në një vit nga një lopë është shumë më i lartë se ai i paraqitur në statistikat zyrtare

shkresë nr. *** prot., datë 23.6.2021, e Drejtorisë së Statistikave; (8) aktvlerësimi datë 26.7.2021; (9) kopje të vërtetimit nr. *** prot., datë 29.6.2020.

⁵⁶E-mail datë 8.9.2021.

⁵⁷Shpjegime datë 13.9.2021.

⁵⁸(1) Vërtetim me nr. *** prot., datë 27.5.2009, i Komunës D.; (2) Vërtetim i datës 25.6.2018, i Kryesisë së fshatit Mali i Gjymtit; (3) Vërtetim nr. *** prot., datë 25.6.2018, i Njësisë Administrative D.; (3) Shkresa me nr. *** prot., datë 2.7.2020, e Bashkisë Shkodër.

⁵⁹Referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 14.10.2019, të Drejtorisë Rajonale të ISSH-së Shkodër.

⁶⁰Referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 29.6.2020, të Drejtorisë Rajonale të ISSH-së Shkodër.

⁶¹Inspektorati Veterinar ka lëshuar dokumentet e identifikimit individual të kafshës "Pasaport" me datë lëshimi 21.6.2004.

⁶²Njësia Administrative D. vërtetim nr. *** prot., datë 27.1.2021.

⁶³Sipas dokumentit të printuar nga sistemi RUDA, në datën 16.10.2019.

⁶⁴<https://www.bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/01/Manuali-mbi-Menaxhimin-e-Biznesit-ne-Ferme.pdf>

të publikuara nga INSTAT-i⁶⁵, konkretisht në aktvlerësimin e subjektit paraqitet rendiment vjetor 4.500 litra, ndërkohë që referuar INSTAT-it rendimenti vjetor për periudhën 1998 – 2003, varion nga 2.280 litra deri në 2.863 litra.

1.65. Komisioni kërkoi nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) informacion lidhur me datën e regjistrimit si fermer në regjistrin kombëtar të identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermës blegtorale të shtetasit N.L., statusin jetësor të gjedhëve të paraqitur nga subjekti sipas sistemit RUDA si dhe për: (i) rendimentin vjetor të qumështit të prodhuar për çdo vit kalendarik; (ii) konsumin vjetor të qumështit për viç dhe atë për nevoja personale familjare; (iii) çmimin mesatar të shitjes së qumështit për çdo vit kalendarik; (iv) numrin e viçave të lindur nga secila kafshë; (v) çmimin mesatar të shitjes së mishit të viçit për çdo vit kalendarik; si dhe (vi) kostot e mundshme fikse dhe variabël (ushqime të njoma, shpenzime veterinarë dhe për pajisje blegtorale etj.). Këtë kërkesë Komisioni ia drejtoi edhe Departamentit të Prodhimit Shtazor pranë Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, por nuk mori përgjigje.

1.66. MBZHR-ja⁶⁶ informon se regjistrimi individual i kafshëve dhe funksionimi i sistemit të informacionit blegtoral “RUDA” ka filluar në vitin 2011 dhe, për pasojë, të dhënat për matrikujt e kafshëve të llojit gjedh dhe numrin e deleve për periudhën 2001 – 2009 nuk mund të verifikohen prej tyre. Bashkëlidhur shkresës, MBZHR-ja vendosi në dispozicion të Komisionit tabelat në lidhje mbi prodhimin e mundshëm të kafshëve, bazuar në të dhënat e sektorit të statistikave dhe Analizave Ekonomike pranë MBZHR-së për rendimentin e qumështit në nivel qarku⁶⁷ dhe për çmimin mesatar të shitjeve me pakicë të qumështit⁶⁸ dhe mishit të viçit⁶⁹.

1.67. Nga analiza e mësipërme, Komisioni krijoi bindjen se babai i subjektit të rivlerësimit ka ushtruar aktivitet në blegtori, por subjekti nuk ka provuar të ardhurat *neto* të realizuara nga ky aktivitet, sipas kërkesave të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

1.68. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) personi tjetër i lidhur/babai i subjektit ka mungesë të ardhurash të ligjshme në vlerën 4.100.000 lekë për të kryer pagesën e kësteve të apartamentit; (ii) personi tjetër i lidhur/babai i subjektit ka mungesë të ardhurash të ligjshme në vlerën 2.110.000 lekë për të kryer shlyerjen e parakohshme të kredisë, e cila ka shërbyer si burim për pjesën takuese të subjektit në apartamentin në Shkodër.

1.69. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁷⁰ subjekti i rivlerësimit ka paraqitur raportin e audituesit ligjor M.L., ku janë analizuar: (i) të ardhurat nga blegtoria; (ii) të ardhurat dhe konsumi si familje bujqësore; si dhe (iii) të ardhurat nga interesat bankare.

1.70. *Lidhur me të ardhurat nga blegtoria* – në raport është shpjeguar se ato janë bazuar në aktvlerësimin e përpiluar nga z. M.M., inspektor në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit

⁶⁵http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START__BL/BL06/table/tableViewLayout2/?rxid=c4bcec1b-7e5a-4f07-8817-84e4015727c7

⁶⁶Shkresa nr. *** prot., datë 23.9.2021.

⁶⁷Lidhur me rendimentin vjetor të qumështit të prodhuar në nivel Qarku Shkodër për krerë gjedh rezultojnë në vitet: 1996-2.540; 1997-2.280; 1998-2.280; 2000-2.451; 2001-2.658; 2002-2.817; 2003-2.863; 2004-2.307; 2005-2.245; 2006-2.448; 2007-2.170; 2008-2.304; 2009-2.334.

⁶⁸Lidhur me çmimet e shitjes me pakicë të qumështit në nivel Republike rezultojnë se në vitet: 1994-30.6.; 1995-31.1.; 1996-32.2; 1997-39.6; 1998-49; 2000-52; 2001-52; 2002-53; 2004-54; 2005-54; 2006-55; 2007-56; 2008-61; 2009-61.

⁶⁹Lidhur me çmimin mesatar të shitjes me pakicë të mishit të viçit në nivel Republike: 1994-228.5; 1995-251.7; 1996-297.7; 1997-384.3; 1998-583; 2000-561; 2001-563; 2002-616; 2003-629; 2004-624; 2005-626; 2006-630; 2007-635; 2008-653; 2009-720.

⁷⁰Shpjegime të subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi, datë 22.10.2021 (me nr. *** prot., datë 22.10.2021, në Komision).

dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i paraqitur nga subjekti gjatë hetimit administrativ, ku totali i të ardhurave të krijuara ka qenë 13.098.900 lekë. Gjithashtu, audituesi ligjor ka përpiluar një tabelë tjetër për përlllogaritjen e të ardhurave, ku si bazë për rendimentin e prodhimit të qumështit janë përdorur të dhënat e INSTAT-it. Referuar këtij skenari, të ardhurat kanë qenë 12.121.913 lekë. Më tej, në raport janë përshkruar shpenzimet në blegtori, duke pasur si pikënisje dokumentin “manual mbi menaxhimin e biznesit në fermë”, cituar nga Komisioni në relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht. Duke konsideruar se në strukturën e kostos së analizuar në këtë manual janë përfshirë edhe tre zëra, të cilët përballohen nga babai i subjektit⁷¹, norma e fitimit *bruto* nga 32,3% në 53,1%, shpjegohet në raport.

1.71. Referuar normës 53,1%, fitimi i realizuar nga blegtorja ka qenë në vlerën 6.955.516 lekë sipas variantit të parë⁷² (rendimenti i prodhimit të qumështit sipas aktvlerësimit të inspektorit) dhe në vlerën 6.436.763 lekë⁷³ (rendimenti i prodhimit të qumështit sipas të dhënave të INSTAT-it, ndërsa për të ardhurat nga shitja e mishit të viçit dhe mishit të qengjit bazuar në aktvlerësimin e inspektorit).

1.72. *Lidhur me të ardhurat dhe konsumin si familje bujqësor* – në raportin e audituesit ligjor është shpjeguar se këto të dhëna janë mbështetur në të dhënat e INSTAT-it për vitin 2007, duke i indeksuar me normën e inflacionit për periudhën 1993 – 2007, për të cilën, referuar këtyre përlllogaritjeve të ardhurat si familje bujqësore kanë qenë në shumën 7.822.972 lekë, ndërsa konsumi në shumën 6.770.332 lekë, duke rezultuar në një gjendje pozitive në vlerën 1.052.639 lekë.

1.73. Në raportin e audituesit është paraqitur edhe shuma 266.660 lekë, si të ardhura nga interesat e depozitave bankare.

1.74. Në përfundim, në raport është paraqitur një tabelë përmbledhëse, ku pasqyrohen: (i) të ardhurat nga blegtorja⁷⁴ në shumën 12.121.913 lekë; (ii) shpenzimet blegtorale në shumën 5.685.177 lekë, bazuar në normën 46,91%; (iii) të ardhurat si familje bujqësore në shumën 7.822.972 lekë; (iv) konsumi si familje bujqësore në shumën 6.770.332 lekë; (v) të ardhurat nga interesat në shumën 266.660 lekë; (vi) pagesat për apartamentin dhe mbylljen e kredisë në shumën 6.175.286 lekë. Nga këto përlllogaritje ka rezultuar një gjendje pozitive prej 1.580.749 lekësh. Në fund të raportit konkludohet se shtetasi N.L. ka pasur mjete të mjaftueshme monetare për kryerjen e pagesave për blerjen e banesës dhe mbylljen e kredisë së shtetasit Ermir Lelçi, në të cilën është bashkëpronar me 67%.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.75. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

1.76. Nenet 30 dhe 45 të ligjit nr. 84/2016, autorizojnë organet e rivlerësimit të hetojnë në drejtim të verifikimit dhe kontrollit të pasurisë çdo situatë, fakt apo cilësi, në funksion të realizimit të qëllimit të këtij procesi, autorizim i cili jo detyrimisht lidhet me cilësimin e personave të tretë si persona të tjerë të lidhur.

⁷¹Konkretisht ushqime të njoma (prodh. fermë); ushqime të thata (prodh. fermë); koncentratë (prodh. fermë).

⁷²Të ardhura në vlerën 13.098.900 lekë, shpenzime 6.143.384 lekë.

⁷³Të ardhura në vlerën 12.121.913 lekë, shpenzime 5.685.177 lekë.

⁷⁴Për rendimentin e qumështit bazuar në të dhënat e INSTAT-it, ndërsa për të ardhurat nga shitja e mishit të viçit dhe shitja e mishit të qengjit bazuar në aktvlerësimin e inspektorit.

Lidhur me burimet e mjaftueshme financiare të ligjshme të babait të subjektit/N.L. për blerjes e 2/3 pjesë takuese në shumën 4.100.000 lekë

1.77. Bazuar në këto dispozita ligjore, Komisioni vlerësoi pretendimin e subjektit të rivlerësimit mbi mundësinë financiare të babai të tij, z. N.L., për shlyerjen e kësteve të blerjes së apartamentit në shumën 4.100.000 lekë, me të ardhura nga bujqësia dhe blegtoria nga viti 1991 e në vijim dhe në drejtim të verifikimit të deklarimeve të tij mbi marrëdhënien që ka pretenduar se ka pasur me këtë pasuri.

1.78. *Lidhur me të ardhurat e realizuara nga babai i subjektit nga bujqësia dhe blegtoria* – Komisioni vlerëson se nga hetimi administrativ subjekti i rivlerësimit ka provuar që babai, shtetasi N.L.: (i) ka në përdorim një sipërfaqe prej 40.2 dynym tokë, në bazë të ligjit nr. 7501, “Për Tokën”, sipas vërtetimit të njësisë administrative; (ii) ka paguar kontribute të sigurimeve shoqërore si i vetëpunësuar në bujqësi për periudhën 1993 – 2008 dhe bashkëshortja/L.L. ka paguar kontributet për periudhën 1993 – 2006; (iii) në datën 24.6.1996 ka blerë traktor me vlerë 500.000 lekë; (iv) në datën 21.6.2004 ka regjistruar 8 krerë lopë; (v) në kohën e emergjencave civile të vitit 2011, familja e shtetasit N. M. L. ka pasur miniferme me 6 krerë lopë, 40 dele dhe 10 derra; (vi) në datën 1.1.2007 ka regjistruar në sistemin RUDA 50 specie të leshta, si dhe 8 gjedhë nga viti 2009 deri në vitin 2018.

1.79. Referuar fakteve të mësipërme, Komisioni krijoi bindjen se babai i subjektit të rivlerësimit ka ushtruar aktivitet në blegtori, por subjekti nuk ka provuar të ardhurat *neto* të realizuara nga ky aktivitet. Aktivlerësimi i përpiluar nga inspektori në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2⁷⁵ dhe akti i audituesit ligjor i paraqitur nga subjekti në përfundim të rezultateve të hetimit, nuk janë mbështetur në asnjë burim të njohur prove nga ato që parashikon neni 49 i ligjit nr. 84/2016, por pasqyrojnë të ardhurat hipotetike të babait të tij gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e blegtorisë.

1.80. *Lidhur me marrëdhënien e subjektit me këtë pasuri* – nga hetimi administrativ rezulton se: (i) në kontratën e kaparit figuron si blerës vetëm subjekti dhe në përshkrimin e dy transfertave të kryera në vitin 2006 nga babai i tij, është specifikuar se pagesat janë për shtetasin Ermir Lelçi (“kësti I për blerje Ermir Lelçi” dhe “kësti II për blerje apartamenti Ermir Lelçi”); (ii) nga dokumentacioni i administruar dhe nga shpjegimet e subjektit vërehet se babai i subjektit ka investuar në një pasuri të paluajtshme në Shkodër, ndërkohë që ka banuar dhe vazhdon të banojë në fshat⁷⁶, për shkak të ushtrimit të aktivitetit blegtoral; (iii) kontratat e energjisë elektrike dhe ujësjellësit janë lidhur në emër të subjektit; (iv) subjekti i rivlerësimit ka një marrëdhënie të qëndrueshme dhe të pandërprerë me këtë apartament, duke qenë se subjekti bashkë me familjen kanë jetuar në këtë apartament që nga blerja e tij e në vijim; dhe (v) babai i subjektit nuk provon me dokumentacion ligjor justifikues burimet financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

1.81. Gjithashtu, nga hetimi i origjinës së këtyre fondeve të përdorura për shlyerjen e kështit të parë dhe të dytë për blerjen e apartamentit, konstatohet se babai i subjektit ka depozituar në llogaritë e tij në “Tirana Bank” shumën 1.000.000 lekë në datën 19.3.2003 dhe pak kohë përpara se të paguante kështin e parë për blerjen e apartamentit⁷⁷, në datën 6.12.2005, llogaria e tij dyfishohet nëpërmjet depozitimit *cash* të shumës 1.270.000 lekë dhe më pas në datën e pagimit të kështit të dytë, në datën 8.6.2006, shtohet me 300.000 lekë. Pra, në një periudhë të shkurtër kohore (6 muaj), që përkon me pagimin e dy kësteve të para të blerjes së apartamentit, depoziton *cash* shumën 1.570.000 lekë. Gjithashtu, edhe në datën e shlyerjes së kredisë, babai

⁷⁵Shpjegime datë 28.7.2021.

⁷⁶Referuar deklarimit të subjektit në pyetësorin nr. 2.

⁷⁷Datë 7.2.2006.

i subjektit depoziton shumën *cash* 800.000 lekë. Këto ndryshime të rëndësishme në llogarinë bankare të tij që përkojnë me shlyerjen e kësteve të blerjes së apartamentit dhe të pagimit të kredisë, ngrenë dyshimin lidhur me mundësinë e tij për krijimin e shumave të mësipërme.

1.82. Bazuar në sa më sipëranalizuar, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pronësinë në masën 33% mbi këtë pasuri dhe përdorimin e pjesës takuese prej 77% në pronësi të babait të tij, për aq sa nuk provoi të kundërtën e rezultatit të hetimit, duke u gjendur në kushtet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

1.83. Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit se zotëron vetëm 33% të pasurisë apartament banimi nuk bind për vërtetësinë e tij, por ngre dyshime për paraqitjen e rrethanave jo të vërteta, të cilat tentojnë të fshehin nga kontrolli apo verifikimi marrëdhënie të plotë të pronësisë me këtë pasuri dhe, për pasojë, edhe të burimit të krijimit të saj në vlerën 4.100.000 lekë, që përbëhet nga këstet e paguara nga babai i subjektit.

Lidhur me burimet e mjaftueshme financiare të ligjshme të babait të subjekti/N.L. për shlyerjen e parakohshme të kredisë së marrë nga subjekti në shumën 2.100.000 lekë

1.84. Komisioni konstaton se nga hetimi administrativ është provuar se: (i) shuma e kredisë është transferuar për llogari të shitësit menjëherë pas lëvrimit të saj; (ii) apartamenti është vendosur si kolateral për kredinë e marrë; (iii) në kontratën e shitblerjes me rezervë citohet kredia që do të merret në “Tirana Bank”; (iv) objekti i kontratës së kredisë është blerje banese; dhe (v) në DIPP-në e vitit 2007 subjekti ka deklaruar kontratë kredie bankare afatgjatë në “Tirana Bank” për shtëpi dhe, për pasojë, e vlerëson se kredia ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit.

1.85. Gjithashtu është provuar se në datën 16.1.2009 në llogarinë e subjektit është transferuar shuma 2.110.000 lekë nga babai N.L., me përshkrimin “për shlyerje kredie”. Ky veprim vlerësohet nga Komisioni se plotëson kushtet e kontratës së dhurimit të parashikuar nga dispozitat e Kodit Civil⁷⁸ dhe bazuar në pikën 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, e konsideron shtetasin N.L. “person tjetër të lidhur”. Si pasojë, subjekti, në zbatim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhuruar nga babai i tij për shlyerjen e kredisë.

1.86. Lidhur me burimin e krijimit të shumës për shlyerjen e kredisë, subjekti, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se për blerjen e apartamentit janë paguar shuma të ndryshme nga babai N.L., të kursyera nga vetëpunësimi në bujqësi dhe nëblegtori që nga viti 1991 e në vijim, një pjesë e të cilave ka qenë depozituar në bankë dhe një pjesë në banesë. Më pas, në procesverbalin e datës 20.1.2016 të ILDKPKI-së subjekti ka deklaruar se burimi i shumës prej 6.200.000 lekësh janë të ardhura të përfituara nga babai nga shitja e bagëtive nga viti 1992 e në vijim, ku gjatë kësaj periudhe kohe ka shfrytëzuar një sipërfaqe toke të njohur nga Komuna D. sipas kufijve të vjetër, sipërfaqe të cilën e shfrytëzon edhe aktualisht për bagëtinë dhe se nuk ka kontribuar fare në pagesën e blerjes së këtij apartamenti edhe pse pagesat janë kryer prej tij në vitet 2006 dhe 2007.

1.87. Gjithashtu edhe në aktvlerësimin e paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3⁷⁹ dhe në raportin e audituesit ligjor të paraqitur në përgjigje të rezultateve të hetimit pasqyrohen të ardhurat e realizuara, ndër vite, nga babai i subjektit nga aktiviteti blegtoral.

⁷⁸Neni 761: “Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat kjo i pranon”.

⁷⁹Shpjegime datë 13.9.2021.

1.88. Sa më sipër, Komisioni, në analizën e tij mori në konsideratë kursimet e babait të subjektit nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral për krijimin e shumës 2.100.000 lekë.

1.89. Bazuar në arsyetimin e përdorur në paragrafët 1.81-1.83 të vendimit, Komisioni vlerëson se të ardhurat e babait të subjektit nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral mbeten vetëm në kuadër të një deklarimi të pambështetur në asnjë burim prove nga ato që parashikon neni 49 i ligjit nr. 84/2016.

1.90. Në përfundim, Komisioni vlerëson se babai i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e personit tjetër të lidhur (dhurues), ka mungesë të burime të mjaftueshme dhe të ligjshme për shlyerjen e kredisë në shumën 2.110.000 lekë, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

2. Automjet tip “Opel Zafira”, viti i prodhimit 2001, në vlerën 660 euro

Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjet tip “Opel Zafira”, blerë më 13.5.2013, në vlerën 660 euro. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi subjekti deklaroi kursime nga paga gjatë viteve. Për vërtetimin e deklarimeve, ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁸⁰.

2.1. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë automjetin me targa *** në deklaratën *Vetting* dhe jo në DIPP-në e vitit 2013, vit në të cilin e ka blerë.

2.2. Në pyetësin nr. 2⁸¹, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të shpjegonte se përse nuk e ka deklaruar blerjen e automjetit në DIPP-në e vitit 2013. Në përgjigje⁸², subjekti deklaroi se: “Në deklaratën periodike të vitit 2013, të dorëzuar në datën 18.3.2014, te fleta me nr. 9, kam përshkruar ‘është blerë automjeti me datën 13.5.2014’, ku në fakt rezultoi se është bërë një lapsus, pasi në vend që të shkruhej viti 2013, është shkruar gabimisht viti 2014 dhe aty përshkruhet çmimi prej 660 euro, fatura tatimore me nr. ***, datë 13.5.2013, si dhe një deklaratë e kësaj date”.

2.3. Komisioni konstatoi se në DIPP-në e vitit 2013, të dorëzuar nga ILDKPKI-ja, mungon faqja nr. 9. Komisioni kërkoi informacion në ILDKPKI lidhur me faqen nr. 9 të DIPP-së së vitit 2013 dhe, në përgjigje, ILDKPKI-ja⁸³ bën me dije se kjo faqe mungon duke dërguar edhe një herë DIPP-në e vitit 2013 të subjektit.

2.4. Referuar dokumentacionit të administruar nga DPSHTRR-ja⁸⁴, rezultoi se shitësi E.A. e ka zhdoganuar këtë automjet në datën 10.3.2013, me çmim blerjeje 500 euro, shpenzime transporti 150 euro⁸⁵ dhe ka paguar detyrime doganore vetëm tatim mbi vlerën e shtuar në vlerën 54.336 lekë⁸⁶.

2.5. Duke krahasuar çmimin e blerjes me atë të shitjes, pa e përfshirë vlerën e tatimit mbi vlerën e shtuar⁸⁷, vërehet se ky automjet është blerë në shumën 650 euro (500 euro dhe 150 euro

⁸⁰(1)faturë tatimore shitjeje nr. ***, datë 13.5.2013; (2) deklaratë nga shtetasi E.A. (administratori); (3) leje qarkullimi automjeti me targa ***, nr. shasje ***, në emër të z. Ermir Lelçi.

⁸¹E-mail datë 21.7.2021.

⁸²Shpjegime datë 28.7.2021.

⁸³Shkresa nr. *** prot., datë 2.9.2021.

⁸⁴Shkresa nr. *** prot., datë 23.1.2020.

⁸⁵Referuar kutisë nr. *** të deklaratës doganore nr. ***, detajet e vlerës ku pasqyrohet vlera e transportit prej 21.647 lekësh, ekuivalenti i shumës 150 euro bazuar në kursin e këmbimit 1 euro=139,66 lekë.

⁸⁶Deklaratë doganore nr. ***, datë 10.3.2013, kurs këmbimi 1 euro=139,66 lekë, eksportues S.B., marrës E.A. person fizik.

⁸⁷TVSH-ja zbatohet si një tatim në përqindje mbi çmimin e mallrave dhe shërbimeve dhe bëhet i pagueshëm, pasi më parë zbritet TVSH-ja që rëndon drejtpërdrejt, elementet e kostos së mallrave dhe të shërbimeve. Parimi i zbritjes së TVSH-së:

transport) dhe është shitur në shumën 550 euro (çmimi me të cilin e ka blerë subjekti pa e përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar). Pra, subjekti tregtar E.A., person fizik, ia ka shitur automjetin subjektit të rivlerësimit me një humbje në vlerën 100 euro.

2.6. Sa më lart, në pyetësin nr. 2⁸⁸, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me këtë çmim preferencial, i cili në përgjigje⁸⁹ deklaroi se nuk ka pasur asnjë lloj marrëdhënie me shtetasin E.A. dhe nuk rezultoi që të ketë pasur ndonjë procedim penal në ngarkim të tij.

2.7. Në dosjen e DPSHTRR-së konstatohet se fillimisht ky automjet është pajisur me targën *** dhe, më pas, është pajisur me targën **. Gjithashtu, është administruar shkresa nr. ** prot., datë 27.7.2017, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, drejtuar DRSHTRR-së Shkodër, duke i kërkuar fotokopjen e dosjes së automjetit me targa ** për interesa të procedimit penal nr. **, viti 2013. Referuar vërtetimit nr. ** prot., datë 23.7.2013, të lëshuar nga Komisariati i Policisë Shkodër, shtetasi Ermir Lelçi ka bërë denoncim pranë këtij komisariati për humbjen e targës së automjetit **.

2.8. Në pyetësin nr. 2⁹⁰, subjekti u pyet nga Komisioni lidhur me procedimin penal nr. **, viti 2013 dhe, në përgjigje, sqaroi se ka bërë kallëzim penal në Komisaratin e Policisë Shkodër pasi ka konstatuar se njëra prej targave nuk ishte dhe ka dyshuar se mund të ishte vjedhur. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë nuk e ka thirrur për të dhënë shpjegime dhe nuk i është njoftuar vendimi lidhur me këtë procedim penal.

2.9. Nga verifikimi në sistemin elektronik të AMF-së, subjekti i rivlerësimit figuron pronar që nga data 14.5.2013, i automjetit tip “Opel Zafira”, me targa **.

2.10. Gjithashtu, Komisioni hetoi për konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit duke kërkuar informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat⁹¹ dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër⁹² lidhur me procedimet penale ndaj shtetasit E.Xh.A.

2.11. Në përgjigje, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat⁹³ dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër⁹⁴ informojnë Komisionin se nuk është regjistruar procedim penal dhe nuk ka fashikuj procedimi përfshirë ato të mosfilluara, pushuara apo pezulluara në emër të shtetasit E.Xh.A.

2.12. Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet në datën 13.5.2013, nga ku rezultoi një balancë pozitive në shumën 95.987 lekë.

2.13. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: subjekti nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me germën “a”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003 blerjen e automjetit tip “Opel Zafira”, të vitit 2001, në vlerën 660 euro.

personi i tatueshëm gëzon të drejtën që të zbrësë nga TVSH-ja e llogaritur për transaksionet e tatueshme shumë TVSH-së, në masën që furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të marra përdoren nga personi i tatueshëm në funksion të këtyre transaksioneve të tatueshme.

⁸⁸E-mail datë 21.7.2021.

⁸⁹Shpjegime datë 28.7.2021.

⁹⁰E-mail datë 21.7.2021.

⁹¹Shkresa nr. ** prot., datë 28.5.2021.

⁹²Shkresa nr. ** prot., datë 28.5.2021.

⁹³Shkresa nr. ** prot., datë 1.6.2021.

⁹⁴Shkresa nr. ** prot., datë 24.6.2021.

2.14. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁹⁵ subjekti shpjegon se fakti që nuk gjendet fleta nr. 9 në deklaratën *Vetting*, nuk mund ta ngarkojë me përgjegjësi, pasi nëse nuk do ta kishte dërguar fletën me nr. 9, mungesën do ta kishte konstatuar Prokuroria e Përgjithshme ku mbliidhen të gjitha deklaratat e prokurorëve dhe bëhet një verifikim paraprak i numrit të fletëve apo të plotësimit gabim të të dhënave dhe, më pas, nga ILDKPKI-ja. Fakti që nuk i është kërkuar nga këto institucione që të dërgohej edhe fleta me numër 9 e kësaj deklarate, pas muajit prill e në vijim të vitit 2014 apo në vitin 2015, konfirmon faktin se nuk është konstatuar prej tyre mungesa e faqes numër 9.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.15. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

2.16. Neni 24⁹⁶, i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, përcakton se është detyrë e Inspektoratit të Lartë dhe atij të ulët verifikimi i rregullsisë së plotësimit të deklaratës dhe të anekseve, dokumentet justifikuese dhe ligjshmëria e tyre dhe në rastin kur vërehen gabime materiale ose plotësime të gabuara njoftojnë subjektin që ka paraqitur këto deklarime, i cili, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit është i detyruar t’i ndreqë ato.

2.17. Sa më sipër, në kushtet kur institucioni përgjegjës nuk ka bërë verifikimin paraprak të DIPP-së së vitit 2013, Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme.

2.18. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me deklarimin e pasurisë automjet tip “Opel Zafira” në DIPP-në e vitit 2013.

3. Kursime në vlerën 650.000 lekë

3.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes, si dhe nga shuma e përfituar nga kempit i vajzës, E.L., gjatë vitit 2016. Konkretisht, nga pagat e tij gjatë viteve ka kursyer shumën 390.000 lekë. Bashkëshortja ka kursyer gjatë viteve nga pagat shumën 195.000 lekë dhe nga shumat e kempit të vajzës E.L. është kursyer shuma 65.000 lekë. Si burim krijimi subjekti deklaroi: kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes, si dhe shuma e përfituar nga kempit i vajzës E.L.

3.2. Nga hetimi administrativ rezulton se në procesverbalin datës 20.1.2016, të ILDKPKI-së subjekti është pyetur lidhur me gjendjen *cash* në datën 31.12.2014, i cili në përgjigje ka deklaruar se disponon vlerën 450.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar vlerën 650.000 lekë dhe po kjo shumë është deklaruar në deklaratën *Vetting*.

3.3. Me anë të pyetësorit nr. 2⁹⁷, Komisioni i kërkoi subjektit të deklaronte gjendjen e likuiditeteve *cash* në datën 31.12.2017 dhe, në përgjigje⁹⁸, deklaroi se gjendja e likuiditeteve *cash* në këtë datë ka qenë në vlerën rreth 50.000 lekë.

⁹⁵Shpjegime të subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi, datë 22.10.2021 (nr. *** prot., datë 22.10.2021, në Komision).

⁹⁶Ligji nr. 9049/2003, neni 24: “Inspektorati i Lartë dhe ai i ulët bëjnë përpunimin paraprak të deklarimeve, i cili përfshin juridiksionin, rregullsinë e plotësimit të deklaratës dhe të anekseve, dokumentet justifikuese dhe ligjshmërinë e tyre. Kur nga përpunimi paraprak vërtetohen gabime materiale ose plotësime të gabuara, Inspektorati njofton subjektin që ka paraqitur këto deklarime, i cili brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar t’i ndreqë ato”.

⁹⁷E-mail datë 21.7.2021.

⁹⁸Shpjegime datë 28.7.2021.

3.4. Duke ndjekur logjikën e deklarimeve, duket se subjekti nuk deklaroi shtesa/pakësime, por deklaroi gjendjen e likuiditeteve të disponuara në banesë në fund të çdo viti kalendarik, çka përputhet edhe me deklarin e subjektit në procesverbalin e ILDKPKI-së⁹⁹ dhe në deklaratën *Vetting*. Për rrjedhojë, Komisioni, vlerat e deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike, i paraqiti në analizën financiare si gjendje të likuiditeteve *cash*.

3.5. Referuar analizës financiare për periudhën 2007 – 2016, periudhë gjatë së cilës janë deklaruar likuiditete *cash*, rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi financiare për krijimin e shtesës së kursimeve.

3.6. Në përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit është i saktë dhe ka burime të ligjshme me dokumentacion justifikues.

KONSTATIME TË TJERA

4. Banesë dykatëshe në fshatin Mali i Gjymtit, Shkodër – në përdorim

4.1. Në pyetësorin standard¹⁰⁰ subjekti ka deklaruar se në ndonjë periudhë të shkurtër kohore, kryesisht gjatë fundjavave apo gjatë muajit gusht, që ka qenë periudhë pushimi, ka banuar në banesën e prindërve të tij në fshatin Mali i Gjymtit, Njësia Administrative D., bregu i Bunës, Shkodër. Banesa është e ndërtuar para vitit 1990 (rreth vitit 1967) dhe ka qenë e banueshme nga xhaxhai i tij së bashku me familjen e tij dhe rreth vitit 1980 janë transferuar në qytetin e Pukës. Banesa është dykatëshe, nuk ka dokumentacion të regjistrimit në ZVRPP-në Shkodër, pasi nuk ka pasur interes nga babai dhe xhaxhai i tij.

4.2. Me anë të pyetësorit nr. 2¹⁰¹, Komisioni i kërkoi subjektit të sqaronte nëse këtë banesë prindërit e tij e kanë në bashkëpronësi me xhaxhain apo e disponojnë vetëm ata, si dhe kërkoi që subjekti t'i vinte në dispozicion kopje të dokumentacionit të pronësisë, që disponon pavarësisht regjistrimit ose jo në ASHK (si kontratë shitblerjeje, leje ndërtimi, akte të tjera etj.), pozicionin e saktë (me koordinata) të këtij objekti në *google map* dhe foto nga jashtë të tij. Gjithashtu, i kërkoi të deklaronte nëse janë kryer investime në objekt nga viti 1990 e në vijim, dhe nëse po, sa ka qenë vlera e tyre.

4.3. Në përgjigje¹⁰², subjekti deklaroi se banesa nuk ka dokumentacion pronësie, pasi është ndërtuar përpara vitit 1967, nga gjyshi i tij dhe për ndërtimin e saj kanë kontribuar dy xhaxhallarët dhe babai i tij. Në të ka banuar gjyshi, gjyshja, dy xhaxhallarët e tij, kushërinjtë dhe kushërirat, prindërit dhe motrat e tij. Ndërtesa ka qenë dykatëshe përpara vitit 1990 dhe vetëm një pjesë e saj është e banueshme për shkak të amortizimit. Për të krijuar kushte banimi gjatë viteve të ndryshme janë bërë investime të pjesshme në ambientet e brendshme në vlerën 200.000 lekë. Aktualisht, pjesa funksionale përdoret nga dy prindërit e subjektit. Në vijim, subjekti deklaroi se nuk e përdor këtë banesë, por shkon te prindërit për t'i vizituar sipas mundësisë dhe kohës. Për të vërtetuar thëniet e tij ka paraqitur fotografi të bëra në këtë banesë para vitit 1990, nga gjyshi i tij M.K.L., gjyshja e tij e ndjerë M.T.L., si dhe xhaxhai i tij i ndjerë P.M.L. Gjithashtu, subjekti deklaroi se e ka të pamundur të gjejë dokumentacionin që vërteton lejen e ndërtimit që është lëshuar rreth vitit 1967 apo përpara tij, pasi këtë dokument nuk e kanë disponuar asnjëherë personat që kanë banuar. Në shpjegimet e tij subjekti ka pasqyruar koordinatat në *google map*, si dhe ka bashkëlidhur edhe dokumentacionin provues¹⁰³.

⁹⁹Shkresa nr. *** prot., datë 2.6.2021.

¹⁰⁰E-mail datë 13.1.2020.

¹⁰¹E-mail datë 21.7.2021.

¹⁰²Shpjegime datë 28.7.2021.

¹⁰³(1) 6 fotografi; (2) certifikatë vdekjeje e shtetasit M.L.; (3) certifikatë familjare e shtetasit M.L. e datës 21.9.2007; (4) certifikatë familjare e shtetasit P.L. e datës 10.9.2007; (5) certifikatë vdekjeje e shtetasit N.L.

4.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, Komisioni konstaton se shtetasi M.K.L. ka ndërruar jetë në datën 25.8.1975. Sipas certifikatës familjare të datës 21.9.2007, në bazë të regjistrimit shtetëror të fshatit Mali i Gjymtit, të vitit 1960, familja e shtetasit M.L. përbëhej nga 4 anëtarë dhe në të pasqyrohet dhe emri i të shoqes M. dhe fëmijëve të tyre N. dhe N.L. Sipas certifikatës së vdekjes të datës 20.2.2008, shtetasi N.L. ka ndërruar jetë në datën 27.5.1977. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur dhe certifikatën familjare të datës 10.9.2007, të shtetasit P.L., e cila përbëhej nga 7 anëtarë dhe disa fotografi të familjes.

4.5. Sa më sipër, Komisioni nuk konstatoi problematika mbi këtë pasuri dhe nuk krijoi dyshime për fshehje pasurie nga subjekti.

5. Apartament banimi me sip. 25 m², në Shkodër, në pronësi të shtetasit N.L.

5.1 Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja Shkodër¹⁰⁴ rezulton se shtetasi N.L. ka në pronësi një apartament me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 25 m². Sipas aktit të shitblerjes nr. ***, datë 5.4.1998, me palë shitëse V.V. dhe palë blerëse N.L., shitësi deklaroi se: “... i shet blerësit një pjesë apartament banimi me sipërfaqe totale 25 m², e ndodhur në L. T. K., rruga ‘***’, p. ***, kati i pestë Shkodër”. Çmimi i shitjes është caktuar në shumën 350.000 lekë dhe parashikohet se këtë shumë shitësi e ka marrë nga blerësi.

5.2. Nga dokumentacioni i administruar nga FSHU-ja¹⁰⁵, rezulton se në sistemin e faturimit gjendet emri i shtetasit N.L., me vendndodhje Mali i Gjymtit që nga data 2.1.2001 dhe me deklaratën noteriale nr. ***, datë 14.4.2015 (të administruar dhe nga notere B.B.¹⁰⁶) ka kërkuar ndryshimin e emrit në kontratën përkatëse nga N.L. në N.L.

5.3. Në pyetësin nr. 2¹⁰⁷, Komisioni i kërkoj subjektit të deklaronte adresat e banimit ndër vite të prindërve të tij. Në përgjigje¹⁰⁸, subjekti deklaroi se: “Prindërit e mi kanë banuar dhe banojnë tek e njëjta adresë, pikërisht në fshatin Mali i Gjymtit, Njësia Administrative D., Shkodër dhe në ndonjë periudhë të shkurtër tek apartamenti numër pasurie ***, zona kadastrale nr. ***, që është objekt hetimi në rastin konkret. Banimi në fshat lidhet kryesisht me ushtrimin e aktivitetit blegtoral që e vazhdon akoma, por në mënyrë të reduktuar, kjo edhe duke u nisur nga gjendja e tyre shëndetësore dhe qetësinë që ofron jeta e fshatit për sa kohë janë të aftë për t’u kujdesur për veten e tyre”.

5.4. Nga informacioni i administruar nga DPGJC-ja¹⁰⁹ rezulton se shtetasit N. dhe L.L. (prindërit e subjektit) janë banorë të përhershëm në Njësia Administrative D., Bashkia Shkodër.

5.5. Në pyetësin nr. 3¹¹⁰, Komisioni i kërkoj subjektit të deklaronte se kush ka jetuar ndër vite në këtë apartament, i cili në përgjigje¹¹¹, shpjegoi se në periudhën tetor 1998 – tetor 2000 ka banuar vëllai i tij L.L. Në vijim, subjekti sqaroi se në periudhën 1998 – korrik 1999, kur është diplomuar, ka qenë duke ndjekur studimet në Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë dhe pas diplomimit ka qëndruar në fshat, në banesën e prindërve deri në datën 1.2.2000, datë në të cilën është emëruar oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat. Gjithashtu, subjekti shpjegoi se nuk ka banuar asnjëherë në këtë apartament dhe se ka deklaruar fillimisht

¹⁰⁴Shkresa me nr. *** prot., datë 17.2.2020.

¹⁰⁵(1) Shkresa nr. *** prot., datë 22.1.2020; (2) Shkresa nr. *** prot., datë 1.7.2021.

¹⁰⁶Shkresa e datës 12.6.2021.

¹⁰⁷E-mail datë 21.7.2021.

¹⁰⁸Shpjegime datë 28.7.2021.

¹⁰⁹Shkresa nr. *** prot., datë 20.8.2021.

¹¹⁰E-mail datë 8.9.2021.

¹¹¹Shpjegime datë 13.9.2021.

adresën e tij në lagjen “***”, që i përket kushërirës së nënës së tij F.B. dhe bashkëshortit të saj Z.B.

5.6. Në përfundim, Komisioni nuk konstaton problematika për këtë pasuri që lidhen me procesin e rivlerësimit.

6. Tokë bujqësore

6.1. Sipas procesverbalit të datës 20.1.2016 të ILDKPKI-së subjekti ka deklaruar se burimi i shumës 6.200.000 lekë për blerjen e pasurisë, të përmendur në paragrafin 1, janë të ardhura të përfituara nga babai nga shitja e bagëtive nga viti 1992 e në vijim, ku gjatë kësaj periudhe kohore ka shfrytëzuar një sipërfaqe toke të njohur nga Komuna D. sipas kufijve të vjetër, sipërfaqe të cilën e shfrytëzon edhe aktualisht për bagëtinë.

6.2. Me anë të pyetësorit nr. 2¹¹², Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit se në bazë të ligjit i është njohur e drejta e shfrytëzimit të tokës nga Komuna D., si dhe i kërkoi t’i vinte në dispozicion kopje të dokumentacionit ligjor.

6.3. Në përgjigje¹¹³, subjekti deklaroi se babai i tij ka përfituar nga ligji nr. 7501, “Për tokën”, dhe disponon rreth 40 dynym tokë, pasi ka qenë anëtar i kooperativës bujqësore deri më 1.8.1991, ka shlyer detyrimet lidhur me taksën e tokës, si dhe detyrimet e tjera. Në vijim, subjekti deklaroi se babai i tij i është drejtuar Bashkisë Shkodër me dokumentacionin hartografik të sipërfaqes së tokës që disponon në bazë të ligjit nr. 7501, “Për tokën” dhe është në pritje të pajisjes me AMTP. Ky fakt provohet edhe nga shkresa përcjellëse e Bashkisë Shkodër për dërgimin e dokumentacionit ASHK-së Shkodër. Bashkëlidhur shpjegimeve ka dorëzuar edhe dokumentacionin provues¹¹⁴.

6.4. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti rezultoi se Komuna D., me vërtetimin nr. *** prot., datë 27.5.2009, konfirmon se shtetasi N.M.L. ka qenë anëtar i kooperativës bujqësore deri më 1.8.1991. Kryesia e fshatit Mali i Gjymtit, me vërtetimin e datës 25.6.2018, vërtetoi se familja e shtetasit N.M.L. ka në përdorim rreth 40 dynym tokë bujqësore që e shfrytëzon që nga viti 1993. Ky fakt konfirmohet edhe nga vërtetimi nr. *** prot., datë 25.6.2018, i Njesisë Administrative D. Sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 19.12.2019, Njësia Administrative D. vërtetoi se familja e shtetasit N.L. ka likuiduar taksat vendore dhe nuk ka detyrime të tjera financiare.

6.5. Në vijim, Bashkia Shkodër, me shkresën nr. *** prot., datë 2.7.2020, i ka dërguar drejtorisë vendore të ASHK-së Shkodër praktikën në emër të shtetasit N.L., të administruar sipas ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Nga dokumentacioni bashkëlidhur shkresës së Bashkisë Shkodër konstatohet se shtetasi N.L., me kërkesën nr. *** prot., datë 25.9.2018, për pajisje me AMTP, drejtuar Drejtorisë së Bujqësisë, ka kërkuar pajisjen me AMTP. Referuar certifikatës së gjendjes familjare të datës 1.8.1991, familja e shtetasit N.L. përbëhej nga 7 anëtarë, ndërmjet të cilëve pasqyrohet edhe emri i subjektit. Sipas planeve të rilevimit të pasurive rezultoi se shtetasi N.L. pasqyrohet si pronar i pasurive: arë me sip. 4810 m²; truall

¹¹²E-mail datë 21.7.2021.

¹¹³Shpjegime datë 28.7.2021.

¹¹⁴(1) Vërtetim nr. *** prot., datë 27.5.2009, i Komunës D.; (2) Vërtetim nr. *** prot., datë 25.6.2018; (3) Vërtetim nr. *** prot., datë 19.12.2019, i Njesisë Administrative D.; (4) Shkresë nr. *** prot., datë 2.7.2020, e Bashkisë Shkodër, bashkëlidhur-kërkesë për pajisje me AMTP nr. ***, datë 25.9.2018; plan rilevimi të pasurive: arë me sip. 4810 m²; truall me sip. 200 m²; arë me sip. 10.114 m²; arë me sip. 6950 m²; arë me sip. 18026 m²; certifikatë e gjendjes familjare në datën 1.8.1991, e shtetasit N.L.; certifikatë familjare e shtetasit N.L. datë 25.9.2018; vërtetim nr. *** prot., datë 25.6.2018, i Njesisë Administrative D.; vërtetim nr. *** prot., datë 25.6.2018; (8) Vërtetim i Kryesisë së fshatit Mali i Gjymtit datë 25.6.2018; vërtetim nr. ***, datë 27.5.2009.

me sip. 200 m²; arë me sip.10.114 m²; arë me sip. 6950 m² dhe arë me sip. 18026 m². Njësia Administrative D., me vërtetimin nr. *** prot., datë 25.6.2018, vërtetoi se norma e shpërndarjes së tokës bujqësore për frymë për fshatin Mali i Gjymtit ka qenë 5.7 dynym. Gjithashtu, pjesë e praktikës janë vërtetimi nr. *** prot., datë 25.6.2018, i Njesisë Administrative D. dhe vërtetimi i datës 25.6.2018, i Kryesisë së fshatit Mali i Gjymtit, sipas përmbajtjes së pasqyruar në paragrafin 6.4.

6.6. Komisioni konstaton se në zbatim të ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, familjet bujqësore ose individët, të cilët janë përfitues të tokës bujqësore, sipas vendimit nr. 452, datë 17.10.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, të ndryshuar, e përdorin tokën për veprimtari bujqësore, por kanë mungesa në plotësimin e dokumentacionit të përdorimit apo pronësisë, pajisen me AMTP sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe që nga hyrja në fuqi e VKM-së nr. 452/1992 e përdorin tokën për veprimtari bujqësore, pavarësisht se nuk janë pajisur me aktin e përdorimit¹¹⁵. Ky ligj¹¹⁶ ka përcaktuar kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore si organin përgjegjës për ndjekjen dhe përfundimin e procedurave për pajisjen e subjekteve me AMTP dhe si afat për përfundimin e procedurave të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve ka përcaktuar datën 31.12.2019.

6.7. Më pas është miratuar ligji nr. 20/2020, datë 5.3.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”¹¹⁷, që ka përcaktuar se kalimi në pronësi i tokës bujqësore bëhet nga ASHK-ja, sipas listës së përdoruesve të tokës, të miratuar me vendim të këshillit bashkiak. Në zbatim të këtij ligji, njësitë e vetëqeverisjes vendore, brenda 7 muajve nga hyrja në fuqi e tij, duhet të përcjellin pranë ASHK-së kërkesat për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, të administruara sipas ligjeve nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, dhe nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, si dhe kërkesat e administruara sipas nenit 6 të këtij ligji.

6.8. Komisioni, duke u bazuar në dispozitat e ligjit nr. 171/2014, ligjit nr. 20/2020 dhe në vërtetimin nr. *** prot., datë 25.6.2018, të Njesisë Administrative D., të paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr.2, konstaton se babai i subjektit të rivlerësimit ka në përdorim tokë bujqësore pa u pajisur me akt të marrjes së tokës në përdorim ose në pronësi dhe, në këto kushte, me kërkesën nr. *** prot., datë 25.9.2020, i është drejtuar Bashkisë Shkodër për t’u pajisur me AMTP. Bashkia Shkodër, në zbatim të ligjit nr. 20/2020, i ka dërguar ASHK-së dokumentacionin që dispononte me qëllim pajisjen e këtij shtetasi me AMTP.

¹¹⁵Neni 2: “Ky ligj zbatohet për subjektet si më poshtë: a) Familjet bujqësore ose individët, të cilët përmbushin kushtet e mëposhtme: i) janë përfitues të tokës bujqësore, sipas vendimit nr. 452, datë 17.10.1992, të Këshillit të Ministrave, ‘Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore’, të ndryshuar; ii) shfuqizuar; dhe iii) e përdorin tokën për veprimtari bujqësore por kanë mungesa në plotësimin e dokumentacionit të përdorimit apo pronësisë.

Neni 3: ‘Familjet bujqësore apo individët pajisen me aktin e marrjes së tokës në pronësi, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj, nëse janë përfitues të tokës bujqësore në përdorim, sipas vendimit nr. 452, datë 17.10.1992 të Këshillit të Ministrave ‘Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore’, të ndryshuar, dhe që nga hyrja në fuqi e këtij vendimi:

[....].b)) e përdorin tokën për veprimtari bujqësore, pavarësisht se nuk janë pajisur me aktin e përdorimit [...].

¹¹⁶ Neni 4: ‘I.Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore është organi përgjegjës për ndjekjen dhe përfundimin e procedurave për pajisjen e subjekteve me AMTP, sipas kërkesave, kritereve dhe kushteve të përcaktuara në këtë ligj’.

¹¹⁷Neni 14: “Kalimi në pronësi i tokës bujqësore bëhet nga ASHK-ja, sipas listës së përdoruesve të tokës, të miratuar me vendim të këshillit bashkiak.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, brenda 7 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcjellin pranë ASHK-së kërkesat për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, të administruara sipas ligjeve nr. 171/2014, ‘Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve’, dhe nr. 9948, datë 7.7.2008, ‘Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore’, si dhe kërkesat e administruara sipas nenit 6 të këtij ligji’.

6.9. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën Vetting dhe në DIPP-të vjetore periodike pjesën e tij takuese në tokën bujqësore të përfutuar, në bazë të ligjit nr. 7501, “Për tokën”*.

6.10. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹¹⁸ subjekti ka shpjeguar se nuk është pajisur me AMTP që ta njohë si përfutues të tokës bujqësore dhe se nuk është përdorues i saj. Më pas shpjegon se nuk ka pretenduar dhe deklaruar se ka dhënë me qira apo në përdorim tokë bujqësore dhe ka përfutuar të ardhura, por sqaron se babai i tij disponon tokë bujqësore dhe merret me ushtrimin e blegtorisë. Për sa kohë që kërkesa e babait të tij për t’u pajisur me AMTP nuk është shqyrtuar nuk mund të deklaronte diçka që nuk ka ndodhur dhe, si pasojë, është i pabazuar konstatimi se duhej të deklaronte pjesën e tij takuese.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

6.11. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

6.12. Ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, në nenin 24, të tij ka përcaktuar se: “*Kriteret për ndarjen, regjistrimin, ndryshimin, kalimin në pronësi, vlerësimin dhe dhënien me qira të tokës, si dhe detyrat e kadastrës, caktohen nga Këshilli i Ministrave*”. Referuar VKM-së nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, toka bujqësore është ndarë për çdo familje sipas numrit të frymëve të gjendjes familjare në datën 1.8.1991. Në numrin e frymëve të familjes, anëtarë të kooperativës bujqësore, do të llogariten të gjithë frymët e saj si, fëmijët etj. Sipas certifikatës së gjendjes familjare të shtetasit N.L., në datën 1.8.1991, rezultojnë se familja e tij përbëhej nga 7 anëtarë dhe pjesë e saj ishte edhe subjekti. Njësia Administrative D. me vërtetimin nr. *** prot., datë 25.6.2018, vërteton se norma e shpërndarjes së tokës bujqësore për frymë për fshatin Mali i Gjymtit ka qenë 5.7 dynym dhe, në bazë të kësaj norme, familja e shtetasit N.L. duhet të përfitonte 39.9 dynym. Kryesia e fshatit Mali i Gjymtit, me vërtetimin e datës 25.6.2018, vërteton se familja e shtetasit N.M.L. ka në përdorim rreth 40 dynym tokë bujqësore që e shfrytëzon që nga viti 1993.

6.13. Kodi Civil, në nenin 163, përcakton se: “*Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë*”. Si pasojë, është ligji nr. 7501/1991, që i ka njohur të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore subjektit të rivlerësimit për shkak se ka qenë në të njëjtën përbërje familjare me babain e tij N.L. në datën 1.8.1991. Pavarësisht se subjekti shpjegon se nuk e ka dhënë në përdorim apo me qira pjesën e tij dhe nuk ka krijuar të ardhura, referuar deklaratimeve të tij në deklaratën *Vetting*, DIPP-të vjetore dhe në pyetësorë, subjekti ka pretenduar se babai i tij, nëpërmjet përdorimit të tokës bujqësore të familjes, ku përfshihet edhe pjesa e subjektit, ka realizuar të ardhura për blerjen e apartamentit. Gjithashtu, subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokument ku të ketë hequr dorë nga pjesa e tij në tokën bujqësore.

¹¹⁸Shpjegime të subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi, datë 22.10.2021 (nr. *** prot., datë 22.10.2021, në Komision).

6.14. Në përfundim, Komisioni vlerëson se mosdeklarimi në deklaratën *Vetting*, i pjesës takuese në tokën bujqësore të përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, “Për tokën”, është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

7. Tokë bujqësore në pronësi të bashkëshortes/A.L. (Z.)

7.1. Referuar dokumentacionit të dërguar nga ASHK-ja Shkodër¹¹⁹ se shtetasi V.Gje. Z., në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, është pajisur me AMTP-në nr. ***, datë 26.5.1995, fshati Ndërllys, si dhe ka përfituar tokë bujqësore me sip. totale 2.000 m², nga të cilat 1.900 m² arë dhe 100 m² truall.

7.2. Në përgjigje të pyetjes nr. 3, të pyetësorit standard¹²⁰, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është martuar në datën 29.4.2007 me shtetasen A.V.Z., procedurë e cila është kryer në vitin 2008 në Zyrën e Gjendjes Civile.

7.3. Komisioni hetoi gjendjen civile të shtetasit V.Gj.Z. dhe kërkoi nga DPGJC-ja¹²¹ informacion lidhur me gjendjen familjare të datës 1.8.1991 dhe lëvizjet e mëpasshme. Në përgjigje, DPGJC¹²² vuri në dispozicion të Komisionit certifikatën e përbërjes familjare të datës 1.8.1991 të shtetasit V.Gj.Z., nga ku rezultoi se familja e tij përbëhej nga 9 pjesëtarë, ndërmjet të cilëve ishte edhe emri i shtetasës A.Z.

7.4. Komisioni konstatoi se në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP-të e viteve 2007, 2008 e në vijim, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nuk e ka deklaruar bashkëpronësinë mbi sipërfaqen e tokës bujqësore të përfituar nga babai i saj, në cilësinë e kryetarit të familjes bujqësore.

7.5. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *subjekti nuk ka deklaruar bashkëpronësinë e bashkëshortes në tokën bujqësore me sipërfaqe totale 2.000 m², nga të cilat 1.900 m² arë dhe 100 m² truall.*

7.6. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹²³, subjekti ka shpjeguar se bashkëshortja e tij nuk ka dijani lidhur me ekzistencën e kësaj AMTP-je, pasi në kohën kur është lëshuar ky dokument ka qenë 12 vjeçe. Gjithashtu, subjekti shpjegon se sipas përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në vitin 1993 është transferuar me gjendje civile nga Dukagjini në Bashkinë Shkodër dhe ky fakt tregon se në vitin 1995, kur pretendon se është lëshuar kjo AMTP, bashkëshortja e tij ka qenë në Shkodër duke ndjekur arsimin tetëvjeçar.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

7.7. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

¹¹⁹AMT-ja nr. ***, datë 26.5.1995, në emër të shtetasit V.Gj. Z., fshati Ndërllysë.

¹²⁰ Shpjegime datë 24.1.2020 (nr. *** prot., datë 24.1.2020, në Komision).

¹²¹(1) Shkresa nr. *** prot., datë 1.6.2021;(2) Shkresa nr. *** prot., datë 14.6.2021.

¹²²Shkresa nr. *** prot., datë 1.7.2021.

¹²³Shpjegime të subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi, datë 22.10.2021 (nr. *** prot., datë 22.10.2021, në Komision).

7.8. Kodi Civil, në nenin 163, përcakton se: “Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë”. VKM-ja nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, ka përcaktuar se toka bujqësore është ndarë për çdo familje sipas numrit të frymëve të gjendjes familjare në datën 1.8.1991. Sipas certifikatës së përbërjes familjare të datës 1.8.1991, të shtetasit V.Gj.Z., të administruar nga DPGJC-ja, rezultoi se familja përbëhej nga 9 pjesëtarë, ndërmjet të cilëve ishte edhe emri i shtetas A.Z., bashkëshortja e subjektit. Në këto kushte, znj. A.Z. është bashkëpronare në pjesën ideale të tokës bujqësore të përfituar nga babai i saj.

7.9. Në përfundim, Komisioni vlerëson se mosdeklarimi në deklaratën *Vetting*, i pjesës takuese të bashkëshortes së tij, në tokën bujqësore të përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, “Për tokën”, është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e pasurive.

8. Përdorimi i banesës në pronësi të shtetasve F.Rr.B. dhe Z.M.B., në Shkodër, për periudhën shtator 2004 – prill 2007

8.1. Në pyetjete të pyetjeve nr. 1 dhe 8 të pyetësorit standard,¹²⁴ subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në periudhën shtator 2004 – prill 2007 ka banuar në adresën: lagjja “****”, rruga “****”, p. ****, h. ****, ap. ****, k. ****, në pronësi të shtetasve F.Rr.B. dhe Z.M.B. Gjithashtu, subjekti deklaroi se nuk ka paguar qira, pasi shtetasja F.Rr.B. është kushëriri e parë e nënës së tij (vajza e xhaxhait) dhe ka pasur marrëveshje verbale vetëm për të rregulluar pjesën e soletës së pallatit me shpenzimet e tij, detyrim që e ka përmbushur, si dhe deklaroi se ka shpenzuar shumën rreth 50.000 lekë të reja për riparimin e saj. Bashkëlidhur ka dorëzuar kopje të certifikatës së pronësisë të pasurisë nr. ****, z. k. ****, vol. ****, f. ****, në pronësi të shtetasve F.Rr.B. dhe Z.M.B.

8.2. Komisioni hetoi lidhur me origjinën e pronës së mësipërme dhe nga verifikimi i sistemit elektronik të ASHK-së rezultoi se shtetasit F. dhe Z.B. janë bërë pronarë të apartamentit 1+1, me sip. 57 m², në bazë të akti të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme shtëpi banimi nr. ****, datë 7.8.1996.

8.3. Në pyetësorin nr. 3¹²⁵, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegonte se ku banonin këta shtetas gjatë kohës që kjo banesë përdorej prej tij, si dhe të paraqiste dokumentacionin ligjor justifikues. Në pyetjete¹²⁶ subjekti shpjegon se shtetasit F. dhe Z.B. banojnë prej shumë vitesh jashtë shtetit dhe në periudhën kohore kur e ka përdorur apartamentin e tyre kanë qenë në Itali, fakt i cili vërtetohet duke iu referuar hyrje-daljeve të këtyre shtetasve në sistemin *TIMS*. Gjithashtu, subjekti sqaron se për periudhat e shkurtra kohore që kanë ardhur në periudhën 2004 – 2007, nuk është përdorur banesa prej tyre, por kanë banuar tek të afërmit e tyre në Shkodër. Bashkëlidhur shpjegimeve subjekti ka dorëzuar printime nga Sistemi i Menaxhimit Total të Informacionit të dhëna për shtetasit F. dhe Z.B. për periudhën 2005 – 2021.

8.4. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit duke kërkuar informacion nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat¹²⁷ dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër¹²⁸ lidhur me procedimet penale ndaj shtetasve F.Rr.B. dhe Z.M.B. Në pyetjete, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat¹²⁹ dhe Prokuroria pranë Gjykatës së

¹²⁴ Shpjegime datë 24.1.2021 (nr. **** prot., datë 24.1.2020, në Komision).

¹²⁵ E-mail datë 8.9.2021.

¹²⁶ Shpjegime datë 13.9.2021.

¹²⁷ Shkresa nr. **** prot., datë 28.5.2021.

¹²⁸ Shkresa nr. **** prot., datë 28.5.2021.

¹²⁹ Shkresa nr. **** prot., datë 1.6.2021.

Rrethit Gjyqësor Shkodër¹³⁰ informon Komisionin se nuk është regjistruar procedim penal dhe nuk ka fashikuj procedimi përfshirë ato të mosfilluara, pushuara apo pezulluara në emër të shtetasve të mësipërm.

8.5. Në përfundim, Komisioni, për këtë pasuri, nuk konstaton problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

9. Shpenzimet mjekësore të kryera në vitin 2017

9.1. Në DIPP-në e vitit 2017 subjekti ka deklaruar shpenzime në total në shumën 6.288,11 euro në Modena, Itali, për kurimin e vajzës E.L., nga të cilat 5.688,11 euro për analiza dhe operacion dhe 600 euro për biletat.

9.2. Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se burim janë pagat e tij dhe të bashkëshortes dhe se shuma është paguar *cash* në dy këste nga bashkëshortja. Më tej, subjekti deklaroi se në nëntor të vitit 2017 ka marrë nga Shqipëria shumën 2.500 euro, me qëllim pagesën e shpenzimeve të operacionit të vajzës, ndërsa shuma 3.500 euro është marrë nga bashkëshortja e tij më parë.

9.3. Subjekti ka paraqitur faturat e muajve tetor¹³¹ dhe nëntor 2017¹³², të cilat përputhen me totalin e shumës së deklaruar nga subjekti (5.688,11 euro) dhe një faturë të muajit dhjetor 2017 në vlerën 82 euro.

9.4. Në DIPP-në e vitit 2017, subjekti ka deklaruar: “*Kursime nga paga ime, e bashkëshortes, si dhe shuma e përfituar nga kempit i vajzës, shuma 50.000 lekë*”. Me anë të pyetësorit nr. 2¹³³, Komisioni i kërkoi subjektit të deklaronte gjendjen e likuiditeteve *cash* në datën 31.12.2017 dhe në përgjigje¹³⁴, deklaroi se gjendja e likuiditeteve *cash* në datën 31.12.2017 ka qenë rreth 50.000 lekë.

9.5. Sa më lart, Komisioni kreu analizën financiare në datën 30.10.2017, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 95.189 lekë.

9.6. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 95.189 lekë për kryerjen e shpenzimeve mjekësore në vitin 2017*.

9.7. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹³⁵, subjekti, mbështetur edhe në raportin e audituesit ligjor, ka pretenduar, ndër të tjera, që të konsiderohet se gjatë kohës së kurimit të vajzës në Itali, bashkëshortja, së bashku me vajzën dhe djalin kanë qëndruar për rreth 3 muaj jashtë Shqipërisë, pranë të afërmeve të tyre në Modena, Itali.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

9.8. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të

¹³⁰Shkresa nr. *** prot. J. B., datë 24.6.2021; shkresa nr. *** prot., J. B., datë 8.7.2021.

¹³¹Faturat: nr. ***, datë 2.10.2017; nr. ***, datë 2.10.2017; nr. ***, datë 26.10.2017.

¹³²Faturat: nr. ***, datë 18.11.2017 dhe nr. ***, datë 18.11.2017.

¹³³E-mail datë 21.7.2021.

¹³⁴Shpjegime datë 28.7.2021.

¹³⁵Shpjegime të subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi, datë 22.10.2021 (nr. *** prot., datë 22.10.2021, në Komision).

administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyetën se:

9.9. Komisioni mori në konsideratë pretendimin e subjektit për reduktimin e shpenzimeve të jetesës për periudhën që bashkëshortja së bashku me vajzën dhe djalin kanë qëndruar në Itali dhe, për rrjedhojë, shpenzimet e jetesës për periudhën janar-tetor 2017 u reduktuan nga vlera 983.000 lekë në vlerën 880.768 lekë, çka bën që balanca e fondeve në datën 30.10.2017 të jetë 7.043 lekë.

9.10. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për përballimin e shpenzimeve mjekësore në vitin 2017.

10. Analiza financiare

10.1. Komisioni kreu analizën financiare duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur për periudhën 2000 – 2016, si dhe rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vitet 2006, 2007 dhe 2009.

10.2. Në përfundim, referuar shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, në prapësime, të cilat janë analizuar në paragrafët përkatës të vendimit, analiza financiare pasqyrohet në tabelën në vijim.

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime	Vitet me balancë negative
2000-2003	0	0	0	1,907,104	0	403,728	1,503,376	0
2004	0	0	0	691,823	0	143,864	547,959	0
2005	0	0	177,934	868,720	0	109,557	581,229	0
2006	2,400,000	0	485,381	907,382	0	109,557	-2,087,556	-2,087,556
2007	3,800,000	210,000	-486,175	1,072,905	2,100,000	867,802	-1,218,722	-1,218,722
2008	0	90,000	-46,905	1,239,319	0	713,886	482,338	0
2009	0	0	96,357	1,170,692	0	2,492,005	-1,417,670	-1,417,670
2010	0	100,000	190,237	1,391,769	0	425,801	675,732	0
2011	0	50,000	-19,147	1,423,535	0	626,518	766,164	0
2012	0	-350,000	-125,927	1,520,925	126,300	880,612	1,242,541	0
2013	91,740	300,000	-183,721	1,553,450	69,900	917,286	498,046	0
2014	0	50,000	15,697	1,651,522	30,000	1,385,525	230,300	0
2015	0	100,000	19,119	1,847,309	0	1,290,156	438,034	0
2016	0	100,000	-33,794	1,787,526	0	1,466,905	254,416	0
TOTAL	6,291,740	650,000	89,056	19,033,981	2,326,200	11,833,200	2,496,186	-4,723,947

11. Në lidhje me kontrollin e konfliktit të interesit

11.1. Nga shqyrtimi i dosjes penale rezultoi se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në datën 20.10.2014, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, sipas nenit 199/a të Kodit Penal ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. (“****” sh.p.k.) ndaj shtetasve A. dhe B.Ç. Ky procedim penal është bashkuar me procedimin penal nr. ***, për veprën penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë” dhe me procedimin penal nr. *** për veprat penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, “punësim i paligjshëm” dhe “ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar në nenet 289, 170/a dhe 199/a të Kodit Penal, duke marrë numrin ***, viti 2014.

11.2. Nga shqyrtimi i dosjes penale nr. ***, viti 2014, konstatohet se prokurori i çështjes është subjekti i rivlerësimit Ermir Lelçi, i cili me administratorin e shoqërisë “****” sh.p.k. A.Ç. ka lidhur kontratë kapari dhe shitblerjeje për apartamentin në zotërim të tij. Nga hetimi ka rezultuar se në fshatin P., Plazh - Velipojë, në afërsi të grykëderdhjes së Bunës, është ndërtuar

një godinë ***-katëshe + bodrum, karabina, “****” (kompleks), nga shoqëria “****” sh.p.k. Për këtë objekt të ndërtuar janë marrë masa administrative nga INUV, Komuna Velipojë, si procesverbali i konstatimit të ndërtimit pa leje, vendimi për pezullimin e punimeve dhe njoftimi i subjektit. Gjithashtu, ALUIZNI Shkodër ka konfirmuar se kompleksi “****” nuk ka bërë aplikim për legalizim objekti në Komunën Velipojë, duke sqaruar se informacioni i mësipërm i referohet deklarimeve të periudhës 2005 - 2006 dhe vitit 2013 dhe procesi i deklaramit të objekteve pa leje është i hapur deri në dhjetor të vitit 2014.

11.3. Nga hetimi, subjekti i rivlerësimit, si prokuror i çështjes ka arritur në përfundimin se objekti është ndërtuar brenda vitit 2013 dhe është bërë në tokën në pronësi të kësaj shoqërie. Në këto kushte, duke u bazuar në ligjin nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie” dhe në ligjin nr. 92/2015, datë 23.7.2015, “Për disa shtesa në ligjin nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie” dhe për shkak se kur vepra penale parashikon dënim deri në 1 vit burgim, në kërkesën për gjykim dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të datës 30.12.2015, ka parashtruar se nuk mund të merret si i pandehur asnjë person për këtë vepër penale.

11.4. Komisioni konstaton se ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në nenin 4¹³⁶ përcakton se dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga çdo zyrtar, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje që përfshin aktet e organeve të prokurorisë.

11.5. Në rastin konkret, nga faktet e pasqyruara gjatë rivlerësimit të pasurisë, rezulton se subjekti i rivlerësimit në vitin 2006 ka lidhur kontratën e kaparit për blerjen e një apartamenti banimi 3+1 dhe më pas në vitin 2007, bashkë me babain e tij kanë lidhur kontratën përfundimtare të shitblerjes me ish-administratorin dhe ortakun e vetëm të shoqërisë “****” sh.p.k. (“****” sh.p.k.) dhe pagesat për blerjen e këtij apartamenti janë bërë në llogari të shoqërisë dhe të ortakut/administratorit të saj A.Ç. Këto fakte provojnë se subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “****” sh.p.k. kanë pasur ndërmjet tyre marrëdhënie me të drejta dhe detyrime pasurore, të cilat sipas gërmës “a”¹³⁷, të pikës 1, të nenit 5, të ligjit nr. 9367/2005, parashikohen si interesa private të zyrtarit. Pavarësisht faktit se marrëdhënia ndërmjet tyre ka përfunduar në vitin 2007 me pagimin e kështit të fundit për blerjen e apartamentit, në gërmën “e”¹³⁸, të pikës 1, të nenit 5, të ligjit nr. 9367/2005 parashikohet se interesi privat i zyrtarit përfshin edhe angazhimet e mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë të drejtat dhe detyrimet pasurore. Si pasojë, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një interes privat me shoqërinë “****” sh.p.k. ndaj së cilës zhvillonte hetimet.

11.6. Nga faktet e analizuar më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *subjekti i rivlerësimit është në kushtet e konfliktit të interesit gjatë hetimit të këtij procedimi penal.*

11.7. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹³⁹ subjekti ka shpjeguar se nuk mjafton fakti që së bashku me babain e tij të ketë blerë një apartament te shtetasi A.Ç., marrëdhënie që ka përfunduar në vitin 2007, që të jetë në konflikt interesi, pasi duhet që të ketë pasur marrëdhënie miqësie me të dhe pas këtij viti edhe kjo marrëdhënie të jetë e konkretizuar si p.sh., në një

¹³⁶Ligji nr. 9367/2005, neni 4: “1. Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë rregulla të detyrueshme për t’u zbatuar nga: [...]a) çdo zyrtar, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për: [...] (ii) akte të organeve gjyqësore, noteriale, për ekzekutimin e titujve ekzekutivë nga organet e përmbartimit dhe akte të organeve të prokurorisë”.

¹³⁷Neni 5: “1. Interesat private të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre”.

¹³⁸Neni 5: “1. Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: ... e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni”.

¹³⁹Shpjegime të subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi, datë 22.10.2021 (nr. *** prot., datë 22.10.2021, në Komision).

udhëtim jashtë shtetit, me marrjen e një shume huaje nga ky shtetas, me marrjen e ndonjë ftese në evenimente që mund të ketë pasur gjatë ushtrimit të aktivitetit apo të jetë favorizuar me një çmim më të ulët të apartamentit sesa vlera reale që ka qenë në treg. Në vlerësimin e tij mungojnë të gjitha këto rrethana. Gjithashtu, subjekti shpjegon se marrëdhënia që ka pasur me këtë shtetas ka përfunduar në vitin 2007 dhe as para këtij viti dhe as më pas tij nuk ka pasur marrëdhënie miqësie apo interesi me shtetasin A.Ç. dhe me bashkëshorten e tij B.Ç.

11.8. Në vijim, subjekti shpjegon se në rastin konkret ka qenë një regjistrim procedimi penal për disa vepra penale dhe se ia ka bërë të njohur Drejtuesit të Prokurorisë rrethanat me shoqërinë “****” sh.p.k., duke e sqaruar për blerjen e apartamentit dhe përfundimin e marrëdhënies në vitin 2007 dhe se këtë deklaram e ka bërë verbalisht dhe jo me shkrim. Meqenëse drejtuesi nuk pati ndonjë reagim ka regjistruar procedimin penal duke e regjistruar pa emër personin që i atribuohet vepra penale dhe nga oficeri i policisë gjyqësore është bërë hetim i plotë. Gjithashtu, subjekti shpjegon se nuk ka qenë dakord për bashkimin e procedimit penal pasi referuar praktikës për vendimet e bashkimit rregulli është që prokurori që ka regjistruar i pari procedimin penal duhet të ndjekë procedimin e bashkuar dhe ky rregull është shkelur nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe pavarësisht reagimit të tij nuk u reflektua nga drejtuesi i Prokurorisë Shkodër. Në fund ka shpjeguar se ka bërë një hetim të plotë për të gjitha veprat penale dhe nuk është ndikuar nga marrëdhënia që kishte përfunduar në vitin 2007.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

11.9. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

11.10. Nga hetimi administrativ rezulton se subjekti i rivlerësimit ka lidhur në vitin 2006 kontratën e kaparit nr. ***, datë 7.2.2006, për blerjen e një apartament banimi 3+1 dhe më pas në vitin 2007, bashkë me babain e tij kanë lidhur kontratën përfundimtare të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me nr. ***, datë 6.6.2007, me ish-administratorin dhe ortakun e vetëm të shoqërisë “****” sh.p.k. (“****” sh.p.k.) dhe se pagesat për blerjen e këtij apartamenti janë bërë në llogari të shoqërisë dhe të ortakut/administratorit të saj A.Ç. Këto fakte provojnë se subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “****” sh.p.k. kanë pasur ndërmjet tyre marrëdhënie me të drejta dhe detyrime pasurore.

11.11. Komisioni vlerëson se në kohën e lidhjes së kontratës së kaparit në vitin 2006 dhe më pas në kohën e lidhjes së kontratës së shitblerjes në vitin 2007, subjekti nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit në raport me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe shtetasin A.Ç., pasi subjekti është caktuar për ndjekjen e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “ndërtim i paligjshëm” ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. (“****” sh.p.k.) me vendimin e datës 3.7.2015, të Drejtuesit të Prokurorisë. Më pas, me vendimin e datës 30.12.2015 ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. ***, të vitit 2014, veprime të cilat kanë ndodhur shumë kohë pasi marrëdhënia ndërmjet tyre kishte përfunduar.

11.12. Gjithashtu, Komisioni vlerëson se çmimi i vendosur për shitjen e apartamentit në shumën 6.200.000 lekë nuk konsiderohet si trajtim preferencial në kuptim të pikës 1¹⁴⁰, të nenit

¹⁴⁰Pika 1, e nenit 23, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, parashikonte: “1. Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji”.

23, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, pasi referuar udhëzimit nr. 5, datë 7.9.2006, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit ‘k’ për vitin 2006”, kostoja e shitjes për metër katror në tregun e lirë të apartamenteve në qytetin e Shkodrës është në vlerën 45.763 lekë dhe çmimi i vendosur në kontratën e kaparit dhe të shitjes është i përafërt me çmimin e tregut të lirë.

11.13. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

Përfundimet e Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë

12. Trupi gjyqës, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, arrin në këto përfundime:

Lidhur me apartamentin e banimit me sip. 138 m², në vlerën 6.200.000 lekë, në Shkodër, subjekti i rivlerësimit:

- i. Ka kryer deklarin jo të saktë dhe në përputhje me ligjin të drejtat reale mbi këtë apartament, si dhe detyrimet që rridhnin nga kjo kontratë në DIPP-në e vitit 2006, e vlerësuar kjo në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e kësaj pasurie.
- ii. Është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pronësinë mbi këtë apartament në masën 33% dhe përdorimin e pjesës takuese prej 77% në pronësi të babait të tij, duke ngritur dyshime të arsyeshme për paraqitjen e rrethanave jo të vërteta, rrethana të cilat tentojnë të fshehin nga kontrolli apo verifikimi marrëdhënien e plotë të pronësisë me këtë pasuri dhe, për pasojë, edhe të burimit të krijimit të saj në shumën 4.100.000 lekë, që përbëhet nga këstet e paguara nga babai i subjektit, duke u gjendur në kushtet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- iii. Ka mungesë të burimeve të mjaftueshme dhe të ligjshme për shlyerjen e parakohshme të kredisë në shumën 2.110.000 lekë, nga personi tjetër i lidhur/dhuruesit/babai të tij, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- iv. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe pagimin e detyrimeve në shumën 4.723,947 lekë, referuar analizës financiare për periudhën 2003 – 2016, bazuar në shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, në prapësime, të cilat janë analizuar në paragrafët përkatës të vendimit.

12.1 Si konkluzion mbi rivlerësimin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pamjaftueshëm në lidhje me këtë kriter, duke u gjendur në kushtet e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 17.1.2020, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 16.1.2020, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

2. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit Ermir Lelçi: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitetet si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

3. Pavarësisht raportit të dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

Hetimi i Komisionit

4. Në deklaratën e kontrollit të figurës subjekti ka deklaruar se ka pasur një mbiemër tjetër të papërdorur. Në pyetësin nr. 2¹⁴¹, Komisioni kërkoi shpjegime se në cilin dokument ekziston ky mbiemër dhe të paraqesë dokumentacion provues. Në përgjigje¹⁴², subjekti deklaroi se nuk e ka ndryshuar asnjëherë mbiemrin në gjendjen civile, por në dekretin e Presidentit të Republikës për emërimin si prokuror në vitin 2004 është shkruar mbiemri Lelçaj dhe ky mbiemër figuron edhe në Prokurorinë e Përgjithshme te lista e prokurorëve. Në vijim, subjekti deklaroi se gjatë marrëdhënieve me gjykatën dhe institucioneve të tjera ka përdorur gjithmonë mbiemrin Lelçi. Faktin se nuk ka ndryshuar mbiemrin e vërteton me certifikatën e gjendjes civile të vitit 1991.

5. Nga verifikimi i certifikatës së gjendjes familjare të shtetasit N.L., të datës 18.1.2017, vërehet se në trungun familjar të tij ndodhet edhe emri i subjektit, Ermir, me mbiemër Lelçi dhe kjo certifikatë mban edhe shënimin: *“Mbështetur në regjistrin themeltar Mali i Gjymtit 8/8, 8/9 shtetasi Ermir Lelçi nuk ka bërë ndryshime në gjeneralitete”*. Me vërtetimin nr. *** prot., datë 19.1.2017, të paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësit nr. 2, Njësia Administrative D. vërteton se shtetasi Ermir N. Lelçi është i njëjti person me shtetasin Ermir N. Lelçaj dhe person tjetër me këtë emër në Njësinë Administrative D. nuk ka. Gjithashtu, sipas certifikatës së gjendjes familjare të datës 1.8.1991, e gjithë familja e shtetasit N.L., ku pasqyrohet dhe emri i subjektit, është shënuar me mbiemrin Lelçi.

6. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga KLP-ja me shkresën nr. *** prot., datë 3.8.2021, Komisioni konstaton se bashkëlidhur procesverbalit *“Për marrjen në dorëzim të formularit të vetëvlerësimit profesional dhe dokumentacionit bashkëngjitur tij nga subjekti i rivlerësimit Ermir Lelçi”*, gjendet kopje e shkresës nr. *** prot., datë 1.2.2000, e Prokurorisë së Përgjithshme *“Për emërim kuadri”*, ku citohet se me urdhrin nr. ***, datë 31.1.2000, të Prokurorit të Përgjithshëm, z. Ermir Lelçi emërohet dhe titullohet oficer i policisë gjyqësore i seksionit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat. Gjithashtu, gjendet edhe shkresa nr. *** prot., datë 12.7.2004, e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, në të cilën citohet se me Dekretin nr. ***, datë 5.7.2004, të Presidentit të Republikës, z. Ermir Lelçaj, me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat emërohet prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

7. Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (a) subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; (b) nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (c) dhe nuk ka bërë deklaramit të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

¹⁴¹ E-mail datë 21.7.2021.

¹⁴² Shpjegime datë 28.7.2021.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjisllacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organ ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përgatitur një raport për vlerësimin profesional si vijon:

3. Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësia profesionale;
- b) aftësia organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

4. Ky vlerësim është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit së bashku me tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin, të paraqitura nga subjekti; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iii) të dhënave nga 23 prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, Sektori i Protokoll-Arkivit, si dhe burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

5. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se subjekti, me urdhrin nr. ***, datë 31.1.2000, të Prokurorit të Përgjithshëm, është emëruar oficer i policisë gjyqësore i seksionit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat dhe me Dekretin nr. ***, datë 5.7.2004, të Presidentit të Republikës është emëruar prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nga korriku i vitit 2004 e në vazhdim ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Aftësitë profesionale

Njohuritë ligjore

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se: në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjithashtu, rezulton se ka shfaqur aftësi në interpretimin e ligjit, në analizën e jurisprudencës dhe në arsyetimin ligjor e logjik.

Arsyetimi ligjor

Bazuar në aktet e dorëzuara dhe në dosjet e shortuara konstatohet se subjekti i rivlerësimit Ermir Lelçi shfaq aftësi në pasqyrimin e rrethanave të faktit, në analizën e provave dhe në ballafaqimin e tyre me bazën ligjore të aplikueshme. Aktet e përpiluara prej tij paraqiten të qarta dhe të kuptueshme. Respektohen përgjithësisht rregullat e drejtshkrimit dhe niveli i

arsyetimit të vendimeve të vëzhguara është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor.

Hetimi i Komisionit

6. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLP-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe me pesë dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime për dosjet 3 dhe 4, të shortuara, si vijon:

7. Lidhur me dosjen nr. 3, procedimi penal nr. *** i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, datë regjistrimi 25.4.2014, për veprën penale “mashtrim”, i parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti për konstatimin se: *“Subjekti i rivlerësimi nuk ka kërkuar heqjen dorë nga procedimi penal në kundërshtim me nenin 17, të Kodit të Procedurës Penale”*.

8. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁴³, subjekti sqaron se caktimi i kësaj çështjeje është bërë nga zv/Drejtuuesi i Prokurorisë, A.M., e cila ka pasur dijeni se motra e tij punonte pranë DRSSH-së, pasi kishte njohje personale me të dhe do të thotë që ky material i është nënshtruar filtrit të parë nga zv/Drejtuuesi i Prokurorisë. Në vijim, subjekti ka pasqyruar vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër në çështje të ngjashme, në rastin e shtetasit Sh.K., ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 23.1.2015, ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të prokurorit për mosfillimin e hetimeve, duke arsyetuar se gjendej në kushtet e papajtueshmërisë për shkak se motra e tij ka firmosur kallëzimet, ndërsa Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 7.10.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke arsyetuar: *së pari* – kallëzimi penal është bërë nga titullari i institucionit, ndërsa përpilimi është bërë nga juristët; *së dyti* – prokurori ka vendosur mosfillimin për shkak se vepra penale është parashkruar, duke bërë që në thelb vendimi i prokurorit në këtë rast ka qenë në disfavor të institucionit që ka bërë kallëzimin; *së treti* – vendimi i mosfillimit të çështjes është vendim ku prokurori nuk kryen veprime të mirëfillta hetimore, pra procedimi penal nuk fillon dhe nuk regjistrohet dhe rastet e neneve 26, 16 dhe 17 nuk gjejnë vend; *së katërti* – për veprimet e kryera nga shtetasi Sh.K. prokurori nuk mund të fillojë ushtrimin e ndjekjes penale për shkak se ndjekja penale për veprat penale për të cilat dyshohet ky shtetas është parashkruar dhe, për këtë shkak, vendimi i prokurorit për mosfillimin e çështjes penale është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

9. Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit, përkatësisht, vendimet: nr. ***, datë 23.1.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe nr. ***, datë 7.10.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

10. Nga shqyrtimi i vendimeve gjyqësore të paraqitura nga subjekti, rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në vendimin nr. ***, datë 23.1.2015, ka arritur në përfundimin se subjekti ndodhej në kushtet e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit, për shkak se motra e tij ka firmosur kallëzimin penal dhe Gjykata e Apelit Shkodër në vendimin nr. ***, datë 7.10.2015, ka analizuar faktin e mësipërm dhe ka arritur në përfundimin se konkluzioni i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është i pabazuar në ligj. Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar se subjekti është ndodhur në të njëjtën situatë edhe në dy raste të tjera të trajtuara në paragrafin 10, denoncime nga publiku, ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka konstatuar papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit të prokurorit, ndërsa Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e ankimit të DRSSH-së Shkodër.

¹⁴³Shpjegime të subjektit të rivlerësimit datë 22.10.2021.

11. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se vendimi i kontestuar i është nënshtruar vlerësimit të fakteve, interpretimit të ligjit dhe formimit të bindjes së brendshme të trupit gjykues gjatë procesit gjyqësor nga gjykatat kompetente dhe meritojnë trajtimin dhe vlerësimin e një gjykate më të lartë. Në këto kushte, analizimi i faktit të konstatuar gjatë hetimit administrativ do të dilte jashtë juridiksionit kontrollues të Komisionit, në kuptim të pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

12. Në përfundim: Komisioni vlerësoi të mos trajtojë në vendim rastin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit, të parashikuar nga nenet 17 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale.

13. Lidhur me dosjen nr. 4, procedimi penal nr. ***, të i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i regjistruar për veprën penale “vrasje me dashje” në tentativë, “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 76-22 e 278/4 të Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit R.T. Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti për konstatimin se: *“(i) nuk ka konstatuar mospërputhje ndërmjet aktekspertimit mjeko-ligjor dhe aktekspertimit kimik të teshave të të dëmtuarit; (ii) nuk është pyetur shtetasja F.H., e cila rezulton se ka qenë në të njëjtën tavolinë me të pandehurin; (iii) nuk ka kryer ekspertimin psikiatriko-ligjor të të pandehurit në kundërshtim me nenin 17 të Kodit Penal”*.

14. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁴⁴, subjekti shpjegon se edhe pas kryerjes së veprimeve hetimore të përcaktuara nga drejtuesi i prokurorisë këto akte nuk kanë ndikuar në ndryshimin e cilësimit të veprës penale apo të rrethanave të kësaj ngjarjeje. Po ashtu, subjekti shpjegon se ka zbatuar me korrektësi urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë, si dhe ka ushtruar edhe të drejtën e ankimit. Gjykata e Apelit, gjithashtu, nuk e ka ndryshuar cilësimin ligjor.

Analiza e Komisionit

15. Nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal nr. *** rezulton se shtetasi L.M. i kishte dhënë hua shumë 3.000 euro të pandehurit R.T., me një përqindje mujore prej 200 euro. Ka rezultuar se për shkakun se i pandehuri R.T. nuk kishte paguar detyrimet sipas marrëveshjes, shuma kishte shkuar në 4.500 euro. Në datën 6.12.2013, rreth orës 22:00, ndërsa po shkonte për në banesë me automjet, shtetasi L.M. ka parë rastësisht të pandehurin R.T. në lokalin e shtetasit A.B. dhe i kërkuar shumë e parave që i detyrohej. Fillimisht i pandehuri i ka thënë që ta diskutonin të nesërmen, por pas debateve i ka thënë që do t’ia sillte paratë po atë ditë. Pasi ka bërë një xhiro me automjet, shtetasi L.M. është rikthyer te lokali dhe ka takuar sërish të pandehurin R.T. Ky i fundit i ka thënë që të shkonin së bashku drejt një rrugice në drejtim të një pallati ***-katësh. Sapo janë futur në rrugicë, i pandehuri R.T. ka nxjerrë një armë zjarri (pistoletë) dhe ia ka drejtuar në gjoks shtetasit L.M., i cili ka mundur ta shmangë një moment pistoletën, por i pandehuri, duke u tërhequr, e ka qëlluar një herë në këmbë dhe, më pas, edhe dy herë të tjera në trup.

16. Gjatë hetimeve janë kryer dy ekspertime mjeko-ligjore: ekspertimi teknik-balistik i gëzhgojave të sekuestruara dhe ekspertimi teknik-kimik i rrobave të sekuestruara. Për shkak të sjelljes së të pandehurit është kryer edhe ekspertimi psikiatriko-ligjor. Eksperti, në aktin nr. ***, datë 16.4.2014, ka konkluduar se i pandehuri R.T. vuante nga çrregullim i personalitetit, i cili i kishte filluar në adoleshencën e vonë. Ky çrregullim nuk kishte ndikuar në aftësinë për të qenë i përgjegjshëm para ligjit, pasi nuk e kishte ulur ekuilibrin mendor në një shkallë të tillë që të mos kishte kuptuar aktin që kishte kryer dhe pasojat.

17. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin e datës 28.11.2013, ka vendosur caktimin e masës “sigurim personal të arrestit me burg ndaj të dyshuarit”. Subjekti, me kërkesën e datës 4.2.2014, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për gjykimin

¹⁴⁴Shpjegime të subjektit të rivlerësimit, datë 22.10.2021.

e procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, në ngarkim të të pandehurit R.T., i akuzuar për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armës luftarake”, “vrasje me dashje” e mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 278/4, 76 dhe 22 të Kodit Penal.

18. Drejtuesi i Prokurorisë, në vendimin e datës 24.2.2014, ka arritur në përfundimin se nuk janë kryer të gjitha veprimet e domosdoshme hetimore, të cilat do ta sqaronin në mënyrë të shteruar ngjarjen dhe do të identifikonin saktësisht të vërtetën objektive dhe në arsyetimin e vendimit të tij, ka arsyetuar se: *“(i) nuk është bërë një skicë e vendit të ngjarjes për të vendosur në dinamik provat e gjetura në vendngjarje, si pozicioni i gëzhojave, këpuca, gjurmët e frenimit etj.; (ii) ka mospërputhje ndërmjet aktekspertimit mjeko-ligjor dhe aktekspertimit kimik të teshave të të dëmtuarit, ku sipas aktekspertimit mjeko-ligjor rezultojnë 3 ose 4 dëmtime me armë zjarri dhe, në këto kushte, lindte i nevojshëm riekspertimi mjeko-ligjor; (iii) nuk është pyetur shtetasja F.H., e cila rezulton se ka qenë në të njëjtën tavolinë me të pandehurin; (iv) në të njëjtën kohë i pandehuri ka pretenduar se vuan nga sëmundje mendore të përcaktuara nga vizitat e mjekut Gj.P. dhe, për këtë, ka kërkuar ekzaminim psikiatriko- ligjor. Prokurori i çështjes ka rrëzuar kërkesën për ekspertim me argumentin se gjatë seancës së masës së sigurimit i pandehuri ishte koshient. Çmujmë se organi procedues nuk mund të anashkalojë një kërkesë të tillë, aq më tepër kur shoqërohet me dokument që provon kurimin e të pandehurit”.*

19. Në zbatim të detyrave të lëna nga Drejtuesi i Prokurorisë, subjekti, me vendimet e datës 4.3.2014, ka vendosur kryerjen e riekspertimit mjeko-ligjor të shtetasit L.M., kryerjen ekspertimit psikiatriko-ligjor të shtetasit R.T., si dhe ka marrë në pyetje shtetasen F.H.

20. Me kërkesën e datës 5.5.2014, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, subjekti ka kërkuar gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, ndaj të pandehurit R.T., për veprat penale “vrasje me dashje”, të mbetur në tentativë dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 278/4, 76 dhe 22 të Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 23.9.2014, ka vendosur deklaram fajtor të të pandehurit R.T. për veprën penale “vrasje me dashje”, e mbetur në tentativë dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim dhe deklarimin fajtor për veprën penale “mbajtje pa leje të armëve luftarake” duke e dënuar me 7 vjet burgim dhe në zbatim të nenit 55/2 të Kodit Penal e ka dënuar përfundimisht me 17 vjet burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 18.5.2015. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 8.2.2017, ka vendosur lënien në fuqi pjesërisht të vendimit nr. ***, datë 18.5.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër, për sa i përket fajësisë dhe masës së dënimit të të pandehurit për veprën penale “vrasje me dashje”, të mbetur në tentativë dhe ndryshimin e vendimit duke e deklaruar fajtor të pandehurin për veprën penale “mbajtje pa leje të armëve luftarake” dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim, si dhe në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal dënimin e tij me 12 vite burgim.

21. Komisioni, nga analizimi i akteve të dosjes penale, konstaton se avokati i të pandehurit ka paraqitur kërkesën e datës 27.1.2014 për kryerjen e ekspertimit psikiatrik të tij. Kësaj kërkesë i është bashkëlidhur raporti mjekësor i datës 25.1.2014, i Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor, ku pasqyrohen problemet e shëndetit mendor të tij, vizita e bërë në ambientet e shtëpisë për shkak se nuk dëshironte të identifikoheshin edhe mjekimet e përdorura. Me vendimin e datës 29.1.2014, subjekti ka vendosur mospranimin e kërkesës me arsyetimin se gjendja e pacientit nuk ka qenë aq e rëndë, pasi në të kundër ai do të ishte shtruar në pavijonin psikiatrik, ku dhe do t’i nënshtrohej një terapie intensive për diagnozën e pretenduar dhe në seancën gjyqësore (të vleftësimit të masës së sigurimit) ka qenë koshient dhe ka kuptuar veprimet e tij kriminale. Gjithashtu, Komisioni konstaton se sipas aktekspertimit mjeko-ligjor nr. ***, datë 5.12.2013, janë konstatuar 4 plagë, ndërsa sipas aktekspertimit teknik-kimik nr. ***, datë 19.12.2013, të teshave të të dëmtuarit janë konstatuar 2 dëmtime.

22. Komisioni vlerëson se vendimi i subjektit për rrëzimin e kërkesës për kryerjen e ekspertimit psikiatrik të të pandehurit vjen në kundërshtim me paragrafin 2, të nenit 178, të Kodit të Procedurës Penale¹⁴⁵, që përcakton se *nuk lejohet ekspertimi për cilësitë psikike që nuk varen nga shkaqet patologjike*. Në rastin konkret, raporti i Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor ka vërtetuar se i pandehuri vuante nga sëmundje të shëndetit mendor dhe trajtohej me antidepresivë, tranquizilantë dhe psikoterapi intensive, duke provuar shkaqet patologjike të çrregullimeve psikike të pandehurit. Mosverifikimi i gjendjes psikike të të pandehurit, kur vërtetohen shkaqet patologjike, ndikon drejtpërdrejt në përcaktimin e përgjegjësisë penale të tij sipas nenit 17¹⁴⁶ të Kodit Penal, që parashikon rastet e papërgjegjshmërisë për shkak të gjendjes mendore.

23. **Në përfundim**, Komisioni vëren mangësi profesionale të subjektit për sa i përket aspektit të njohurive ligjore, bazuar në aftësinë për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore dhe për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kriteret të parashikuara nga pika 2¹⁴⁷, e nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Aftësitë organizative

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokuror Ermir Lelçi, për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezultojnë se janë 577 çështje të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit, të marra në shqyrtim për shortim. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 12.10.2020, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për përzgjedhjen e pesë dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit Tetor 2013 – Tetor 2016, rezultojnë se afatet kohore të zgjidhjes së praktikave që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short, janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti Ermir Lelçi ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës duke kryer detyrat e ngarkuara me efikasitet.

Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokuror Ermir Lelçi, për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezultojnë se subjekti i rivlerësimit, në rastin e vendimmarrjes mbi mosfillimin e procedimit penal, të ketë argumentuar mungesën e elementëve të veprës penale. Në procedimet penale, për të cilat është vendosur pushimi i hetimeve, është argumentuar vendimmarrja për pushimin e procedimeve penale. Subjekti i

¹⁴⁵Kodi i Procedurës Penale, neni 178: “1.Ekspertimi lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore.

2.Nuk lejohen ekspertimet për të përcaktuar profesionizmin në veprën penale, prirjet kriminale, karakterin dhe personalitetin e të pandehurit dhe në përgjithësi cilësitë psikike që nuk varen nga shkaqet patologjike”.

¹⁴⁶Kodi Penal, neni 17: “ Nuk ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe, për pasojë, nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen veprën penale. Personi që në kohën e kryerjes së veprës penale vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik, që ka ulur ekuilibrin e tij mendor për të kuptuar dhe kontrolluar plotësisht veprimet apo mosveprimet e tij, është i përgjegjshëm, por kjo rrethanë mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e masës dhe llojit të dënimit”.

¹⁴⁷Ligji nr. 96/2016, neni 73:“Aftësitë profesionale të prokurorit”, parashikon se: “1.Vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorit përfshin njohuritë ligjore dhe të arsye-timit ligjor. 2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën”.

rivlerësimit ka shfaqur aftësitë e nevojshme mbi kontrollin e hetimeve në lidhje me çështjet me të pandehur, të dërguara për gjykim.

Aftësia për të administruar dosjet

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016, rezulton se nga vëzhgimi i akteve të dorëzuara nga subjekti dhe pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se prokuror Ermir Lelçi, në ushtrim të kompetencave të tij, ka aftësi për të administruar dosjet.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Etika në punë

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë.

Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokuror Ermir Lelçi, si dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Aftësia e komunikimit

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokuror Ermir Lelçi, për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk rezultojnë të dhëna që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces.

Aftësia për të bashkëpunuar

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokuror Ermir Lelçi, për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se në të gjitha burimet e informacioneve nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë.

Gatishmëria për t'u angazhuar

Prokurori Ermir Lelçi, nga të dhënat në dosjen personale, ka pjesëmarrje në 8 trajnime. Lënda e trajnimeve ku ka marrë pjesë kanë lidhje me detyrën e prokurorit.

Të dhëna nga burimet arkivore të KLP-së

24. Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.6.2021, i kërkoi informacion Prokurorisë së Përgjithshme nëse nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore ka të regjistruar

procedim penal, mosfillim ose pushim në ngarkim të subjektit Ermir Lelçi. Prokuroria e Përgjithshme¹⁴⁸ ka përcjellë pranë Komisionit informacionin si vijon:

25. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasës Z.M., ka regjistruar materialin kallëzues nr. ***. Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se kallëzuesja, banuese në Shkodër, kishte depozituar kallëzim penal ndaj shtetasit I.M., duke pretenduar se për shkak të mbiemrit ky i fundit kishte zaptuar një sipërfaqe toke prej 395 m², të kthyer nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Shkodër. Kallëzuesja ka shpjeguar se ai kishte ndërtuar edhe një objekt trekatësh brenda kësaj sipërfaqeje. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, që është hetuar nga prokurori Ermir Lelçi. Pas verifikimeve të kryera, prokurori ka vendosur të mosfillojë procedimin penal, vendim i cili është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në lidhje me vendimin e mosfillimit, shtetasja Z.M. ka kallëzuar penalisht prokurorin Ermir Lelçi për kryerje të veprës penale të “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

26. Prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, nga verifikimet e kryera, ka konkluduar se nuk janë konstatuar elemente të veprës penale, të parashikuara nga neni 248 i Kodit Penal, vendimi i prokurorit Ermir Lelçi ishte marrë në përputhje me ligjin dhe provat e administruara. Në datën 22.7.2016 është vendosur mosfillimi i procedimit penal mbi bazën e kallëzimit të shtetasës Z.M. ndaj prokurorit Ermir Lelçi, bazuar në nenet 290/1/ç e 291 të Kodit të Procedurës Penale.

27. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasës A.B.M., ka regjistruar materialin kallëzues nr. ***. Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se kallëzuesja ka depozituar kallëzim penal ndaj prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Ermir Lelçi, M.F. dhe Xh.L. Kallëzimi penal është depozituar në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila e ka dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë. Kallëzuesja ka pretenduar se asnjëri nga prokurorët nuk e kanë njohur me vendimmarrjen e tyre, duke kërkuar që të kryheshin hetime për punonjësit e ZVRPP-së Shkodër për falsifikim dokumentesh dhe mashtrim.

28. Pas verifikimeve të kryera, prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka konstatuar se ish-in regjistruar kallëzimi penal nr. ***, i hetuar nga prokurori Ermir Lelçi, kallëzimi penal nr. ***, i hetuar nga prokurore M.F. dhe procedimi penal nr. ***, i hetuar nga prokurori Xh.L. Ka rezultuar se vendimmarrjet e të tre prokurorëve ish-in njoftuar, përkatësisht me shkresat nr. *** prot., datë 20.9.2016, nr. *** prot., datë 13.1.2017, dhe nr. *** prot., datë 9.11.2016. Prokurori ka konkluduar se kallëzuesja ishte njohur me vendimmarrjet e prokurorëve dhe se ka pasur të drejtën ligjore për t'i ankimuar vendimet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në lidhje me kërkesën e kallëzueses për kryerje të hetimeve të mëtejshme, prokurori ka konkluduar që kompetencën për kryerjen e tyre e kishte Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në datën 15.1.2018 është vendosur mosfillimi i procedimit penal mbi bazën e kallëzimit të shtetasës A.B.M., bazuar në nenet 290/1/ç dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale.

29. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit F.D., ardhur për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka regjistruar materialin kallëzues nr. ***. Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se kallëzuesi ka pretenduar që konfiskimi i sipërfaqes së tokës prej 9300 m², me vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër, kishte ardhur si rezultat i dëshmimeve të rreme dhe zhdukjes së dokumenteve nga prokurori i çështjes Ermir Lelçi. Kallëzuesi ka pretenduar se pronësinë e

¹⁴⁸Shkresë nr. *** prot., datë 15.9.2021.

tokës e kishte me dokumentacion të rregullt dhe se nuk kishte mundur të ankimonte vendimin për shkak të fatkeqësisë familjare që i kishte ndodhur.

30. Prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka administruar aktet e fashikullit penal nr. ***, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, regjistruar për veprat penale “falsifikim i dokumenteve” dhe “pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga nenet 186 e 287 të Kodit Penal. Nga shqyrtimi i tyre rezultoi se në përfundim të hetimeve, prokurori Ermil Lelçi ka kërkuar në gjykatë pushimin e procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, pasi personi kishte ndërruar jetë, pushimin e procedimit për veprën penale të parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, pasi ishte parashkruar ndjekja penale, si dhe konfiskimin për 3 pasuri të paluajtshme, objekt hetimi, në emër të shtetasit F.D.

31. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin e datës 29.7.2019, ka pranuar kërkesën e prokurorit për pushimin e procedimit penal për dy veprat penale të parashikuara nga nenet 287 dhe 186 të Kodit Penal, si dhe ka rrëzuar kërkesën për konfiskimin e pasurive. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 16.10.2019, ka vendosur të pranojë plotësisht kërkesën e prokurorit, duke përfshirë edhe konfiskimin e pasurive të paluajtshme.

32. Prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, pasi ka shqyrtuar aktet, ka konkluduar se nuk ndodhej para kryerjes së ndonjë vepre penale. Hetimet e kryera nga prokurori ishin shqyrtuar dhe ishin konsideruar të ligjshme nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendim të formës së prerë. Në datën 27.12.2019 është vendosur mosfillimi i procedimit penal mbi bazën e kallëzimit të shtetasit F.D., bazuar në nenet 290/1/ç dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale.

33. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit E.M., ka regjistruar materialin kallëzues nr. ***. Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se kallëzuesi ka pretenduar se pasuritë e tij ishin përvetësuar nëpërmjet përdorimit të dokumenteve të falsifikuara. Pretendimet e tij i kishte paraqitur edhe më parë në kallëzimin penal të depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, por prokurori Ermir Lelçi kishte vendosur mosfillimin pa kryer hetimet e nevojshme në institucionet shtetërore.

34. Prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka administruar aktet e fashikullit penal të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të regjistruar për veprat penale “falsifikim i dokumenteve” dhe “shpërdorim detyre”, të parashikuara nga nenet 186 e 248 të Kodit Penal, të regjistruar pas administrimit të rrethanave të reja pas mosfillimit dhe ka arritur në përfundimin se nuk ndodhej para kryerjes së veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Prokurori ka arsyetuar se veprimet e kryera nga prokurori i çështjes janë në ushtrim të kompetencave që i jep Kushtetuta dhe në çmuarjen e ligjit nga ana e tij. Moskryerja e hetimeve të pretenduara nga kallëzuesi nuk përmban elemente të figurës së veprës penale, të parashikuara nga neni 248 i Kodit Penal. Kallëzuesi ka të drejtë të plotë ligjore të parashtrojë të gjitha pretendimet e tij në seancë paraprake, duke shteruar mekanizmat procedurale brenda procesit të rregullt ligjor. Në datën 6.8.2020 është vendosur mosfillimi i procedimit penal mbi bazën e kallëzimit të shtetasit E.M., bazuar në nenet 290/1/ç dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale.

Hetimi i kryer nga Komisioni

35. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga KLP-ja, me shkresën nr. ***, datë 3.8.2021, u konstatua se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me shkresën nr. *** prot., datë 19.2.2021, ka vënë në dispozicion të KLP-së aktet e kallëzimit penal nr. ***,

viti 2016, kallëzimit penal nr. ***, viti 2017, kallëzimit penal nr. ***, viti 2019, si dhe kallëzimit penal nr. ***, viti 2020. Nga shqyrtimi i dosjeve penale rezultoi, si më poshtë vijon:

36. Lidhur me kallëzimin penal nr. ***, të shtetasës Z.M., e cila ka kallëzuar penalisht prokurorin Ermir Lelçi për kryerje të veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për shkak se subjekti ka vendosur të mos fillojë procedimin penal nr. ***, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nga shqyrtimi dosjes penale nr. ***, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime për konstatimin se: *Subjekti nuk ka kryer veprimet e duhura hetimore me qëllim analizimin dhe vlerësimin e pretendimeve të kallëzueses, lidhur me veprën penale “falsifikim i dokumenteve” në formën e përdorimit.*

37. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁴⁹, subjekti ka shpjeguar se në favor të shtetasit I.M. është lëshuar një leje ndërtimi në vitin 1991 dhe trualli mbi të cilën do të bëhej ky ndërtim ka qenë në pronësi të shtetit. Nga përmbajtja e kësaj lejeje përcaktohet qartë se periudha e fillimit të punimeve do të jetë data 20.7.1991 dhe data e përfundimit 30.12.1991. Në këto kushte, është logjike që një organ shtetëror nuk mund të lëshojë një leje të tillë pa e verifikuar paraprakisht dhe konfirmuar se vendi ku do të bëhej ky ndërtim është blerë nga shtetasi që kishte bërë kërkesë për ndërtimin e një objekti. Më pas ka shpjeguar se, meqenëse ka një proces gjyqësor lidhur me këtë sipërfaqe trualli, do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër që do të analizojë dhe vendosë nëse duhej apo jo privatizuar sipërfaqja e tokës për të cilën është lëshuar leja e ndërtimit dhe a duhej apo jo KKK Pronave të vendoste lidhur me kthimin e sipërfaqes së truallit mbi të cilin është dhënë leja e ndërtimit. Më pas, subjekti ka shpjeguar se në vlerësimin e tij gjykata ka gabuar dhe nuk mund të urdhëronte të kryhen hetime për një mosmarrëveshje juridike-civile që po shqyrtohej në gjykatë, pasi edhe sikur sipërfaqja e tokës 39 m² të jetë shitur në kundërshtim me ligjin, përsëri nuk mund të pretendohet se duhen kryer hetime, pasi është parashkruar ndjekja penale dhe nga viti 1991 kanë kaluar shumë vite.

Analiza e Komisionit

38. Komisioni konstaton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka administruar kopjen e fashikullit të dosjes penale nr. *** të vitit 2016. Gjithashtu, nga verifikimi i faqes elektronike gjykata.gov.al konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 6.9.2016, ka vendosur: *“Pranimin e ankimit. Shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër ‘Për mosfillimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2016’, të datës 24.5.2016, si të pabazuar në ligj dhe prova. Detyrimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për vazhdimin e hetimeve”*. Kjo çështje është në proces gjykimi në Gjykatën e Apelit Shkodër.

39. Nga analizimi i akteve të procedimit penal nr. *** të vitit 2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton se kallëzuesja Z.M. ka ngritur pretendimin se shtetasi I.M. ka kryer veprime të kundërligjshme, duke paraqitur një dokument që nuk pasqyron faktin e kryerjes së një shitblerjeje trualli, por që përbën në vetvete veprim të kundërligjshëm të falsifikimit dhe mashtrimit me dokumentacionin. Në arsyetimin e vendimit të datës 24.5.2016, për mosfillimin e procedimit penal nr. *** vitit 2016, subjekti i rivlerësimit i referohet nenit 66 të Kodit Penal, që parashikon institutin e “Parashkrimit të ndjekjes penale” dhe arsyeton se të gjitha shkeljet ligjore të zyrtarëve gjatë ushtrimit të detyrës, apo të shtetasve që përbëjnë vepra penale, i nënshtrohen këtyre rregullave dhe për shkak se ka një proces gjyqësor lidhur me këtë sipërfaqe trualli do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër që do të analizojë nëse duhej ose jo të privatizohet sipërfaqja e tokës për të cilën është lëshuar leja e ndërtimit dhe a duhej Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të kthente një sipërfaqe trualli mbi të cilin ishte bërë një objekt, shtëpi banimi, në bazë të një lejeje ndërtimi.

¹⁴⁹Shpjegime të subjektit të rivlerësimit, datë 22.10.2021.

40. Komisioni vlerëson se sipas nenit 186 të Kodit Penal¹⁵⁰ vepra penale “falsifikim i dokumenteve”, nga ana objektive kryhet nëpërmjet falsifikimit të dokumentit ose nëpërmjet përdorimit të dokumenteve të falsifikuara nga vetë personi që e ka kryer falsifikimin apo nga një person tjetër që ka interes për përdorimin e tij. Në rastin e përdorimit, nga ana subjektive kërkohet që autori i veprës penale të ketë dijëni për falsitetin e dokumentit dhe me dashje e përdor për qëllime të ndryshme. Në vendimin e datës 24.5.2016, për mosfillimin e procedimit penal, subjekti i rivlerësimit i referohet institutit të “Parashkrimit të ndjekjes penale” (nenit 66 i Kodit Penal) dhe arsyeton se të gjitha shkeljet ligjore të zyrtarëve gjatë ushtrimit të detyrës apo të shtetasve që përbëjnë vepra penale i nënshtrohen këtyre rregullave, por në vendim nuk shprehet dhe në dosjen penale nuk pasqyrohen veprimet hetimore që provojnë faktin nëse i akuzuari e ka përdorur ose jo dokumentin, dhe nëse e ka përdorur kur është momenti i fundit i përdorimit dhe më pas të vijonte me arsyetimin nëse janë plotësuar ose jo afatet e parashkrimit të ndjekjes penale. Vetëm pas hetimit të këtyre rrethanave mund të konkludohet se veprimet hetimore lidhur me këtë vepër penale janë plotësisht të ezauruara.

41. Lidhur me arsyetimin e subjektit se ka një proces gjyqësor lidhur me këtë sipërfaqe trualli, do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër që do të analizojë dhe vendosë nëse duhej apo jo privatizuar sipërfaqja e tokës për të cilën është lëshuar leja e ndërtimit dhe a duhej apo jo KKK Pronave të vendoste lidhur me kthimin e sipërfaqes së truallit mbi të cilin është dhënë leja e ndërtimit, konfirmon se subjekti nuk arrin të bëjë dallimin e përgjegjësisë civile nga ajo penale. Falsifikimi i një dokumenti, nga njëra anë, përbën vepër penale dhe mund të përbëjë objekt të një gjykimi penal, por mund të jetë objekti i shqyrtimit dhe në një proces civil, me qëllim neutralizimit të efekteve të dokumentit të falsifikuar lidhur me prejardhjen, origjinën formale të tij, por edhe për përmbajtjen e deklaratave apo fakteve juridike që ai përfaqëson. Procedimi penal ka për qëllim të individualizojë përgjegjësinë penale të personit të dyshuar, ndërkohë që gjykimi civil e vë theksin tek përgjegjësia e tij civile ose administrative. Pavarësisht se të dy gjykimet kanë për objekt sqarimin e çështjes nëse një dokument është apo jo i falsifikuar, qëllimi që ndjekin ato janë të ndryshme. Gjykimi civil ka karakter objektiv, në kuptimin që qëllimi i tij është të godasë pavërtetësinë e pjesëshme apo tërësore të dokumentit, me qëllim nxjerrjen e tij jashtë qarkullimit civil, ndërsa procesi penal i falsifikimit të dokumentit ka karakter subjektiv. Ky proces, qëllim primar ka identifikimin e autorit me qëllim të vënies së tij para përgjegjësisë penale¹⁵¹.

42. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi profesionale, për sa i përket aspektit të njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësisë për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe për të interpretuar ligjin, kritere të parashikuara nga pika 2¹⁵² e nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

43. Lidhur me kallëzimin penal nr. *** – ky kallëzim penal është trajtuar nga Komisioni në paragrafin 1 të denoncimeve nga publiku.

¹⁵⁰Kodi Penal, neni 186: “Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet”.

¹⁵¹Vendimi nr. ***, datë 15.3.2018, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

¹⁵²Ligji nr. 96/2016, neni 73: “Aftësitë profesionale të prokurorit”, parashikon se: “1. Vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorit përfshin njohuritë ligjore dhe të arsye-timit ligjor. 2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën [...]”.

44. Lidhur me kallëzimin penal nr. *** – ky kallëzim penal është trajtuar nga Komisioni në paragrafin 8 të denoncimeve nga publiku.

45. Lidhur me kallëzimin penal nr. *** – ky kallëzim penal është trajtuar nga Komisioni në paragrafin 4 të denoncimeve nga publiku.

Konstatime të tjera

46. Komisioni, në kuadër të hetimit lidhur me konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit, kërkoi nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër¹⁵³ informacion lidhur me procedimet penale ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. (“****” sh.p.k.), si dhe shtetasve A.Ç. dhe B.Ç. Në përgjigje¹⁵⁴ të saj, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka informuar se personat/subjektet e mësipërme janë përmendur në procedimin penal nr. *** të vitit 2014, i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal, i dërguar për rigjykim në datën 30.12.2015, dhe bashkëlidhur vuri në dispozicion të Komisionit kopje të këtij procedimi.

47. Nga shqyrtimi procedimit penal nr. *** të vitit 2014, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti për konstatimin se: *“Subjekti ka pushuar veprën penale të ndërtimit të paligjshëm për shoqërinë ‘***’ sh.p.k. (me administrator B.Ç., bashkëshortja e A. Ç.), në kundërshtim me nenin 71 të Kodit Penal dhe ligjin nr. 22/2014, ‘Për dhënie amnistie’, të ndryshuar”.*

48. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁵⁵, subjekti ka shpjeguar se nuk është në kushtet e papajtueshmërisë, pasi në asnjërin prej tri procedimeve penale që janë regjistruar nuk rezulton që të ketë pasur emër personi që i atribuohet vepra penale për shtetasit A. dhe B.Ç. Rezulton qartë se hetimet janë zhvilluar kundër personave të tjerë, të cilët po kryenin punime bazuar në një kontratë sipërmarrjeje të investitorit me subjektin, shoqëria “****” sh.p.k., e përfaqësuar nga shtetasi N.Ç. dhe pikërisht bazuar në dokumentacionin e fashikullit është vlerësuar se duhej të merren si të pandehur shtetasit N.Ç. dhe F.A., për veprën penale të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal.

Me pas, subjekti vijon me shpjegimin se nuk duhej të ishte ai që duhej të ndiqte procedimin penal por prokurori që e ka regjistruar i pari, dhe për këtë parashtron komunikimet që ka pasur me Drejtuesin e Prokurorisë.

Analiza e Komisionit

49. Komisionin vlerëson se subjekti nuk ka dhënë shpjegime për konstatimin e se ka pushuar çështjen penale në ngarkim të shoqërisë “****” sh.p.k., për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, në kundërshtim me nenin 71 të Kodit Penal dhe ligjit nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”, të ndryshuar, por i referohet rrethanave të analizuara nga Komisioni në pikën 11 “Rivlerësimi i pasurisë”.

50. Nga analizimi i akteve të dosjes penale nr. *** të vitit 2014, rezulton se në datën 20.10.2014 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, sipas nenit 199/a të Kodit Penal, në ngarkim të subjektit “****” sh.p.k. Në datën 13.1.2015, në objektin që po ndërtonte shoqëria “****” sh.p.k. ka ndodhur një aksident në punë ku ka humbur jetën shtetasi D.K. Lidhur me këtë ngjarje, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal. Gjithashtu, në datën 5.6.2015, po në të njëjtin objekt, ka ndodhur një aksident tjetër në punë me pasoje vdekjen, nga i cili ka humbur jetën shtetasi M.K. dhe për këtë ngjarje

¹⁵³Shkresë nr. *** prot., datë 9.6.2021.

¹⁵⁴Shkresë nr. *** prot., datë 13.7.2021.

¹⁵⁵Shpjegime të subjektit të rivlerësimit, datë 22.10.2021.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprat penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, “punësim i paligjshëm” dhe “ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga nenet 289/1, 170/a, 199/a të Kodit Penal.

51. Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur bashkimin e procedimeve penale nr. *** dhe nr. *** në një procedim të vetëm nr. *** të vitit 2014, duke vendosur që hetimi të vazhdojë nga prokurori Ermir Lelçi. Në përfundim të hetimeve, subjekti me vendimin e datës 30.12.2015, vendosi dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. *** të vitit 2014, kundër të pandehurve N.Ç. dhe F.A., të akuzuar për veprën penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal.

52. Në kërkesën për gjykim, subjekti ka bërë arsyetimin si vijon: (i) lidhur me procedimin penal nr. ***, të regjistruar në datën 20.10.2014, për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, ndaj subjektit “****” sh.p.k., arsyeton se, bazuar në ligjin 22/2014, “Për dhënie amnistie”, kjo çështje penale duhet pushuar pasi vepra penale “ndërtim i paligjshëm”, i parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, është amnistuar; (ii) lidhur me procedimin penal nr. ***, subjekti arsyeton se shkak i aksidentit, me pasojë vdekjen e shtetasit D.K., nuk ka ndodhur gjatë kohës kur po punohej në këtë objekt, por në periudhën kur ishin pezulluar punimet dhe ai kishte vajtur në objekt për të marrë disa vegla pune të cilat i kishte lënë rreth 1 muaj më parë; (iii) lidhur me procedimin penal nr. ***, subjekti arsyeton se të pandehurit N.Ç. dhe F.A. kanë konsumuar veprën penale “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal.

53. Komisioni konstaton se INUV Velipojë, me vendimin nr. ***, datë 1.2.2013, ka vendosur pezullimin e punimeve të subjektit “****” sh.p.k. Më pas, Komisariati i Policisë Shkodër, me shkresat nr. *** prot., datë 17.11.2014 dhe nr. *** prot., datë 16.1.2015, i ka dërguar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër informacionin për referimin e veprës penale të datës 14.11.2014, me shkresën për ndërtim pa leje në vendin e quajtur Plazhi Velipojë, me tabelë punimesh “****” sh.p.k. Gjithashtu, subjekti, në kërkesën për gjykim të datës 30.12.2015, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, arsyeton se gjatë hetimeve lidhur me procedimin penal nr. ***, të regjistruar për shkak të vdekjes së shtetasit D.K., në datën 13.1.2015, përfaqësuesi i shoqërisë “****” sh.p.k. ka deklaruar se punimet kishin 2 muaj që ishin pezulluar (në datën 13.11.2014), ndërsa në arsyetimin lidhur me procedimin penal nr. ***, të regjistruar për shkak të vdekjes së shtetasit M.K., arsyeton se, pavarësisht pretendimeve të shtetasve N.Ç. dhe F.A. (drejtuesi teknik) se shtetasi M.K. nuk ka qenë duke punuar në datën 5.6.2015 te kompleksi “****” sh.p.k., është provuar se ky shtetas ka qenë duke punuar në këtë kompleks në datën 5.6.2015.

54. Nga analizimi i akteve të mësipërme, është vërtetuar se punimet për ndërtimin e objektit me investitor shoqëria “****” sh.p.k. kanë vazhduar edhe pas marrjes së vendimit INUV Velipojë në datën 1.2.2013, për pezullimin e punimeve. Ky fakt është vërtetuar nga shkresat e datës 17.11.2014 dhe 16.1.2015, të Komisarariatit të Policisë Shkodër si dhe nga konkluzioni i subjektit në arsyetimin e kërkesës për gjykim drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, lidhur me procedimin penal ***, të regjistruar për shkak të vdekjes së shtetasit M.K., ku arsyeton se është provuar që ky shtetas ka qenë duke punuar te ky kompleks në datën 5.6.2015.

55. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. ***, datë 6.10.2000, arsyetojnë: “[...] se për të pasur krim vazhdues duhet të jenë të pranishëm elementë të tillë si: secila veprë nuk duhet të qëndrojë si akt më vete, veprimet ose mosveprimet e të pandehurit të konsumojnë të njëjtën figurë të veprës penale, të ekzistojë një mendim kriminal, i cili të bashkojë aktet e veçanta në një tërësi të vetme të pandashme [...]”. Referuar teorisë së të drejtës penale, vepra penale vazhduese karakterizohen nga veprime të njëjlojta dhe nga një mendim

unik kriminal. Në këto kushte, në rastin konkret, vazhdimi i kryerjes së ndërtimit pa leje të organeve përkatëse plotëson elementet e një vepre penale me karakter vazhdues.

56. Neni 71 i Kodit Penal, përcakton se: *“Amnistia shtrihet për ato vepra penale të kryera deri një ditë para shpalljes së saj, veç rastit kur në aktin përkatës vendoset ndryshe”*. Në kuptim të kësaj dispozite, amnistia shtrihet për ato vepra penale të kryera përpara shpalljes së saj dhe nuk zbatohet për veprat penale vazhduese në rast se akti i fundit i saj kryhet pas daljes së aktit të amnistisë. Gjithashtu, neni 5 i ligjit 22/2014, “Për dhënie amnistie”, i ndryshuar me ligjin nr. 92/2015, datë 23.7.2015, parashikon se: *“Amnistohen nga ndjekja penale të gjithë personat të cilët akuzohen se kanë kryer veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në rastet kur vepra penale në fjalë është kryer jo më vonë se data 10 prill 2014”*.

57. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se kërkesa për pushimin e çështjes penale nr. ***, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, është në kundërshtim me nenin 71 të Kodit Penal dhe ligjin nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”, të ndryshuar.

58. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi profesionale në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësisë për të interpretuar ligjin, kriter që parashikohet nga pika 2¹⁵⁶ e nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

Në Komisionin e pavarur të Kualifikimit, për subjekti Ermir Lelçi janë administruar 10 denoncime nga publiku. Referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kërkoi shpjegime për të gjitha denoncimet.

1. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 22.11.2017, të shtetases A.B.(M.),** e cila denoncon tre prokurorët e Shkodrës, Ermir Lelçi, M.F. dhe Xh.L. për mbyllje të hetimeve, pa e thirrur asnjëherë dhe pa deponuar asnjëherë si person i dëmtuar. Komisioni kërkoi nga subjektit shpjegime për konstatimin se: *“Subjekti nuk ka analizuar veprimet e të akuzuarit nëse përbëjnë ose jo veprime të vetëgjyqësisë, në kuptim të nenit 277 të Kodit Penal”*.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ka një proces gjyqësor civil për pjesëtimin e kësaj prone të dhënë me qira, fakt i cili përbën mosmarrëveshje juridiko-civile dhe në këto kushte është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Gjithashtu, shpjegimet e tij i mbështet në vendimin nr. ***, datë 30.11.2017, të Gjykatës së Apelit Shkodër, që ka ndryshuar vendimin nr. ***, datë 21.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rrëzimin e ankimit të kërkuësës A.M. kundër vendimit të datës 30.7.2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, “Për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, viti 2016”.

Analiza e Komisionit

Nga analizimi i dokumentacioni të administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër¹⁵⁷, KLP-ja¹⁵⁸ dhe Prokuroria e Përgjithshme¹⁵⁹, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, bazuar në materialet kallëzuese të dërguar nga

¹⁵⁶Ligji nr. 96/2016, neni 73: *“Aftësitë profesionale të prokurorit”*, parashikon se: *“1. Vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorit përfshin njohuritë ligjore dhe të arsye-timit ligjor. 2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën [...]”*.

¹⁵⁷Shkresë nr. *** prot., datë 18.6.2021.

¹⁵⁸Shkresë nr. *** prot., datë 3.8.2021.

¹⁵⁹Shkresë nr. *** prot., datë 15.9.2021.

Komisariati i Policisë Shkodër, ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, datë 28.6.2016, dhe kallëzimin penal nr. ***, datë 30.6.2016, të shtetases A.M., e cila ka bërë kallëzim penal kundër shtetasit D.M. Ajo ka deklaruar se në datën 25.6.2016, rreth orës 20:00, është njoftuar me telefon nga shtetasja B.Sh., e cila kishte kontratë të rregullt qiraje me denoncuesen për dyqanin që kishte në përdorim, se shtetasi D.M. i kishte telefonuar shtetasen B.Sh. dhe i kishte kërkuar që deri në orën 09.00 të ditës së nesërme duhej të nxirrte mallrat e ndryshme që kishte aty dhe po atë natë kishte ndërruar bravat dhe drynat e dyqanit dhe kishte vendosur polici private për të mos lejuar shitësen të futej në dyqan. Kallëzuesja ka sqaruar gjithashtu se shtetasi D.M. është kushëri i bashkëshortit të saj (djali i djalit të xhaxhait) dhe se dyqani i dhënë me qira shtetasen B.Sh. është objekt i shqyrtimit gjyqësor prej rreth një viti në një proces gjyqësor që po zhvillohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku shtetasi D.M. kërkon pjesëtimin e kësaj pasurie.

Në vendimet e datave 28.7.2017 dhe 30.7.2016, subjekti ka arritur në përfundimin se ka një proces gjyqësor civil për pjesëtimin e kësaj prone të dhënë me qira dhe ky fakt përbën mosmarrëveshje juridiko-civile, e cila do të zgjidhej nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Pikërisht kjo gjykatë do të vendoste nëse ky dyqan do t'i nënshtrohej pjesëtimit (ndarjes së pasurisë) dhe nëse po, në sa pjesë do të ndahej dhe kush do të jenë përfituesit e saj, dhe si pasojë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Komisioni vlerëson se në kuptim të nenit 277 të Kodit Penal¹⁶⁰ do të jemi përpara rastit të kundërvajtjes penale të “vetëgjyqësisë”, kur autori i veprës vepron duke shkelur dhe “zëvendësuar” veprimin e organit kompetent që ka juridiksionin, kompetencën dhe detyrën që të zgjidhë konfliktin mes palëve sipas ligjit, me objektivitet dhe paanshmëri. Pavarësisht se nuk përmendet shprehimisht në dispozitë nga pikëpamja e anës objektive, vetëgjyqësia kryhet nga autori nëpërmjet ushtrimit arbitrar të së drejtës, me forma të ndryshme të dhunës fizike a psikike (kanosjes, etj.), drejtpërdrejt mbi personin ose indirekt, duke vepruar mbi sendin a interesin mbi të cilin ekziston apo pretendohet se ekziston e drejta (e ligjshme) e autorit të veprës¹⁶¹.

Komisioni konstaton se subjekti, në rastin konkret, në vendimet e tij është mjaftuar me faktin se kallëzuesja dhe i kallëzuari janë pjesë e një procesi civil për pjesëtimin e pasurisë dhe nuk ka analizuar, në kuptim të nenit 277 të Kodit Penal, faktin nëse veprimet e të akuzuarit për njoftimin që i ka bërë qiramarrëses për të nxjerrë mallin dhe ndërrimi i drynave të dyqanit përbëjnë ose jo veprime të vetëgjyqësisë, në kushtet kur shtetasja B.Sh. kishte të lidhur paraprakisht një kontratë qiraje dhe i akuzuari nuk ishte në zotërim të sendit. Nga analizimin i vendimeve të subjektit dhe nga shpjegimet e dhëna në përgjigje të rezultateve të hetimit, Komisioni vëren se subjekti nuk arrin të dallojë përgjegjësinë civile nga ajo penale. Procedimi penal ka karakter subjektiv, pasi ka si qëllim të individualizojë përgjegjësinë penale të personit të dyshuar, ndërkohë që gjykimi civil ka karakter objektiv, pasi ka si qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes civile, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e secilës palë.

Lidhur me pretendimin e subjektit se Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka konstatuar elemente të veprës penale, Komisioni, nga shqyrtimi i vendimit nr. ***, datë 30.11.2017, të Gjykatës së Apelit Shkodër, konstaton se kjo gjykatë nuk ka analizuar veprimet e shtetasit D.M. nëse përbejnë ose jo veprime të vetëgjyqësisë, por ka arritur në përfundimin se për shkak të daljes së ligjit për amnistinë, edhe sikur veprimet e tij të përmbanin elemente të veprës penale të

¹⁶⁰Kodi Penal, neni 277, parashikon se: “Ushtrimi i një të drejte prej personit që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk njihet nga tjetri pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj”.

¹⁶¹Vendim nr. 1, datë 25.3.2005, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

vetëgjyqësisë, ato janë amnistuar. Si pasojë, shpjegimi i subjektit nuk ka lidhje me arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e interpretimit të ligjit dhe në aspektin e arsyetimit të vendimit, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës dhe të argumentimit logjik, të parashikuar nga pikat 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar¹⁶².

2. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 25.6.2018, të shtetases T.Ç.,** e cila akuzon disa subjekte rivlerësimi, ndërmjet tyre edhe subjektin Ermir Lelçi, për proces të parregullt ligjor dhe shkelje të etikës profesionale. Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime lidhur me këtë denoncim.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se vendimi i prokurorit ka qenë i drejtë, pasi nuk rezulton të jetë shfuqizuar.

Analiza e Komisionit

Komisioni, pasi shqyrtoi vendimin e prokurorisë të datës 11.12.2013, “Për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. ***”, konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në arsyetimin e vendimit të tij, i ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kallëzueses.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional.

3. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 22.10.2018, të shtetasit F.A.,** i cili denoncon disa subjekte të rivlerësimit dhe subjektin Ermir Lelçi, për moskryerje të hetimeve dhe që tjetërsojnë faktet dhe provat si dhe shkelin ligjet. Komisioni i kërkoi nga subjekti shpjegime lidhur me këtë denoncim.

Subjekti ka shpjeguar se vendimi i mosfillimi ka qenë i drejtë, pasi vepra penale “dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, ndiqet me ankimin e të dëmtuarit në gjykatë dhe jo në prokurori.

Analiza e Komisionit

Komisioni analizoi vendimin e datës 27.9.2016, “Për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. *** të vitit 2016” dhe konstatoi se ky vendim është marrë me arsyetimin se fakti mbi bazën e të cilit shtetasi F.A. ka bërë kallëzimin përmban elementet e veprës penale “dëmtime të tjera me dashje”, të parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, e cila bën pjesë në grupin e veprave penale, për të cilat neni 59 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se personi që është dëmtuar nga kjo vepër penale ka të drejtë t’i drejtohet vetë gjykatës me kërkesë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se subjekti ka vepruar në përputhje me nenet 59, 284, pika 5 dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale.

¹⁶²Ligji nr. 96/2016, neni 73, parashikon se: “1. Vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorit përfshin njohuritë ligjore dhe të arsyetimit ligjor. 2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën. 3. Aspekti i arsyetimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit”.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional.

4. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 10.12.2019, të shtetasit E.M.**, i cili ankohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar akuzën që ka paraqitur kundër personave konkretë për devijim të hetimit dhe për shmangien e hetimeve ndaj punonjësve të institucioneve shtetërore. Komisioni kërkoi nga subjekti shpjegime për konstatimin se: (i) subjekti nuk ka analizuar veprimet e kryera nga punonjësit shtetërorë, përgjegjësish individuale të tyre, kohën e kryerjes dhe faktin nëse përmbajnë elemente ose jo të veprës penale “shpërdorim detyre”; (ii) subjekti nuk ka hetuar kërkesën e kallëzuesit për ndjekjen penale të të kallëzuarve për veprën penale “falsifikim i dokumenteve” në formën e përdorimit.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se lidhur me veprën penale “përdorim i dokumenteve të falsifikuara”, rezulton se dokumentacioni i këtyre akteve është dorëzuar pranë ZVRPP-së Shkodër në datën 12.12.2005, konkretisht njëra nga këto praktika lidhet me AMTP-në nr. ***, që i përket shtetasit B.M., dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 12.12.2005, të Këshillit të Qarkut Shkodër, si dhe praktika tjetër që lidhet me AMTP-në nr. ***. dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 15.12.2005, të Këshillit të Qarkut Shkodër dhe, në këto kushte, edhe sikur përmbajtja e këtyre dokumenteve të ishte e falsifikuar, ajo që paraqet rëndësi është ana subjektive e subjektit të kësaj vepre penale, që do të thotë se shtetasit F. dhe B.M. janë pajisur me AMTP nga shtetasi S.M., që mbante vulën e kryetarit të fshatit Z., të cilat kanë pasur edhe vulën e komunës Rr., si dhe firmën e përfaqësuesit të kadastrës dhe dokumenti nga ana formale nuk ka pasur mangësi dhe nuk kishte arsye të mendohej nga këta shtetas se ishte dokument me përmbajtje të falsifikuar. Nga ana tjetër, edhe sikur ky dokument të ishte falsifikuar dhe lidhur me përmbajtjen e falsifikimit të ishin në dijeni këta shtetas, ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale, pra ka kaluar afati pesëvjeçar që parashikohet nga germa “c”, e nenit 66, të Kodit Penal, pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim deri në pesë vjet. Vepra penale e parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal parashikon një masë dënimi me burgim deri në tre vjet.

Analiza e Komisionit

Nga analizimi i dokumentacionin të paraqitur nga denoncuesit¹⁶³, Komisioni konstaton se shtetasit E. e B.M., vëllezër me njëri-tjetrin, kanë paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër kallëzimin penal, duke kallëzuar shtetasit F. e B.M. për veprat penale “pushtim toke”, “ndërtim i paligjshëm” dhe “falsifikim i dokumenteve”. Kallëzuesit pretendojnë se shtetasit F. dhe B.M. kanë bërë ndërtime pa leje në tokën e tyre, duke ju bllokuar rrugën që shkon për në banesën e tyre në fshatin Z., Shkodër. Të kallëzuarit kanë pretenduar se ndërtimet i kanë kryer në tokën në pronësi të tyre dhe për këtë fakt i referohen AMTP-ve të lëshuara nga kryetari i Komisionit të Ndarjes së Tokës së fshatit Z., z. S.M., përkatësisht: nr. ***, pa datë dhe nr. ***, në datën 15.12.2005. Nga ana tjetër, edhe babai i shtetasve E. e B.M., z. N.M., është pajisur nga Komisioni i Ndarjes së Tokës së Tokës së fshatit Z., Shkodër, me AMTP-në nr. ***, pa datë, duke i dhënë në pronësi 3300 m² tokë, nga të cilat 300 m² truall.

Subjekti, pasi ka hetuar çështjen dhe faktet e kallëzuara, me kërkesën e datës 24.9.2018, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për pushimin e hetimeve për procedimin penal

¹⁶³Kopje të vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 23.1.2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; kopje të vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 23.1.2015; “Kërkesë për pushimin e çështjes”, datë 22.9.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; kopje të vendimit nr. ***, datë 19.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; kopje të vendimit nr. ***, datë 27.9.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

nr. ***, të regjistruar në datën 6.2.2018, ndërmjet të tjerave, ka arsyetuar se lidhur me veprën penale “falsifikim i dokumenteve” (në formën e përdorimit), parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, rezulton se dokumentacioni i këtyre akteve është dorëzuar pranë ZVRPP-së Shkodër në datën 12.12.2005. Shtetasit F. dhe B.M. janë pajisur me AMTP nga shtetasi S.M., që mbante vulën e kryetarit të fshatit Z. dhe këto AMTP kanë pasur edhe vulën e komunës Rr., si dhe firmën e përfaqësuesit të kadastrës dhe dokumenti, nga ana formale, nuk ka pasur mangësi dhe nuk kishte arsye të mendohej nga këta shtetas se ishte dokument me përmbajtje të falsifikuar. Dhe sikur ky dokument të ishte i falsifikuar dhe për përmbajtjen e falsifikimit të ishin në dijeni këta shtetas, ka kaluar afati i parashkimit të ndjekjes penale, pra ka kaluar afati pesëvjeçar që parashikohet nga germa “c”, e nenit 66, të Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 19.12.2018, ka vendosur: “1. Mospranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 6.2.2018, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprën penale ‘ndërtim i paligjshëm’, të parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal. 2. Kthimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2018, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër për vazhdimin e hetimeve për veprat penale ‘falsifikim i dokumenteve’, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal dhe ‘shpërdorim detyre’, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 27.9.2019.

Komisioni konstaton se Gjykata e Apelit Shkodër, në vendimin nr. ***, datë 27.9.2019, ndërmjet të tjerave, arsyeton se: “Së pari: lidhur me veprën penale ‘falsifikim i dokumenteve’, në formën e përdorimit, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal [...] me të drejtë gjykata e shkallës së parë i ka ngarkuar organit të prokurorisë si detyrë të hetojë faktin nëse shtetasit F. e B.M. i kanë përdorur këto dokumente të falsifikuara dhe se kur është momenti i fundit që këto dokumente të falsifikuara janë përdorur prej tyre. Gjithashtu, ajo çka është thelbësore për t’u përcaktuar dhe hetuar nga organi i akuzës, është nëse të kallëzuarve ju takonte tokë në bazë të ligjit nr. 7501 apo jo, nëse ishin trajtuar më parë, ku e kishin marrë etj. Vetëm përcaktimi i këtyre momenteve do të ishte deciziv jo vetëm në lidhje me anën subjektive, por edhe lidhur me parashkrimin e kësaj vepre penale, dhe jo llogaritja e afateve apriori nga momenti i hartimit të këtyre akteve [...]. Së dyti: lidhur me veprën penale ‘shpërdorim detyre’, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, organi i akuzës, megjithëse ka konstatuar një sërë parregullsish të punonjësve të institucioneve shtetërore me dëm dhe pasoja në interesat e ligjshme të kallëzuesve, nuk i ka identifikuar ato, nuk i ka analizuar në kuptim të përgjegjësisë individuale penale, nuk ka përcaktuar kohën e kryerjes së tyre, në mënyrë që të konkludonte drejt dhe në përputhje me ligjin [...]”.

Lidhur me kërkesën e kallëzuesve për ndjekjen penale të shtetasve F. dhe B.M. për veprën penale “falsifikimi i dokumenteve” në formën e përdorimit, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në arsyetimin e kërkesës për pushimin e çështjes, ka arsyetuar lidhur me kohën kur janë plotësuar dokumentet e falsifikuara dhe me personat që e kanë bërë falsifikimin, por nuk ka hetuar nëse të kallëzuarit kanë pasur dijeni për falsifikimin, si dhe për kohën se kur i kanë përdorur për herë të fundit dokumentet e falsifikuara. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, megjithëse ka konstatuar një sërë parregullsish të punonjësve të institucioneve shtetërore në dëm dhe me pasoja në interesat e ligjshme të kallëzuesve, nuk i ka analizuar në kuptim të përgjegjësisë individuale penale dhe nuk ka përcaktuar kohën e kryerjes së tyre, në mënyrë që të vlerësonte drejt dhe në përputhje me ligjin nëse në rastin konkret ishin konsumuar elementet e veprës penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë

logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore dhe për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, të parashikuar nga pika 2 e nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar¹⁶⁴.

5. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 18.7.2019, të shtetasit Xh.V.,** i cili denoncon subjektin e rivlerësimit Ermir Lelçi për kryerjen e veprimeve arbitrare, të kundërligjshme dhe në shpërdorim të detyrës dhe për mosnjofitim për hetimet që po kryheshin ndaj tij. Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime, për konstatimin se: (i) personi nën hetim nuk është njoftuar për veprën penale për të cilën hetohej dhe për kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes; dhe (ii) mungon vendimi për zgjatjen e hetimeve.

Subjekti ka shpjeguar se për sa kohë nuk ka pasur të regjistruar emër personi që i atribuohet vepra penale nuk mund të kishte vendim për zgjatjen e hetimeve dhe rrjedhimisht nuk mund të komunikohet kërkesa për pushim, pasi realisht nuk ka qenë person nën hetim në kuptimin procedural. Në rastin konkret ka pasur vetëm urdhër për regjistrimin e procedimit penal dhe jo urdhër për regjistrimin e emrit që i atribuohet vepra penale.

Analiza e Komisionit

Nga analizimi akteve të dosjes penale nr. ***, viti 2018, të administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër¹⁶⁵, rezulton se bazuar në materialin kallëzues të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar fillimisht kallëzimin penal me nr. *** datë 17.10.2018, dhe më pas procedimin penal me nr. ***, datë 17.10.2018, për veprën penale “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” dhe “sigurim i kushteve dhe mjeteve materiale për vrasje”, parashikuar nga nenet 278/1 dhe 80 të Kodit Penal, pa emër personi të cilit i atribuohet vepra penale.

Sipas informacionit për referimin e veprës penale të oficerit të policisë gjyqësore, shtetasi Xh.J.V. i kishte kërkuar shtetasit M.I. që të vrasë kundrejt shumë prej 50.000 euro shtetasin A.L., në shenjë hakmarrjeje, për shkak se ky i fundit, në datën 5.5.2018, në vendin e quajtur B., Njësia Administrative B., për motive të dobëta, e ka plagosur me armë zjarri pistoletë në këmbë. Nga hetimi nuk është arritur të merret asnjë e dhënë apo *indicie* që shtetasit në fjalë janë përfshirë në kryerjen e ndonjë veprë penale dhe me kërkesën e datës 19.3.2019 subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 17.10.2018, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 15.4.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Lidhur me pretendimin e denoncuesit për mosnjofitim për hetimet që po kryheshin ndaj tij, Komisioni vlerëson se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë¹⁶⁶ kanë trajtuar qartë konceptin e subjektit procedural të “të pandehurit”. Cilësimi dhe emërtimi i subjekteve dhe i personave në raport me veprën penale fillojnë me termin “personi, të cilit i atribuohet vepra penale”, “person ndaj të cilit zhvillohen hetime” dhe më pas “i pandehur”, që ndeshen në shumë dispozita të Kodit të Procedurës Penale. Përcaktimi i termit “person, të cilit i atribuohet vepra penale”, i marrë në kontekstin e përcaktuar nga neni 287 i Kodit të Procedurës Penale, si dhe duke pasur parasysh fazën procedurale në të cilën ai përdoret, do të thotë se nuk mund të

¹⁶⁴Ligji nr. 96/2016, neni 73, parashikon se: “1. Vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorit përfshin njohuritë ligjore dhe të arsytimit ligjor. 2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën [...]”.

¹⁶⁵Shkresë nr. *** prot., datë 18.6.2021.

¹⁶⁶ (1) Vendimi nr. ***, datë 27.9.2002; (2) Vendimi nr. ***, datë 20.6.2013.

barazohet me termin “person ndaj të cilit zhvillohen hetime”, e as me termin person “i pandehur”. Atribuimi i faktit që përbën veprën penale ndaj një personi nuk do të thotë se personi ka realisht lidhje me veprën penale. Lidhja e veprës penale me një emër personi mund të dalë vetëm me kryerjen e hetimeve dhe të dhënave të mbledhura, prej të cilave do të rezultojë një lidhje mes veprës penale që procedohet dhe përgjegjësisë së prezumuar të një personi të caktuar. Me avancimin e fazës së hetimeve paraprahe kuptohet se ndryshon edhe gjendja procedurale penale e subjektit të veprës penale, i cili, nga cilësia e personit që i atribuohet vepra penale, kalon në cilësinë e “personit ndaj të cilit zhvillohen hetime”, që nënkupton se gjatë hetimeve paraprahe, nga momenti fillestar i çeljes së procedimit penal kanë filluar të mblidhen të dhëna, të cilat janë në gjendje të mbështesin akuzën që do të mund të ngrihet në fazën e gjykimit.

Në rastin konkret, Komisioni konstaton se procedimi penal është regjistruar pa emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale dhe se gjatë hetimeve dhe të dhënave të mbledhura nuk ka rezultuar një lidhje mes veprës penale që procedohet dhe përgjegjësisë së prezumuar të një personi të caktuar. Në këto kushte, pozita e denoncuesit nga momenti i regjistrimit të procedimit penal deri në përfundimin e hetimeve nuk ka qenë në cilësinë e “personit ndaj të cilit zhvillohen hetime”, për të përfitua nga të drejtat e parashikuara nga neni 34/a i Kodit të Procedurës Penale.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional.

6. Në lidhje me denoncimet nr. * prot., datë 5.2.2020 dhe nr. *** prot., datë 3.3.2020, të shtetases N.K., e cila akuzon subjektin e rivlerësimit për mosmarrjen në konsideratë të kallëzimit penal të bërë prej saj pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe denoncimin nr. *** prot., datë 3.3.2020, të shtetasit M.K., i cili akuzon subjektin e rivlerësimit se nuk ka vullnetin e duhur për të zbardhur çështjen, Komisioni i trajtoi bashkë këto denoncime, pasi rezultoi se kallëzimet e këtyre shtetasve ishin bashkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në një procedim të vetëm. Komisioni kërkoi nga subjektin e rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: (i) subjekti nuk ka kryer veprimet e duhura hetimore me qëllim analizimin dhe vlerësimin e pretendimeve të kallëzuesve M. dhe P.K., në kuadër të hetimit dhe ndjekjes penale të kallëzuarit për veprën penale “falsifikim i dokumenteve” në formën e përdorimit; (ii) kërkesa “për pushimin e çështjes”, pa datë, e vitit 2019, nuk është e arsyetuar; (iii) nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit në vendimin nr. ***, datë 4.6.2018; dhe (iv) hetimet kanë zgjatur tej afatit të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër në vendimin nr. ***, datë 21.9.2020.**

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka dhënë shpjegimet si vijon:

Lidhur me vendimin e datës 15.3.2018, subjekti shpjegon se gjatë studimit të akteve të procedimit penal nuk ka pasur të dhëna që ndonjë dokument të kishte përmbajtje të falsifikuar dhe në mungesë të këtyre të dhënave është konkluduar se duhet të vendoset mosfillimi i procedimit penal për rastin konkret.

*Lidhur me kërkesën “për pushimin e çështjes”, pa datë (12.6.2019 sipas shkresës nr. *** prot., datë 14.6.2019, të prokurorisë)*, subjekti shpjegon se kërkesa për pushim është kthyer për shkak të mosparaqitjes në seancën gjyqësore për të sqaruar gjykatën në mënyrë më të detajuar pretendimet e shtetases N.K. tek kërkesa për pushim, pavarësisht faktit se gjykata nuk kishte pengesë të verifikonte nëse kjo shtetase ishte pyetur apo jo dhe cilat ishin pretendimet e saj, por ka zgjedhur rrugën më të shkurtër, duke e kthyer çështjen për hetim.

*Lidhur me kërkesën e vitit 2020 për pushimin e procedimit penal (datë 15.5.2020, sipas shkresës së prokurorisë nr. *** prot., datë 18.5.2020), sqaron se janë kryer detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Shkodër në vendimin nr. ***, datë 4.6.2018, konkretisht: është kryer ekspertimi grafik i vendimit nr. ***, datë 5.11.1996, të KKK Pronave pranë Bashkisë Shkodër dhe i dokumentit “notë transkriptimi nr. ***, datë 4.9.1945”.*

*Lidhur me konstatimin e Komisionit se hetimet kanë zgjatur tej afatit të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër në vendimin nr. ***, datë 21.9.2020, subjekti shpjegon se procedimi penal është regjistruar pa emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale dhe se nuk ka pasur detyrimin për të nxjerrë vendimin për zgjatjen e hetimeve. Në vijim sqaron se afati i caktuar nga gjyqtari i seancës paraprake nuk është afat hetimor që i nënshtrohet parashikimeve të institutit të afatit të hetimeve paraprake të rregulluara nga nenet 323 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.*

Analiza e Komisionit

Nga analizimi i dosjes penale të administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër¹⁶⁷ rezulton se në bazë të kallëzimit penal të bërë nga shtetasit M. dhe P.K. kundër shtetasi D.H., Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 2.3.2018, për kryerjen e veprës penale “falsifikim i dokumenteve” dhe “përdorim i dokumenteve të falsifikuara”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe mbi bazën e kallëzimit të shtetases N.K. ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 24.10.2018, për kryerjen e veprës penale “falsifikim i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Me vendimin e datës 24.10.2018, Prokuroria e Rrethit Shkodër ka vendosur bashkimin e procedimit penal nr. ***, datë 7.6.2018, dhe nr. ***, datë 24.10.2018, në një procedim të vetëm me nr. ***, i cili i është caktuar prokurorit Ermir Lelçi.

Kallëzuesit M. dhe P.K. kanë pretenduar se në procesin gjyqësor të zhvilluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me palë paditës D.H., të paditur kundërpaditës M. dhe P.K. janë paraqitur prova shkresore për të cilat kanë dyshimin se janë të falsifikuara nga vetë paditësi D.H. Ndërsa shtetasja N.K. ka kallëzuar faktin se në vitin 2004, për shkak të largimit si emigrante në Itali, i ka lënë pronën e saj shtëpi dhe tokë në ruajtje shtetasit N.Q. deri në vitin 2014. Më pas këto prona ia ka lënë në ruajtje shtetasit G.K., i cili, sipas kallëzueses, pa pëlqimin e saj ka lidhur një kontratë ku pronën ia shiste shtetasit D.H. Gjithashtu ka pretenduar se pronën ia kanë vjedhur me vendimin e gjykatës nr. ***, datë 11.12.2001, pa pasur dijeni as ajo, as të afërmit e saj.

Subjekti i rivlerësimit, në vendimin e datës 15.3.2018, ka vendosur mosfillimin e çështjes penale, me argumentin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, me arsyetimin se provat shkresore që pretendohen të jenë të falsifikuara janë shqyrtuar një herë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 11.12.2001, që i ka vlerësuar të sakta dhe jo me përmbajtje të falsifikuar, vendim i cili ka marrë formë të prerë. Kundër vendimit të prokurorisë kanë bërë ankim kallëzuesit M. e P.K. dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 25.4.2018, ka rrëzuar ankesën, duke e konsideruar vendimin e prokurorisë për mosfillimin e çështjes penale si të drejtë dhe të bazuar në prova dhe në ligj. Ndërsa Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 4.6.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pranimin e ankimit të paditësve M. K. dhe P.K., prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe ka urdhëruar prokurorinë të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme në lidhje me këtë kallëzim, që sipas detyrave lihen në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

¹⁶⁷Shkresë nr. *** prot., datë 18.6.2021.

Pas kryerjes së veprimeve hetimore të lëna si detyrë nga gjykata, subjekti i rivlerësimit, me kërkesën “për pushimin e çështjes”, pa datë, të vitit 2019, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 7.6.2018, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 25.7.2019, ka vendosur mospranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Shkodër. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 17.10.2019. Në arsyetimin e vendimeve, Gjykata e rrethit gjyqësor dhe ajo e apelit, ndërmjet të tjerave, pasi konstatojnë se procedimi penal nr. ***, i vitit 2018, është bashkimi i kallëzimit të bërë nga shtetasit M. dhe P.K. dhe i kallëzimit të shtetasës N.K., kanë arritur në përfundimin se pavarësisht se prokuroria kërkon pushimin dhe procedimin penal të nisur mbi bazën e pretendimeve të shtetasës N.K., në asnjë moment nuk arsyetohet në lidhje bazueshmërinë e pretendimeve të kësaj të fundit, duke vlerësuar se kërkesa e prokurorisë është e paarsyetuar dhe se nuk duhet të pranohet.

Komisioni konstaton se në dosje ndodhet edhe vendimi nr. ***, datë 21.9.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku në të pasqyrohet se Prokuroria e Rrethit Shkodër ka paraqitur përpara gjykatës kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2018, për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”. Në këtë vendim, gjykata arsyeton se prokuroria nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Shkodër në vendimin nr. ***, datë 4.6.2018, pasi nuk është ekspertuar fleta e regjistrimit me nr. *** prot., datë 19.4.1996, dhe nota e transkriptimit nr. ***, datë 26.9.1945. Në përfundim, gjykata ka vendosur mospranimin e kërkesës së prokurorisë për pushimin e procedimit penal dhe kthimin e akteve, duke i lënë afat 4 muaj për kryerjen hetimore. Në dosjen e përcjellë nga Prokuroria e Rrethit Shkodër nuk ndodhet vendimi i gjykatës së apelit, megjithatë konstatohet se me vendimin e datës 11.12.2020, subjekti i rivlerësimit ka vendosur rifillimin e hetimeve dhe në datën 3.6.2021 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për pushimin e çështjes.

Bazuar në aktet e pasqyruara më sipër, Komisioni ka bërë vlerësimet si vijon:

Lidhur me vendimin e datës 15.3.2018, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka hetuar pretendimet e kallëzuesve për falsifikimin e akteve shkresore, por ka vendosur mosfillimin e çështjes me argumentin se provat shkresore që pretendohen të jenë të falsifikuara janë shqyrtuar një herë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 11.12.2001. Nga shqyrtimi vendimit nr. ***, datë 11.12.2001, të paraqitur nga denoncuesi, konstatohet se gjykata ka marrë në shqyrtim kërkesën e palëve paditëse për ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 5.11.1996, të KKK Pronave, pa analizuar ndonjë pretendim apo kërkesë lidhur me falsitetin e këtij vendimi apo të notës së transkriptimit nr. ***, të datës 26.9.1945, mbi bazën e të cilit është marrë vendimi i KKK Pronave. Në zbatim të nenit 71¹⁶⁸ të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit mund t'i referohej vendimit gjyqësor civil nëse gjatë gjykimit civil do të ishin ngritur pretendime për falsitetin e dokumenteve, sipas nenit 270 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe këto pretendime të ishin marrë në shqyrtim nga gjykata civile në përputhje me rregullat procedurale civile. Në këto kushte, duket se referenca që bën subjekti në vendimin gjyqësor civil është e pavend (irrelevante).

*Lidhur me kërkesën “për pushimin e çështjes”, pa datë (12.6.2019 sipas shkresës nr. ***, datë 14.6.2019, të prokurorisë) drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 7.6.2018*, Komisioni konstaton se, pavarësisht se në fund të këtij dokumenti subjekti pasqyron se në këtë procedim penal është bërë bashkimi me procedimin nr. *** (me kallëzues N.K.), në të pasqyrohen vetëm rrethanat e faktit dhe detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Shkodër në vendimin nr. ***, datë 25.4.2018, lidhur me kallëzimin e shtetasve

¹⁶⁸Kodi i Procedurës Penale, neni 71, parashikon se: “Vendimi civil i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që gjykon çështjen penale vetëm për sa i përket faktit nëse vepra ka ndodhur ose jo, por jo për fajësinë e të pandehurit”.

M. dhe P.K., pa u shprehur nëse vërtetohen ose jo pretendimet e kallëzueses N.K. Mosparaqitja e shkaqeve të parashtruara nga kallëzuesja N.K. krijon dyshime mbi cenimin e të drejtës së ankimit efektiv, si dhe të drejtës për t'u dëgjuar.

Lidhur me kërkesën e vitit 2020 për pushimin e procedimit penal (datë 15.5.2020, sipas shkresës së prokurorisë nr. *** prot., datë 18.5.2020) Komisioni konstaton se subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me faktin e ekspertimit të vendimit nr. ***, datë 5.11.1996, të KKK Pronave dhe lidhur me dokumentin “notë transkriptimi nr. *** datë 4.9.1945”, por nuk ka nuk ka dhënë shpjegime lidhur me konstatimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për mungesën e ekspertimit të fletës së regjistrit me nr. *** prot., datë 19.4.1996, dhe të notës së transkriptimit nr. ***, datë 26.9.1945. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Shkodër në vendimin nr. ***, datë 4.6.2018, për kryerjen e aktekspertimit grafik nëse ka ose jo ndërhyrje apo të lloje të tjera në vendimin nr. ***, datë 5.11.1996, të KKK Pronave dhe në notën e transkriptimit nr. ***, datë 26.9.1945.

*Lidhur me zbatimin e vendimit nr. ***, datë 21.9.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*, Komisioni vlerëson se shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se “afati i caktuar nga gjyqtari i seancës paraprake nuk është afat hetimor që i nënshtrohet parashikimeve të institutit të afatit të hetimeve paraprake të rregulluara nga nenet 323 e vijues të Kodit të Procedurës Penale”, është i pa mbështetur në dispozitat procedurale, pasi nenet 323-327 i referohen afatit të përfundimit të hetimeve paraprake që zhvillon prokurori. Në këto dispozita përcaktohet e drejta e prokurorit për zgjatjen e tyre, ndërsa vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake është parashikuar në kreun VIII, “Përfundimi i hetimeve”, të Kodit të Procedurës Penale, nenet 329¹⁶⁹, 329/a¹⁷⁰ dhe 329/b¹⁷¹. Bazuar në këto dispozita, gjyqtari i seancës paraprake vendos kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve kur çmon se janë të paplota dhe cakton afatin brenda të cilit duhet të përfundojnë, moszbatimi afatit të vendosur nga gjykata përbën shkelje procedurale nga organi i akuzës. Neni 324 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: “4. Provat e marra pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren”. Sa më sipër, shpjegimi i subjektit se afati i caktuar nga gjyqtari i seancës paraprake nuk është afat hetimor, është i pa mbështetur. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se hetimet kanë zgjatur më tepër se 4 muaj, duke tejkaluar afatin e vendosur nga gjykata.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin, kriteret të parashikuar nga pika 2¹⁷² e nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

7. Në lidhje me denoncimet nr. * prot., datë 2.6.2020; nr. *** prot., datë 29.12.2020, dhe nr. *** prot., datë 10.3.2021, të shtetases L.D., e cila akuzon subjektin e rivlerësimit**

¹⁶⁹Neni 329 parashikon se: “3. Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e akteve. Gjykata vendos sipas rastit: [...] b) kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve, kur çmon se ato janë të paplota, duke përcaktuar drejtëtimet e thellimit të tyre dhe, kur është rasti, edhe veprimet që duhet të kryhen, si dhe cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë”.

¹⁷⁰Neni 329/a parashikon se: “Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1 i nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes”.

¹⁷¹Neni 329/b parashikon se: “2. Kërkesa shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake në seancë me dyer të mbyllura, në prani të palëve [...] 4. Kur gjykata vendos sipas germës ‘b’, të paragrafit 3, të nenit 329, të këtij Kodi, i cakton prokurorit një afat për kryerjen e hetimeve”.

¹⁷²Ligji nr. 96/2016, neni 73 parashikon se: “1. Vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorit përfshin njohuritë ligjore dhe të arsytimit ligjor. 2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën [...]”.

për mbylljen e hetimeve dhe për shkelje të etikës profesionale, zvarritje të procesit dhe moskryerjen e veprimeve hetimore, Komisioni kërkoi nga subjekti i rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: (i) subjekti nuk ka kryer veprimet e duhura hetimore në vitin 2020, si: nuk ka administruar praktikën e konkurrencës për periudhën 2016 – 2017; nuk ka identifikuar personat pjesëmarrës në konkurs; nuk ka marrë në pyetje anëtarët e komisionit; nuk ka verifikuar në DAR Shkodër shkresat rreth këtij fakti; dhe (ii) referenca që bën subjekti në vendimet e gjykatave administrative për të arritur në përfundimin se fakti nuk parashikohet si vepër penale është e pavend (irrelevante).

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se gjykata ka vendosur të kryhen veprime të tjera verifikuese, duke u bazuar kryesisht në pretendimet që ka shfaqur në seancën gjyqësore shtetasja L.D. dhe njëri nga këto ka qenë se Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër (DAR) ka fshehur shkresa dhe nuk ia ka vënë në dispozicion organit të akuzës. Pas kthimit të kësaj çështjeje nga gjykata, organi i akuzës ka kryer një hetim të plotë, duke pasqyruar të gjithë procedurën e realizuar nga DAR Shkodër. Ky fakt rezultoi i pasqyruar në vendimin gjyqësor nr. ***, datë 19.4.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që ka pranuar kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2019 dhe ky vendim gjyqësor ka marrë formë të prerë në datën 25.5.2021. Sa më sipër, rezultoi se janë kryer veprime shpesh për të verifikuar disa pretendime të tjera që ka pasur kallëzuesja në seancën gjyqësore dhe ka rezultuar se fakti i kallëzuar nuk plotëson elementet e anës objektive të veprës penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Analiza e Komisionit

Subjekti, në shpjegimet e tij, nuk ka sqaruar konstatimin e Komisionit për moskryerjen e veprimeve të duhura hetimore, sikurse janë konstatuar në vendimin nr. ***, datë 22.6.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, por jep sqarime për kryerjen e veprimeve hetimore pas kthimit të akteve nga gjykata. Lidhur me konstatimin e Komisionit se referenca që ka bërë në vendimet e gjykatave administrative për të arritur në përfundimin se fakti nuk parashikohet si vepër penale në kërkesën për pushimin e çështjes, pa datë (viti 2020), është e pavend (irrelevante), nuk ka dhënë sqarime.

Nga analizimi i akteve të procedimit penal nr. *** të vitit 2019, të administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër¹⁷³, Komisioni konstaton se shtetasja L.D. ka bërë kallëzim penal ndaj anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit pranë ish-Drejtorisë Arsimore Shkodër, për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Shtetasja L.D. ka deklaruar se ka konkurruar në portalin “Mësuesi për Shqipërinë”, në vitin 2016 - 2017 dhe është renditur e dyta në Prefekturën Shkodër, profili biologji. Më pas ka lidhur kontratë të përkohshme me gjimnazin “****” në datën 15.12.2016 dhe ka rinovuar kontratën në janar të vitit 2017. Në datën 3.5.2017 shkolla ka shpallur vend të lirë pune për vendin ku ka punuar. Sipas pretendimit të saj, në vend që të kalonte nga kontrata e përkohshme në kontratë njëvjeçare, në vendin e saj në shtator të vitit 2017 është kaluar me lëvizje paralele shtetasja A.S., në një vend që i takon konkurrentëve të portalit, pasi është shpallur vend i lirë pune. Përveç këtij rasti është emëruar nga kjo listë fituesish i 4-ti në renditje para saj që ishte e para në rang qyteti dhe e dyta në rang prefekturë.

Në përfundim të hetimeve Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (pa datë, viti 2020), duke kërkuar pushimin e procedimit penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 22.6.2020, ka vendosur kthimin e akteve të Prokurorisë Shkodër dhe detyrimin e saj për vazhdimin e hetimeve, sikurse përcaktohet në arsyetimin e vendimit, si dhe hetimet paraprake të zhvillohen

¹⁷³Shkresë nr. *** prot., datë 18.6.2021.

për një afat 60-ditor. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 4.9.2020. Në arsyetimin e vendimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndërmjet të tjerave, ka arsyetuar se: “[...] bazuar në aktet dhe provat e administruara në kuadër të këtij procedimi penal, organi i akuzës nuk i ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kallzueses lidhur me emërimin e shtetasve A.S. dhe A.V. Gjithashtu, kallzuesja pretendoi se DAR Shkodër ka fshehur disa shkresa rreth procedurës së ndjekur të cilat nuk i ka administruar organi i akuzës. Ndodhur para këtyre rrethanave të konstatuara, gjykata e çmon të nevojshme kthimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër për hetime të mëtejshme rreth veprës penale ‘shpërdorim detyre’, parashikuar neni 248 i Kodit Penal, duke caktuar konkretisht këto detyra: - të thirret sërish për të dhënë deklarime kallzuesja L.D. dhe hetimet të shtrihen rreth pretendimeve për të cilat sipas saj organi i akuzës nuk ka hetuar...; - të identifikohen se kush janë personat pjesëmarrës në këtë konkurs...; - të pyeten anëtarët e komisionit rreth mbledhjeve të zhvilluara dhe procedurave të ndjekura rreth këtij fakti...; - të verifikohet nëse DAR Shkodër disponohen shkresa të tjera rreth këtij fakti që nuk janë vënë në dispozicion kallzueses dhe organit të akuzës...”.

Pas kryerjes së detyrave të lënë nga gjykata, subjekti i rivlerësimit, me kërkesën e datës 25.2.2021, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për pushimin çështjes. Gjykata, me vendimin nr. ***, datë 19.4.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe pushimin e çështjes që lidhet me procedimin penal nr. *** të vitit 2019, për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky vendim ka shënimin “marrë formë të prerë në datën 25.5.2021”.

Komisioni konstaton se në kërkesën për pushimin e çështjes të vitit 2020 (pa datë) dhe të datës 25.2.2021, subjekti, ndërmjet të tjerave, arsyeton se: “[...] konstatohet se pretendimet e shtetas L.D. janë shqyrtuar edhe nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, që do të thotë se nuk janë konstatuar shkelje ligjore në rastin konkret. Gjithashtu, edhe MASH ka verifikuar pretendimet e kësaj shtetase dhe ka arritur në përfundimin se DAR Shkodër dhe shkolla e mesme ‘***’ kanë respektuar procedurat e përcaktuara në udhëzimin e MASH [...]”.

Nga shqyrtimi i vendimit nr. ***, datë 31.5.2018, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, konstatohet se kjo gjykatë, në arsyetimin e vendimit, shprehet se: “[...] padisë i mungon legjitimiteti pasiv, pasi ajo i kundrejtohet DAR Shkodër dhe Ministrisë së Arsimit [...] caktimi apo emërimi, transferimi në detyrë i mësuesit në punë nuk është në tagrin e Drejtorive Arsimore si institucione për është atribut i drejtuesit të shkollës [...] aktet e kundërshtuara nga paditësja nuk konsiderohen akte administrative dhe nuk mund të shprehet për rrëzimin e padisë” dhe në fund ka vendosur mospranimin e padisë. Ndërsa Gjykata Administrative e Apelit, në vendimin nr. ***, datë 11.2.2019, arsyeton se: “aktet e kundërshtuara nga paditësja në padi nuk janë akte administrative” dhe ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Sikurse vërehet, gjykatat administrative nuk kanë shqyrtuar ligjshmërinë e akteve të kundërshtuara nga paditësja apo ligjshmërinë e procedurave të ndjekura nga institucionet dhe, si pasojë, referenca që bën subjekti në këto vendime për të arritur në përfundimin se fakti nuk parashikohet si vepër penale është e pavend. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se në rastin e dërgimit të kërkesës për pushimin e çështjes së vitit 2020, subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore dhe se kërkesat për pushimin e çështjes të viteve 2020 dhe 2021 janë të paarsyetuara.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësive të përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe në aspektin e arsyetimit ligjor

bazuar në treguesin e cilësisë së analizës dhe të argumentimit logjik, të parashikuara nga pikat 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar¹⁷⁴.

8. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 8.7.2020, të shtetases A.D., e cila ankohet kundër vendimit të subjektit të rivlerësimit, duke pretenduar se ka hequr dokumentacionin nga dosja e hetimit dhe lidhur me përfundimin e arritura nga ai në procedimin penal nr. ***, datë 7.9.2017, si dhe për mos njoftimin e përfundimit të hetimeve lidhur me kallëzimin e saj të bërë ndaj shtetasve A.Sh., Gj.Sh. dhe A.K., Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime lidhur me këtë denoncim.**

Subjekti ka shpjeguar se ka kryer detyrën me korrektësi dhe nuk mund të ngrihen hije dyshimi ndaj tij si prokuror, pasi sipërfaqja prej 10.000 m², e përfituar me dokumentacion të falsifikuar, është konfiskuar dhe i ka kaluar shtetit.

Analiza e Komisionit

*Lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 7.9.2017, nga analizimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga denoncuesja¹⁷⁵, rezulton se shtetasi Gj.Sh., A.Sh. dhe A.K. kanë bërë kallëzim penal ndaj shtetasve A.K./D., pasi kanë pretenduar se kjo shtetase po mundohej të merrte 10.000 m² në fshatin Razëm. Kallëzuesit kanë kërkuar dhe pretenduar që organi i akuzës të hetonte lidhur me mënyrën se si kishte arritur të regjistronte pronën në emër të saj dhe të familjarëve të saj. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushimin e çështjes, meqenëse sipas saj ndjekja penale për veprën penale “falsifikim” është parashikuar bazuar në pikën “c”, të nenit 66, të Kodit Penal, ndërsa për veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, ndjekja penale nuk mund të vazhdojë, pasi shtetasi i dyshuar L.K. ka ndërruar. Gjithashtu, prokuroria ka kërkuar konfiskimin dhe kalimin në favor të shtetit të pasurive të paluajtshme të fituara me vendimin nr. ***, datë 17.4.2001, të KKK Pronave, rrethi Malësi e Madhe dhe asgjësimin e këtij vendimi.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 29.7.2019, ka vendosur: “1. Pranimin pjesërisht të kërkesës së Prokurorisë [...] 2. Pushimin e çështjes penale lidhur me procedimin penal nr. *** të vitit 2017, për veprën penale ‘pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale’, pasi personi që dyshohet se ka kryer veprën penale ka vdekur dhe për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, [...] pasi është plotësuar afati i parashkrimit të ndjekjes penale. 3. Rrëzimin e kërkesës për pjesën tjetër”. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 16.10.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 29.7.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me ndryshimin për pranimin e plotë të kërkesës së prokurorit për asgjësimin e vendimit nr. ***, datë 17.4.2001, të KKK Pronave, rrethi Malësi e Madhe dhe konfiskimin dhe kalimin në favor të shtetit të pronave të fituara me këtë vendim.

¹⁷⁴Ligji nr. 96/2016, neni 73, parashikon se: “1. Vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorit përfshin njohuritë ligjore dhe të arsytimit ligjor. 2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën. 3. Aspekti i arsytimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit [...]”.

¹⁷⁵(1) Kërkesë drejtuar Komisionit; (2) vendim nr. ***, datë 16.10.2019, i Gjykatës së Apelit Shkodër; (3) shkresë nr. *** prot., datë 20.7.2018; (4) lista e shkodranëve që kanë pasuri në Razëm-Vrith, viti 1947; (5) shpjegime përpara gjykatës; (6) vendim nr. ***, datë 29.7.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; (7) vendim për pushim procedimi penal nr. ***, viti 2006.

Komisioni konstaton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Apelit Shkodër në arsyetimin e vendimeve të tyre kanë pasqyruar dhe qëndrimin e denoncueses se nuk pranonte faktin se vendimi i KKKP Malësi e Madhe ishte i falsifikuar, pasi ka prova të plota cilat ishin fshehur nga ata që kanë interesa, pra, denoncuesja ka pasur mundësinë për paraqitjen e dokumentit të pretenduar si të hequr nga dosja përpara gjykatës, ndërsa ankimi lidhur me konkluzionet e prokurorit se vendimi i KKK Pronave është i falsifikuar, është pretendim që i përket themelit të çështjes e cila është zgjidhur me vendim të Gjykatës së Apelit Shkodër. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se denoncuesja parashtron rrethana që nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

*Lidhur me kallëzimin e bërë nga denoncuesja ndaj shtetasve A.Sh., Gj.Sh. dhe A.K., nga verifikimi i sistemit elektronik gjykata.gov.al Komisioni ka konstatuar se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është gjykuar çështja penale me palë: ankues A.D.; kundër Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; persona të interesuar Gj.Sh., Gj.R., K.Gj.R., N.M., L.T., L.L. dhe C.Gj.; me objekt “kundërshtim i vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për mosfillimin e procedimit penal të kallëzimit penal nr. ***, viti 2019”.*

Nga shqyrtimi i vendimit nr. ***, datë 27.2.2020, rezulton se shtetasja A.D. ka bërë kallëzim penal ndaj shtetasve Gj.Sh., Gj.R., K.Gj.R., N.M., L.T., L.L. dhe C.Gj. Sipas ankueses, këta shtetas, në vite të ndryshme dhe procedime të ndryshme penale, sidomos tek procedimi i fundit i vitit 2017, kanë pohuar fakte të paqena dhe shumë të ndryshme nga e vërteta dhe nga ato deklaramë që po ata vetë i kishin bërë para disa viteve. Duke i vlerësuar si kallëzime të rreme apo deklaramë të pavërteta të bëra para organit hetimor, kallëzuesja ka pretenduar që të fillojë procedimi penal kundër tyre për kryerjen e veprave penale “kallëzim i rremë” dhe “deklaramë të rreme para prokurorit apo oficerit të policisë gjyqësore”.

Në datën 14.1.2020 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka marrë vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal” lidhur me kallëzimin penal nr. ***, datë 31.12.2019, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Kundër vendimit ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër kallëzuesja A.D. Gjykata, me vendimin nr. ***, datë 27.2.2020, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës së bërë nga ankuesja A.D., duke lënë në fuqi vendimin e mosfillimit të procedimit penal sipas kallëzimit të bërë nga ankuesja me nr. ***, viti 2019, datë 14.1.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”. Gjykata, në vendimin e saj, pasi pasqyron arsyetimin e vendimit të prokurorit, arsyeton se: “[...] ky vendim është dërguar për njoftim kallëzueses, sipas shkresës nr. *** prot., datë 16.1.2020, dhe vlerësoi se ankimi ndaj këtij vendimi është paraqitur brenda afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 291 i KPP-së.” dhe më pas ka marrë në shqyrtim pretendimet e ankueses. Sa më sipër, Komisioni konstaton se denoncuesja është njoftuar lidhur me vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal të kallëzimit penal dhe ka ushtruar të drejtën e ankimit kundër këtij vendimi në gjykatë.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional.

9. Në lidhje me denoncimin nr. * prot., datë 23.3.2021, të shtetasit Gj.Sh.,** lidhur me procedimin penal nr. ***, të regjistruar për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: “Kërkesa për pushimin e çështjes e datës 24.3.2021 i mungon arsyetimi në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore për marrjen e vendimit të pushimit”.

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij, ka sqaruar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 5.10.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pushimin e procedimit penal nr. *** të viti 2015. Kjo do të thotë që Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka kryer veprimet hetimore që janë caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi nëse kërkesa nuk do të ishte e arsyetuar do ta kthente procedimin penal për hetime të mëtejshme.

Analiza e Komisionit

Komisioni analizoi kërkesën e datës 23.3.2021, për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015, të administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër¹⁷⁶ dhe konstaton se subjekti, pasi ka pasqyruar veprimet hetimore të lëna si detyrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër në vendimin nr. ***, datë 28.6.2018, pasqyron përmbajtjen e nenit 186 të Kodit Penal dhe nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale dhe konkludon se: *“Për sa parashtrova më sipër, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe procedimi penal i filluar duhet të pushohet”*.

Komisioni konstaton se subjekti, në kërkesën drejtuar gjykatës, nuk ka analizuar nëse rrethanat e vërtetuara nga hetimi plotësojnë kushtet ligjore të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale. Si pasojë, Komisioni vlerëson se kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015, i regjistruar për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, i mungon arsyetimi.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësive të përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsyetimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës dhe të argumentimit logjik, të parashikuara nga pikat 2 dhe 3, të neni 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar¹⁷⁷.

10. Në lidhje me denoncimin nr. *, datë 18.1.2021, të shtetasve M.P., N.Q., N.S. dhe P.Gj.**, të cilët akuzojnë subjektin e rivlerësimit se ka hetuar veprimtarinë e kryer nga bashkëshortja e tij, e cila ka qenë juriste pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, ka ndjekur hetimet në lidhje me kallëzimet penale të kryera nga motra e tij A.S. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: “(i) subjekti nuk ka arsyetuar faktin nëse dokumentet e paraqitura nga familja K., në procesin gjyqësor civil ishin ose jo të falsifikuara, nëse ato janë përdorur dhe nëse ishin në dijeni të këtij fakti; (ii) subjekti, në kërkesën për pushim e çështjes penale, nuk ka analizuar elementët përbërës të veprës penale të nenit 143 të Kodit Penal dhe nuk pasqyrohen arsyet se pse në rastin konkret nuk janë konsumuar elementët e kësaj vepre penale; (iii) në dosjen e procedimit penal nr. ***, viti 2018, mungojnë vendimet e prokurorit për zgjatjen e hetimeve; dhe (iv) subjekti nuk ka kërkuar heqjen dorë nga procedimi penal në kundërshtim me nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale.

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij, ka dhënë sqarimet si vijon:

¹⁷⁶Shkresë nr. *** prot., datë 13.4.2021.

¹⁷⁷Ligji nr. 96/2016, neni 73, parashikon se: “1. Vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorit përfshin njohuritë ligjore dhe të arsyetimit ligjor. 2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën. 3. Aspekti i arsyetimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit [...]”.

Lidhur me konstatimin se nuk ka arsytuar faktin nëse dokumentet e paraqitura nga familja K., në procesin gjyqësor civil ishin ose jo të falsifikuara, nëse ato janë përdorur dhe nëse ishin në dijeni të këtij fakti, sqaron se nuk ka pasur të dhëna që dokumentacioni i përdorur të jetë i falsifikuar, për më tepër që shtetasit që kanë paraqitur këtë dokumentacion në gjykatë në vitin 1995 në KKK Pronave në vitin 1995, si dhe për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë nuk rezulton se është shtetasi N.K., i cili nuk ka vendim gjyqësor të formës së prerë që të ketë konstatuar si të falsifikuar ndonjë dokument të kësaj prone dhe të jetë njohur paraprakisht me përmbajtjen e këtij vendimi para se të ketë dorëzuar dokumentacionin në gjykatë.

Në vijim, ka shpjeguar se sipas vendimit civil nr. ***, datë 18.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, kallëzuesit janë zaptues me keqbesim të kësaj prone dhe duhet të lirojnë dhe dorëzojnë pronën, si dhe të paguajnë detyrimet e përdorimit të sendit deri në datën e liritimit. Gjithashtu, sqaron se të njëjtat fakte janë hetuar në procedimin penal nr. ***, për veprën penale “falsifikim dokumentesh dhe shpërdorim detyre”, parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal, i cili është pushuar me vendimin e datës 3.7.2014, të prokurorit A.S., pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, vendim ky i lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 21.1.2015, dhe nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 29.1.2016, dhe në procedimin penal nr. ***, që është pushuar me vendimin e datës 9.12.2016, të prokurores A.M. Sipas subjektit është e qartë se ky fakt është hetuar edhe dy herë të tjera, për më tepër që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Apelit Shkodër e kanë vlerësuar hetimin të plotë, si dhe nuk kanë konstatuar kryerjen e ndonjë vepre penale, për më tepër të personave që kanë qenë të kallëzuar.

*Lidhur me sugjerimin e oficerit të policisë gjyqësore për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. *** të vitit 2018, sqaron se oficerja e policisë gjyqësore nuk kanalizuar me objektivitet të gjitha të dhënat e procedimeve penale të mësipërme, ku nuk rezulton të ketë një vendim prokurorie apo gjykate të formës së prerë që të ketë konstatuar ndonjë dokument të falsifikuar.*

Lidhur me konstatimin e Komisionit se mungojnë vendimet e prokurorit për zgjatjen e hetimeve, shpjegon se afati 3-mujor i hetimeve ka lidhje me rastin kur prokurori regjistron tek urdhri për regjistrimin e procedimit penal ose me një vendim të mëvonshëm emrin e personit që atribuohet vepra penale.

Lidhur me konstatimin se nuk ka kërkuar heqjen dorë nga procedimi penal në kundërshtim me nenin 17, të Kodit të Procedurës Penale, sqaron se drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka qenë në dijeni të faktit se motra tij A.S. ka qenë juriste pranë DRSSH-së Shkodër dhe zv/Drejtesit i Prokurorisë ka pasur dijeni për këtë fakt, pasi njiheshin familjarisht dhe ka pasur njohje me motrën e tij.

*Lidhur me kallëzimin penal nr. *** të vitit 2014, shpjegon se vendimi për “mosfillimin e hetimeve për kallëzimin penal nr. *** të vitit 2014” është ankimuar nga DRSSH-ja Shkodër dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 5.12.2014, ka vendosur “konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit për mosfillimin e hetimeve të marrë në datën 10.11.2014, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe shfuqizimin e këtij vendimi”. Kundër vendimit subjekti ka bërë ankim dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 7.4.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 5.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rrëzimin e ankimit të paraqitur nga DRSSH-ja Shkodër.*

*Lidhur me kallëzimin penal nr. ***, datë 5.11.2014, ka pasqyruar një tjetër procedim penal të ngjashëm, por me shtetasin Sh.K., ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 23.1.2015, ka vendosur “konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit për mosfillimin e hetimeve të marrë në datë 6.11.2014, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe shfuqizimin e këtij vendim”. Ndërsa, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë*

3.3.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 23.1.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rrëzimin e ankimit të paraqitur nga DRSSH-ja Shkodër.

Analiza e Komisionit

Nga analizimi i akteve të procedimit penal nr. *** të vitit 2018, të administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër¹⁷⁸ rezulton se shtetasit M.P., N. Q., N.S. dhe P.Gj. kanë bërë kallëzim penal kundër shtetasve U.M., L.L., A.N. N.K., J.K., M.K. dhe C.K., trashëgimtarë ligjorë të shtetasës Gj.B. Kallëzuesit kanë pretenduar se dokumentet mbi bazën e të cilave është dhënë vendimi i KKK Pronave dhe është bazuar procedura e privatizimit janë të falsifikuara dhe për këtë qëllim kanë bërë kallëzim edhe ndaj ish-anëtarëve të Komisionit të Privatizimit.

Gjatë hetimeve ka rezultuar se në emër të të kallëzuarve është regjistruar një titull bashkëpronësie mbi pasurinë e paluajtshme truall + ndërtesë, me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe trualli 4000 m² dhe sipërfaqe ndërtimore 1241,43m², në ZVRPP-në Shkodër. Origjina e fitimit të kësaj prone është vendimi nr. ***, datë 4.9.1995, i KKK Pronave Shkodër, sipas të cilit trashëgimtarëve të shtetasit Z.E.L., konkretisht shtetasës Gj.B., ka vendosur t'i njohë në pronësi dhe në zbatim të nenit 21 (për efekt parablerjeje) një sipërfaqe prej 6450 m², nga të cilat: 2450 m² të zëna me Ndërmarrjen Rruga Ura, nga ku 560 m² të zëna nga objektet e kësaj ndërmarrjeje dhe 1950 m² të zëna nga territori dhe sheshet e ndërmarrjes; 4000 m² të zëna nga Ndërmarrja Gjeologjike, ku 1470 m² janë të zëna me objekte të kësaj ndërmarrjeje dhe 2530 m² e zënë me territorin e saj. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ka vijuar me procedurat e privatizimit të objekteve të ish-Ndërmarrjes Gjeologjike Shkodër, duke ia shitur të kallëzuarve në kushtet kur ato kishin të drejtën e parablerjes, sipas vendimit të mësipërm të KKK Pronave. Nga shqyrtimi i dosjes penale rezultoi se kallëzuesit kanë paraqitur disa herë kallëzime penale për kryerjen e veprave penale “shpërdorim detyre” dhe “falsifikim i dokumenteve”. Konkretisht, me vendimin e datës 3.7.2014, prokurori A.S. ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2013, të regjistruar mbi bazën e kallëzimit të shtetasve Gj.P., P.Gj., M.P., N.S. dhe N.Q., pasi fakti nuk parashikohet si vepër penale. Gjithashtu, edhe prokurorja A.M., me vendimin e datës 9.12.2016, ka vendosur pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. *** të vitit 2016, të regjistruar në bazë të kallëzimit të shtetasës L.K. (S.), (e bija e N.S.), e cila kishte bërë kallëzim për falsifikimin e vendimit nr. ***, datë 4.9.1995, të KKK Pronave.

Në përfundim të hetimeve, subjekti i rivlerësimit, me kërkesën e datës 21.1.2020, për pushimin e çështjes i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke kërkuar pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 13.12.2018. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër¹⁷⁹ vuri në dispozicion të Komisionit vendimin nr. ***, datë 19.7.2021. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit gjyqësor, Komisioni vëren se gjykata ka arsyetuar: “[...] Prokurori nuk ka analizuar provat e grumbulluara dhe nuk ka argumentuar se përse faktet e kallëzuar nga shtetasit M.P., N.Q., N.S. e P.Gj. nuk përbëjnë vepër penale. Në kërkesën për pushimin hetimeve, prokurori shprehet se pretendimet e kallëzuesve janë shqyrtuar dhe rrëzuar si të papranueshme tek procesi civil me nr. vendimi ***, datë 18.12.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 14.5.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër [...] në këtë vendimi civil gjykata nuk ka trajtuar fare në aspektin penal nëse vendimi nr. ***, datë 4.9.1995, i KKK Pronave Shkodër është ose jo i falsifikuar”. Në vijim, gjykata arsyeton se: “Prokurori shprehet se pretendimet e kallëzuesve janë hetuar tek procedimi penal nr. ***, i cili është pushuar [...] evidentohet fakti se në hetimet e zhvilluara për procesin penal nr. *** nuk është hetuar për

¹⁷⁸Shkresë nr. *** prot., datë 18.6.2021.

¹⁷⁹Shkresë nr. *** prot., datë 15.10.2021.

asnjë nga faktet e kallëzuara nga shtetasit M.P., N.Q., N.S. e P.Gj., por është referuar praktikave të legalizimit të objekteve që shtetasit kishin ndërtuar e përshtatur në pronën objekt gjykimi”. Gjithashtu, gjykata ka konstatuar se prokurori nuk ka kryer disa veprime hetimore.

Komisioni, bazuar në pretendimet e denoncuesve, hetoi nëse në rastin konkret subjekti i rivlerësimit ka hetuar veprimtarinë e kryer nga bashkëshortja e tij A.V.Z. (L.). Nga shqyrtimi i dosjes së privatizimit, dërguar prokurorisë nga Ministria e Financave, me shkresën nr. *** prot., datë 7.11.2019, rezultoi se bashkëshortja e subjektit nuk ka qenë pjesë e komisionit “Të verifikimit të dosjeve të vlerësimit për privatizimin e shtatë objekteve të Ndërmarrjes Gjeologjike” dhe e komisionit “Për vlerësimin e objekteve dhe të truallit”, si dhe se emri i saj nuk figuron në shkresat dhe dokumentet e dosjes së privatizimit.

Komisioni shqyrtoi kërkesën “për pushimin e çështjes”, pa datë (datë 21.1.2020, sipas shkresës nr. *** prot., datë 30.1.2020, të Prokurorisë së Rrethit Shkodër) drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rezultoi se në arsyetimin e saj subjekti ka parashtruar veprimet hetimore të kryera, më pas pasqyron përmbajtjen e vendimit civil nr. ***, datë 28.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe përmbajtjen e vendimit të datës 3.7.2014, “Për pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2013” të prokurorit A.S. dhe në fund, pasi pasqyron përmbajtjen e neneve 143 dhe 248 të Kodit Penal dhe të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale arsyetoi se pretendimet e kallëzuesve janë hetuar te procedimi penal nr. ***, i cili është pushuar, si dhe janë rrëzuar si të papranueshme te procesi civil me vendimin nr. ***, datë 18.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 14.5.2015, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Komisioni shqyrtoi dosjen penale nr. *** dhe vëren se kallëzuesit, në kallëzimin e tyre të datës 14.12.2012, kanë pretenduar se anëtarët e KKK Pronave Shkodër, kryetarja e degës së Shoqërive Publike Shkodër dhe drejtori i Drejtorisë Rajonale të ALUIZN-i Shkodër, nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve të kundërligjshme, falsifikimit dhe përdorimit të dokumente të falsifikuara, kanë sjellë përfitime materiale në favor të shtetasve N.K. dhe J.K. Në vendimin “Për pushimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2013”, të datës 3.7.2014, prokurori i çështjes A.S. pasqyron hetimet e kryera lidhur me veprimtarinë e përfaqësuesve të organeve shtetërore dhe në fund arrin në përfundimin se nuk ka elemente të veprës penale “shpërdorim detyre”. Gjithashtu, Komisioni shqyrtoi vendimin civil nr. ***, të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe konstatoi se në arsyetimin e vendimit gjykata, pasi analizon nenin 296 të Kodit Civil (padinë e rivendikimit), ka arritur në përfundimin se paditësit janë bashkëpronarë të pasurisë nr. ***, me sipërfaqe truall 4000 m², nga kjo 1241,43 m² ndërtesë, të paditurit janë zotërues të paligjshëm për sipërfaqet ndërtimore të vjetra ekzistuese dhe për truallin që zotërojnë dhe në kushtet kur është provuar që janë në keqbesim duhet të shpërblejnë palën paditëse për përdorimin e sendit.

Nga analizimi i akteve të mësipërme, Komisioni vlerëson se në dosjen penale nr. *** prokurori i çështjes nuk ka hetuar lidhur me falsifikimin dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuar nga pjesëtarët e familjes K., por ka hetuar lidhur me veprimet e organeve shtetërore. Ndërsa gjykata, në procesin civil të përfunduar me vendimin nr. ***, nuk ka hetuar lidhur me falsitetin e dokumenteve që kanë përdorur paditësit për fitimin e pronësisë, por ka hetuar dhe gjykuar nëse plotësohen kushtet e padisë së rivendikimit. Neni 71 i Kodit të Procedurës penale përcakton se: “Vendimi civil i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që gjykon çështjen penale vetëm për sa i përket faktit nëse vepra ka ndodhur ose jo, por jo për fajësinë e të pandehurit”. Në rastin konkret, vendimi civil i formës së prerë nuk ka hetuar faktin nëse dokumentet e paraqitura nga pala paditëse në procesin gjyqësor ose përpara institucioneve shtetërore janë ose jo të falsifikuara.

Sa më sipër, Komisioni vlerëson se arsyetimi që përdor subjekti në kërkesën për pushim se pretendimet e kallëzuesve janë hetuar te procedimi penal nr. *** dhe janë rrëzuar si të

papranueshme te procesi civil me vendimin nr. ***, datë 18.12.2013, nuk është i mbështetur në këto akte. Gjithashtu, vlerëson se në kërkesën për pushim e çështjes penale, subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementet përbërëse të veprës penale, të parashikuara nga neni 143 i Kodit Penal dhe nuk pasqyron arsyet se pse në rastin konkret nuk janë konsumuar elementet e kësaj vepre penale.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësive të përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsytimit ligjor bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kriteret të parashikuara nga pikat 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar¹⁸⁰.

*Lidhur me pretendimet e denoncuesve se subjekti ka ndjekur hetimet në lidhje me kallëzimet penale të kryera nga motra e tij A.S., Komisioni administroi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër¹⁸¹ kopje të vendimit nr. ***, datë 5.12.2014, dhe të vendimit nr. ***, datë 5.2.2015. Nga shqyrtimi i vendimit nr. ***, datë 5.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezultoi se Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër ka paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër kallëzim ndaj shtetases H.T. për veprat penale “mashttrim në sigurime” dhe “falsifikim i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 143 dhe 186 të Kodit Penal, për shkak se nëpërmjet paraqitjes së certifikatës së lindjes me datëlindje të falsifikuar shtetasja H.T. ka përfituar padrejtësisht 404 lekë. Kallëzimi është hartuar dhe nënshkruar nga dy persona zyrtarë, që janë shtetaset A.T. dhe A.S. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 17.11.2014, ka vendosur “Mosfillimin e hetimeve për kallëzimin penal nr. *** të vitit 2014”. Kundër vendimi të prokurorisë ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, DRSSH-ja Shkodër. Gjatë gjykimit të këtij ankimi ka rezultuar se juristja A.S., që ka firmosur kallëzimin penal, është motra e subjektit të rivlerësimit. Bazuar në këtë fakt, gjykata ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit për mosfillimin e hetimeve të marrë në datën 17.11.2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në fund të vendimit pasqyrohet shënimi se: “Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim prokurori në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila, me vendimin nr. ***, datë 7.4.2015, ka vendosur ‘Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 5.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rrëzimin e ankimit të paraqitur nga DRSSH-ja”.*

Gjithashtu, edhe nga shqyrtimi i vendimit nr. ***, datë 5.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezultoi se Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër ka paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër kallëzim ndaj shtetases D.M., për veprat penale “mashttrim në sigurime” dhe “falsifikim të dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 143 dhe 186 të Kodit Penal, për shkak se nëpërmjet paraqitjes së certifikatës së lindjes me datëlindje të falsifikuar ka përfituar padrejtësisht 23.975 lekë, shumë e cila është likuiduar nga kjo e fundit. Kallëzimi është hartuar dhe nënshkruar nga dy persona zyrtarë, që janë shtetaset A.T. dhe A.S. Gjykata, bazuar në arsytimin e pasqyruar në paragrafin e mësipërm (vendimin nr. ***, datë 5.12.2014) ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit për mosfillimin e hetimeve të marrë në datën 6.11.2014, të Prokurorisë pranë

¹⁸⁰Ligji nr. 96/2016, neni 73, parashikon se: “1. Vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorit përfshin njohuritë ligjore dhe të arsytimit ligjor. 2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën. 3. Aspekti i arsytimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit [...]”.

¹⁸¹Shkresë nr. *** prot., datë 14.6.2021.

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në fund të vendimit pasqyrohet shënimi se: *“Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim prokurori në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila, me vendimin nr. ***, datë 7.4.2015, ka vendosur ‘Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 5.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe rrëzimin e ankimit të paraqitur nga DRSSH-ja’”*.

Nga shqyrtimi i vendimeve gjyqësore të paraqitura nga subjekti, rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në vendimin nr. ***, datë 23.1.2015, ka arritur në përfundimin se subjekti ndodhej në kushtet e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit, për shkak se motra e tij ka firmosur kallëzimin penal. Gjykata e Apelit Shkodër, në vendimin nr. ***, datë 7.10.2015, ka analizuar faktin e mësipërm dhe ka arritur në përfundimin se konkluzioni i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është i pabazuar në ligj. Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar se subjekti është ndodhur në të njëjtën situatë dhe në dy raste të tjera të trajtuara në paragrafin 10, “Denoncime nga publiku”, ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka konstatuar papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit të prokurorit, ndërsa Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e ankimit të DRSSH-së Shkodër.

59. Sa më sipër, Komisioni, bazuar dhe në arsyetimin shtjelluar në këtë vendim në analizimin e dosjes nr. 3 të shortuar, vlerëson se vendimet e subjektit të rivlerësimit i janë nënshtruar vlerësimit të fakteve, interpretimit të ligjit dhe formimit të bindjes së brendshme të trupit gjykues gjatë procesit gjyqësor nga gjykatat kompetente dhe meritojnë trajtimin dhe vlerësimin e një gjykate më të lartë. Në këto kushte, analizimi i faktit të konstatuar gjatë hetimit administrativ do të dilte jashtë juridiksionit kontrollues të Komisionit, në kuptim të pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

60. Në përfundim: Komisioni vlerësoi të mos trajtojë në vendim rastin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të parashikuar nga nenet 17 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale.

Përfundimet e Komisionit në lidhje me rivlerësimin e aftësive profesionale

Në përfundim të rivlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet që duhet vlerësuar si i papërshtatshëm, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për shkak se ka treguar cilësi të papranueshme në punë në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund t’i rikuperojë ato, duke u gjendur në kushtin e parashikuar nga pika 4 e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e aftësive profesionale dhe të çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, vendosi që subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe pikat 3 dhe 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ermir Lelçi.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 28.10.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO

Kryesuese

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj